

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS
SEKSIONI I SHKENCAVE SHOQËRORE

RRUGA E KOSOVËS DREJT INTEGRIMIT EKONOMIK EVROPIAN

Tryezë shkencore
(29 nëntor 2017)

KOSOVA ACADEMY OF SCIENCES AND ARTS
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS
SECTION OF SOCIAL SCIENCES

KOSOVA'S ROAD TOWARDS EUROPEAN ECONOMIC INTEGRATION

Scientific conference
(29 November 2017)

Approved for publication at the meeting of the Section of Social Sciences,
held on 18th January, 2018.

Editor: Correspondent member Justina Pula, Secretary of the Section of Social Sciences.



AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS
SEKSIONI I SHKENCAVE SHOQËRORE

RRUGA E KOSOVËS DREJT INTEGRIMIT EKONOMIK EVROPIAN

Tryezë shkencore
(29 nëntor 2017)

U miratua për botim në mbledhjen e Seksionit të Shkencave Shoqërore,
mbajtur më 18 janar 2018.

Redaktor: Anëtare korresponente Justina Pula, Sekretare e Seksionit të Shkencave Shoqërore.



Copyright © ASHAK

PËRMBAJTJA

| | |
|--|-----|
| <i>Jusuf Bajraktari</i> FJALA E HAPJES..... | 7 |
| <i>Isa Mustafa dhe Sokol Havolli</i> PROCESI I BERLINIT I VENDEVE TË BALLKANIT PERËNDIMOR..... | 9 |
| <i>Justina Sh. Pula dhe Adhurim Haxhimusa</i> LËVIZJA E TREGUT ENERGJETIK TË KOSOVËS DREJT TREGUT RAJONAL DHE E ARDHMJA E TIJ NË TREGUN EVROPIAN | 23 |
| <i>Petrit Gashi</i> TREGU I PËRBASHKËT BALLKANIK: KOMENT..... | 39 |
| <i>Drita Konxheli Radoniqi dhe Kadri Kadriu</i> INTEGRIMI I TREGUT TË ENERGJISË SË KOSOVËS ME RAJONIN DHE EVROPËN..... | 49 |
| <i>Hykmete Bajrami dhe Lulzim Krasniqi</i> KOSOVA DHE MARRËVESHJA PËR STABILIZIM ASOCIIM ME BE-në..... | 63 |
| <i>Fatmir Besimi</i> REFORMAT STRUKTURE DHE KONVERGJENCA EKONOMIKE E BALLKANIT PERËNDIMOR ME BASHKIMIN EVROPIAN | 77 |
| <i>Avdullah Hoti</i> PËRSHTATSHMËRIA E LEGJISLACIONIT TË KOSOVËS ME ACQUIS- COMMUNAUTAIRE TË BASHKIMIT EVROPIAN | 87 |
| <i>Gazmend Qorraj</i> INTEGRIMI TREGTAR NË BALLKANIN PERËNDIMOR: CEFTA 2006 | 97 |
| <i>Justina Shiroka Pula</i> INFRASTRUKTURA LIGJORE DHE RREGULLATORE NË SEKTORIN E ENERGJISË NË KOSOVË – ANA LIGJORE..... | 107 |
| <i>Valentin Toçi dhe Arben Mustafa</i> EUROIZIMI NË KOSOVË: STABILITETI FINANCIAR DHE DISA ASPEKTE MAKROEKONOMIKE..... | 121 |

FJALA E HAPJES

TRYEZË SHKENCORE

RRUGA E KOSOVËS DREJT INTEGRIMIT EKONOMIK EVROPIAN

Të nderuar zonja dhe zotërinj,
Kolegë dhe mysafirë të nderuar,

Kam nderin që në emër të Seksionit të Shkencave Shoqërore, të ASHAK-ut dhe të Këshillit Organizues të hapi punimet e kësaj tryeze.

Sipas programit të punës së Seksionit tonë është paraparë organizimi i Tryezës shkencore, e cila ka për objekt trajtimin e një teme shumë të rëndësishme si për aktualitetin ashtu edhe për ardhmërinë e Kosovës.

Sot kur na ndan një kohë prej 2 muaj e gjysmë nga 10 VJETORI i shpalljes së PAVARËSISË SË KOSOVËS, objektiv i gjakuar me shekuj e dekada nga të parët tanë, të organizuar në Lëvizjet Politike të Kohës, është e natyrshme që pikërisht sot në Akademi t'i kthehemi një rës ndër disiplinat më vitale të jetës aktuale socio-politike, përkatësisht çështjes së pozicionit të ekonomisë së vendit tonë në kontekstin vendor, rajonal dhe synimit të integritit evropian.

Siç shihet edhe nga titulli i Tryezës sikurse edhe nga pjesëmarrja e një përbërje profesionistësh intelektualë, ndër më kompetentët për këtë lëmi del se trajtimi i sotëm shkencor, është përgatitur me përkushtim dhe me një seriozitet të posaçëm nga Akademik Isa Mustafa, deri pak kohë më parë kryeministër i vendit dhe ekspert i shquar i kësaj discipline shkencore. Prandaj me këtë rast, shpreh falënderimin tim ndaj profesor Mustafës dhe ekipit të tij për kontributin e dhënë në organizim të kësaj tryeze.

Jam plotësisht i bindur se elaborimet e juaja me kumtesat që do të prezantoni sot para këtij auditori të nderuar, do të hapin shtigje për ecjen më të guximshme të ekonomisë kosovare drejt integritit evropian, sigurisht duke vënë në dukje faktorët relevantë dhe kërkesat tona të arsyeshme për një gatishmëri më të madhe të Bashkësisë Ndërkombëtare, për të mirëkuptuar synimet tona dhe për të hapur portat e organizmave të Evropës në shenjë, jo vetëm të solidaritetit formal, por në radhë të parë, në shenjë të interesit të shtuar për të njohur specifikat e Kosovës, e cila në të kaluarën ka qenë e eksploatuar dhe shfrytëzuar pamëshirshëm ekonomikisht dhe politikisht.

Andaj, zonja dhe zotërinj,

Me kaq e deklaroj të hapur Tryezën shkencore “Rruga e Kosovës drejt integritit ekonomik evropian”, ku ju do të prezantoni të arriturat dhe kontributet e juaja shkencore.

Ju faleminderit.

Tribuna është e hapur për ju Zotëri Akademik Mustafa.

Akademik Jusuf Bajraktari, Sekretar i Seksionit të Shkencave Shoqërore

PROCESI I BERLINIT I VENDEVE TË BALLKANIT PERËNDIMOR

Isa Mustafa¹ dhe Sokol Havolli²

Abstrakti

Si rezultat i nevojës për të pasur stabilitet në Bashkimin Evropian, pas valës së madhe të zgjerimit në vitin 2004 dhe dy valëve më të vogla, 2007 dhe 2013, Bashkimi Evropian për periudhën 2014-2018 vendosi të pushojë procesin e zgjerimit.

Rrjedha natyrale e zgjerimit të BE-së orientohet drejt 6 vendeve të Ballkanit Perëndimor. Me qëllim që hapi i reformave në vendet e Ballkanit Perëndimor të mos ndërpritet, si dhe të përshpejtohet përafrimi infrastrukturor, ekonomik, demokratik i shtetit të së drejtës dhe të sundimit të ligjit, vendet kyçe të BE-së iniciuan të ashtuquajturin Proces i Berlinit. Ky proces konsiderohet si instrument i dialogut multilateral dhe reformues i përcjellë edhe me asistencë financiare nga Bashkimi Evropian drejt shteteve të Ballkanit Perëndimor. Ky proces është iniciuar duke pasur edhe kufijtë e vet kohor.

Në këtë punim, argumentojmë se ky proces ka shërbyer pozitivisht në përshpejtimin e reformave infrastrukturore, ekonomike, të tregut energjetik, të bashkëpunimit kulturor dhe të rinisë, në aspektin e sigurisë, si dhe në intensifikimin e bashkëpunimit ekonomik dhe tregtar.

Megjithatë, ashtu edhe siç është filluar, si proces me afat kohor, është e nevojshme që pas përfundimit të Samitit të Londrës, në vitin 2018, nga Procesi i Berlinit të vazhdohet rruga e integritit sipas kriterëve dhe kapitujve të paracaktuar për procesin e integritit.

Hyrje

Procesi i zgjerimi të Bashkimit Evropian (BE) konsiderohet si njëra ndër pikat kryesore identifikuese të vet unionit. Zgjerimi më i madh në historinë e BE-së ishte ai i viteve 2004, ku 10 shtete të reja iu bashkuan unionit, kryesisht të Evropës Qendrore dhe Lindore. Krahas kësaj pasoi edhe vlerësimi i përgjithshëm se Bullgaria dhe Rumania i

¹ Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, rr. Agim Ramadani, nr. 305, Prishtinë 10000, Republika e Kosovës, isamustafa@ashak.org.

² Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Ekonomik, rr. Agim Ramadani p.n. Prishtinë 10000, Republika e Kosovës, sokol.havolli@uni-pr.edu.

janë bashkangjitur unionit para kohës dhe të papërgatitura, gjë që prodhuan një momentum të ri dhe një disponim për ngadalësim të procesit të zgjerimit. Ky disponim u reflektua edhe në vitet pas zgjerimit të fundit, atë të Kroacisë në vitin 2013. Edhe kriza ekonomike e vjetëve 2008-2009, ndikoi që rritja e trendëve kundër zgjerimit të ishte e evidente në kuadër të vendeve të BE-së.




Figura 1. Rritja ekonomike në vendet e BE-së dhe në Ballkanin Perëndimor

Siç shihet në figurën 1, reflektimi i krizës ekonomike globale të viteve 2007-2008 është përafërsisht identik në të gjitha vendet. Përveç Kosovës dhe Shqipërisë, të cilat edhe në vitin 2009 u karakterizuan me rritje ekonomike, të gjitha vendet e tjera të Evropës u përballën me recesion.

Vendet e Ballkanit Perëndimor nuk u atakuan në formë direkte nga kriza, por më tepër përmes burimeve të financimit siç janë zvogëlimi i investimeve të huaja direkte, rënia e eksporteve dhe ulja e remitancave nga diaspora. Në anën tjetër, rënia drastike e çmimeve të mallrave kapitale në vendet e Evropës ndikoi në vendet me bazë të ulët të eksportit, siç ishin Kosova, por dhe Shqipëria, që të rrisin investimet e tyre të brendshme dhe të nxisnin reformat strukturore.

Në përgjithësi, gjendja pas krizës të vjetëve 2008-2009 u shoqërua me rritje të vogël ekonomike, si në vendet e BE-së, ashtu edhe në vendet e Ballkanit Perëndimor. Kjo rritje nuk siguronte se vendet e Ballkanit Perëndimor do të kenë trend të nevojshëm për të arritur nivelin e standardit të jetës dhe përafrimin me vendet e BE-së. E shoqëruar me deklarin e BE-së se procesi i zgjerimit do të ketë ndërprerje 4 vjeçare, inicimi i Procesit të Berlinit është quajtur si iniciativë komplementare ndaj procesit të zgjerimit, por në disa raste më të rralla edhe si zëvendësim i procesit të zgjerimit.

Objektivat e Procesit të Berlinit

Procesi i Berlinit mund të konsiderohet si platformë për rritjen e bashkëpunimit regional në Ballkanin Perëndimor duke aplikuar reformat e nevojshme të BE-së dhe duke ndjekur procesin e zgjerimit. Meqenëse vendet e Ballkanit Perëndimor gjenden në nivele të ndryshme të zhvillimit, por edhe të proceseve dhe fazave të integritit në BE, Procesi i Berlinit luan një rol të veçantë në ngushtimin e dallimeve ndërmjet tyre.

Vendet e Ballkanit Perëndimor, Kosova, Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi, Maqedonia dhe Serbia vlerësohen, nga institucionet ndërkombëtare financiare, se kanë bërë hapa të rëndësishëm në rritjen ekonomike dhe në zvogëlimin e varfërisë që nga fillimi i tranzicionit në ekonominë e tregut. Kosova i është bashkangjitur këtij tranzicioni gati një deçenie më vonë, si pasojë e okupimit dhe luftës.

Krahasuar me vendet e tjera, të cilat po ashtu kanë kaluar tranzicionin, dhe janë bërë pjesë e BE-së, faktori i konvergencës ekonomike tregon se ato vende, të madhësisë përafërsisht të njëjtë me ato të Ballkanit Perëndimor, janë zhvilluar shumë më shpejtë dhe kanë zvogëluar diferencat në të ardhura me mesataren e vendeve të Bashkimit Evropian.

Objektivat e Procesit të Berlinit, të deklaruara nga të gjithë vendet pjesëmarrëse në Samitin e parë në vitin 2014 në Berlin, ndërlidhen me

përkushtimin e plotë që për një periudhë 4 vjeçare të arrihet progres real në procesin reformues, në zgjidhjen e problemeve bilaterale dhe të brendshme, në avancimin e procesit të pajtimit pas krizave dhe luftërave që ka kaluar ky regjion.

Ballkani, sidomos ai Perëndimor, gjithnjë është karakterizuar si regjion i konflikteve dhe i rrezikut të sigurisë për Evropën. Andaj ky proces është në shërbim të bashkëpunimit dhe të kooperimit, në shërbim të paqes dhe të sigurisë.

Përmes Procesit të Berlinit është arritur: përkushtimi i të gjitha palëve për të thelluar bashkëpunimin ekonomik si platformë për zhvillim të gjerë; përkushtimi i vendeve të Bashkimit Evropian për anëtarësimin e tyre në BE; qeverisja e mirë dhe lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar; forcimi i shtetit të së drejtës dhe pavarësimi i sistemit juridik në vendet pjesëmarrëse; forcimi i demokracisë nëpërmjet fuqizimit të opozitës dhe krijimit të hapësirës për rolin e shoqërisë civile.

Faktorë të rëndësishëm të bashkëveprimit të vendeve të Ballkanit Perëndimor për të tejkaluar diferencat e tyre me vendet e BE-së konsiderohen:

- Stabiliteti makroekonomik;
- Progresi në reformat strukturore në ekonomi, dhe
- Integritet ekonomike.

Këto vende kanë nevojë për stabilitet makroekonomik, si parakusht të rritjes ekonomike dhe të integriteteve, të rritjes së sigurisë së investitorëve, por edhe të konsumatorëve, të promovimit të tregtisë, të investimeve dhe të zhvillimit të tregut të kapitalit. Në veçanti është i rëndësishëm stabiliteti fiskal për ekonomitë e vogla të hapura, siç janë ato të vendeve të Ballkanit Perëndimor, që cilësohen me fleksibilitet të kufizuar të politikave monetare, sidomos Kosova dhe Mali i Zi, dhe mjaft të ekspozuara ndaj ndikimeve të jashtme.

Progresi në reformat strukturore në ekonomi ndërlidhen me zhvillimin e sektorit privat, krijimin e vendeve të reja të punës, rritjen e efikasitetit ekonomik dhe të përkrahjes së këtyre vendeve që përmes

integritimeve të sigurojnë rritje të qëndrueshme ekonomike. Krahas të arriturave në liberalizimin e çmimeve dhe të procesit të privatizimit, transformimet strukturore ndërlidhen me nevojën e rritjes së konkurrueshmërisë dhe të aftësisë eksportuese, të qeverisjes korporative, të ristrukturimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe të efekteve të privatizimit. Në këtë drejtim, theksohet nevoja për të përmirësuar ambientin e të bërit biznes, sidomos për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Vlerësohet e rëndësishme që të zvogëlohet deficit i llogarive rrjedhëse të të gjitha vendeve të Ballkanit Perëndimor. Kosova ka arritur që në vitin 2015, 2016 dhe 2017 të sigurojë rritje mesatare vjetore ekonomike prej rreth 4%, që është më e larta krahasuar me vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor.

Vendeve të Ballkanit Perëndimor, si vende që janë pranë apo në fqinjësi me vendet e BE-së, do tu lehtësohet integriti ekonomik qoftë në tregun unik evropian apo edhe në tregjet botërore, përfshirë edhe tregun financiar. Integritet ekonomike parashihet të ulin koston e tregtisë, të përmirësojnë disponueshmërinë dhe zgjedhjen e të mirave dhe të shërbimeve dhe të qojnë në fuqizimin e furnizimeve për konsumatorët.

Modeli i rritjes ekonomike që kërkohet për vendet e Ballkanit Perëndimor është i bazuar në rritjen e sektorit privat, të investimeve, të eksportit, të tregjeve financiare, të aftësive dhe të mobilitetit të fuqisë punëtore, të tregjeve digjitale dhe të infrastrukturës.

Rritja e vazhdueshme e rëndësisë së politikave të energjisë ka krijuar nevojën e bashkëpunimit të vendeve të Ballkanit Perëndimor në kuadër të Komunitetit për Energji. Këto politika orientohen në drejtim të sigurisë së energjisë, efikasitetit, por edhe mbrojtjen klimatike ose ambientale. Për të arritur këto objektiva, Procesi i Berlinit përfshinë një varg masash dhe projektesh, si dhe involvim multilateral, përfshirë edhe nga organizatat financiare ndërkombëtare si Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), Banka Botërore (BB), Banka Evropiane për Investime (BEI), por edhe Komisioni Evropian (KE).

Nga Berlini në Londër

Procesi filloi në Berlin, në vitin 2014, dhe kishte një rëndësi të veçantë pas deklarimeve për marginalizimin e procesit të zgjerimit në agjendën evropiane. Platforma e takimit ndërlidhet me fushat specifike të bashkëpunimit rajonal të vendeve të Ballkanit Perëndimor, duke u ofruar një levë shtesë për integrimin e tyre në BE. Projektet e këtij takimi janë ato të ndërlidhjeve të transportit, dhe projektet me interes të komunitetit të energjisë.

Takimi i dytë i Procesit të Berlinit, në Vjenë, në vitin 2015, rezultoi me Marrëveshjen për prioritetet specifike në fushën e transportit regional dhe të energjisë. Krahas infrastrukturës së fortë, pakoja e konektivitetit përfshiu edhe pakon e butë, pra reformat specifike në fushën e transportit dhe të energjisë.

Takimi i Tretë, i organizuar në Paris, në vitin 2016, iu përkushtua bashkëpunimit rinor, si dhe sferës së transportit dhe të energjisë. Takimi fuqizoi idenë për rëndësinë e bashkëpunimit ekonomik ndërmjet vendeve të Ballkanit Perëndimor.

Takimi i Katërt i mbajtur në Trieste të Italisë, iu përkushtua Hapësirës së Përbashkët Ekonomike të vendeve të Ballkanit Perëndimor e cila nxit ndërlidhjen ndërmjet njerëzve, lehtëson tregtinë dhe lidhjet ekonomike, nxitë investimet e huaja direkte, avancojnë tregun digjital dhe lëvizjen e fuqisë punëtore ndërmjet këtyre vendeve. Në Trieste u paralajmërua tema e takimit të Pestë në Londër, e cila do t'i përkushtohet sigurisë, si një komponentë e rëndësishme, jo vetëm e paqes, por edhe e zhvillimit dhe e perspektivës për njerëzimin.

Projektet për Ballkanin Perëndimor nga Procesi i Berlinit Transporti

Që nga viti 2014, në BE është e aplikueshme politika konsoliduar e rrjetit të transportit ndërmjet 28 anëtarëve të BE-së, i quajtur rrjeti bazë i transportit transeuropian (TEN-T). Kjo politikë, ka pasur për qëllim që të shërbejë si shtyllë thelbësore e modelimit të transportit në kuadër të BE-së, duke synuar të evitohet fytyra e ngushta në transport, të

avancojë standardet e kualitetit të infrastrukturës transportuese, të lehtësojë qarkullimin ndërkufitar të pasagjerëve dhe të mallrave.

Në vitin 2015, harta e TEN-T është zgjeruar duke përfshirë edhe vendet e Ballkanit Perëndimor në kuadër të saj, përfshirë edhe financimin e disa projekteve infrastrukturore në vendet e Ballkanit.

Si rezultat i zgjerimit të hartës në Ballkanin Perëndimor, projektet me rëndësi direkte për të arritur standardin e TEN-T-së janë identifikuar dhe një pjesë e tyre kanë gjetur edhe financim direkt nga BE-ja.

Projektet me trajtim nga Procesi i Berlinit për sa i përket transportit përfshijnë:

- Financimin për ndërtimin e dy interkoneksioneve të autostradave ndërmjet Bosnjë e Hercegovinë dhe Kroacisë me 20% të vlerës grant i drejtpërdrejtë nga Komisioni Evropian;
- Financimin e rindërtimit të rrjetit hekurudhor R10 (Maqedoni-Kosovë-Serbi) ku Kosova ka përfituar grant në vlerë prej 48% të shumës së përgjithshme të investimit;
- Financimin për interkoneksionin hekurudhor ndërmjet Malit të Zi dhe Serbisë me grant prej 50% të shumës së përgjithshme të investimit.

Përveç këtyre financimeve të vendosura, mbeten të financohen dhe të studiohen edhe projekte të tjera. Në studim në kuadër të këtij procesi është edhe ndërtimi i Autostradës nga Nishi i Serbisë deri në kufi me Kosovën, po ashtu i financuar nga Komisioni Evropian.

Megjithatë, implementimi i këtyre projekteve është i ndërlidhur edhe me një listë të masave të buta që duhen aplikuar deri në vitin 2020. Këto masa janë të ndërlidhura me hapjen e tregut të transportit duke reformuar strategjitë hekurudhore të të gjitha vendeve të rajonit, duke ndërtuar sisteme të qëndrueshme, të sigurta, të besueshme dhe konkurruese të transportit dhe në fund, duke rritur efektivitetin e procedurave për kalimet kufitare.

Projektet dhe bashkëpunimi në fushën e transportit tanimë janë bërë obligime ndërkombëtare për të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor që nga Samiti i Triestes pasi që është nënshkruar edhe

Traktati i Komunitetit të Transportit dhe pritjet të ratifikohet nga parlamentet respektive.

Energjia

Bashkimi Evropian, përmes traktatit të Komunitetit të Energjisë ka politikë të konsoliduar kundrejt vendeve jo anëtare me të cilat synon të rrisë integrimin në sektorin e energjisë, që përfshin ndërtimin e rregullativës, të infrastrukturës së përshtatshme, si dhe liberalizimin e tregut të energjisë, me synim përfundimtar të krijimit të tregut të energjisë Pan-Evropian.

Në këtë kontekst, në kuadër të Procesit të Berlinit, për të arritur qëllimin e adresimit të politikave të energjisë rol dhe involvim të madh, si financiar ashtu edhe rregullativ, kanë luajtur organizatat financiare ndërkombëtare, por edhe Komisioni Evropian.

Sikur edhe tek infrastruktura, edhe në sektorin e energjisë janë paraparë dy lloj masash për të arritur qëllimin e një tregu Pan-Evropian, masat e buta apo rregulativa ligjore, si dhe masat e forta, apo investimet direkte në projekte energjetike.

Në kuadër të sektorit të energjisë, janë katër projekte nëpërmjet Procesit të Berlinit:

- Linja e interkoneksionit Shqipëri-Maqedoni, pjesa e rrjetit në Shqipëri, në vlerë të përgjithshme të investimit prej 70 milionë euro, e financuar me kredi të Bankës Zhvillimore Gjermane (KfW), dhe me 20% grant direkt nga Komisioni Evropian.
- Linja e interkoneksionit Shqipëri-Maqedoni, pjesa e rrjetit në Maqedoni, në vlerë të përgjithshme të investimit prej 49 milionë euro, e financuar nga BERZH-i, dhe me 24% grant direkt nga Komisioni Evropian
- Korridori Transballkanik i Energjisë, pjesa e rrjetit elektrik në Malin e Zi, me vlerë të investimeve 127 milionë euro, e financuar me kredi nga KfW dhe me grant prej 20% nga Komisioni Evropian.

- Korridori Trans-Ballkanik i Energjisë, pjesa e rrjetit elektrik në Serbi, me vlerë të investimeve 28 milionë euro, e financuar me kredi nga KfW dhe grant prej 24% nga Komisioni Evropian.

Përveç projekteve të financuara nga Procesi i Berlinit, ka pasur edhe projekte të tjera të cilat janë financuar nga institucionet financiare ndërkombëtare, sikur që është linja e interkoneksionit ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë në vlerë prej 75.5 milionë euro, e financuar nga KfW dhe tanimë e ndërtuar. Nga investimi i përgjithshëm prej 33.5 milionë euro në Kosovë, 50% e shumës ka qenë e dedikuar si grant nga Qeveria Gjermane, ndërsa pjesa tjetër kredi afatgjatë.

Megjithatë, linja ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë është ende jashtë funksionit si rezultat i mospërmbushjes së marrëveshjeve rajonale dhe bilaterale, sidomos marrëveshjes politike të energjisë ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

Funksionalizimi i këtij investimi ka rol tejet të rëndësishëm pasi që e rrit në masë të konsiderueshme kapacitetin transmetues të energjisë përtej kufijve dhe e rrit sigurinë dhe qëndrueshmërinë e furnizimit me energji elektrike në të dy vendet. Kjo është sidomos e rëndësishme kur merret parasysh se Kosova dhe Shqipëria kanë burime të ndryshme të prodhimit të energjisë, e para linjitet ndërsa e dyta kapacitetet hidroelektrike.

Politika e konsoliduar e BE-së është po ashtu e ndërlidhur edhe me masat e buta, të cilat kryesisht kanë të bëjnë me ndërmarrjen e masave të nevojshme për krijimin e tregut energjetik të Ballkanit. Po ashtu, në kuadër të masave të buta janë edhe bashkëpunimi rajonal në këmbimin energjetik, alokimi i kapaciteteve rajonale, dhe masa të tjera konkrete me afate kohore për vendet individuale në drejtim të liberalizimit të tregut.

Bashkëpunimi i të rinjve

Një ndër pikat e ngritura në Samitin e Vjenës më 2015 ka qenë edhe përfshirja në deklaratën e përbashkët të Kryeministrave të Ballkanit Perëndimor e përkushtimit dhe e pajtueshmërisë për

themelimin e Zyrës Rajonale për Bashkëpunim Rinor (RYCO), e cila është ndërtuar mbi konceptin e suksesshëm të bashkëpunimit rinor ndërmjet Francës dhe Gjermanisë, por edhe praktikave të tjera në vendet e BE-së. Në themelimin e kësaj zyre, hartimin e objektivave dhe të aktiviteteve ka luajtur rol thelbësor pikërisht Zyra për Bashkëpunim Rinor Franko-Gjermane. Në Samitin e Parisit në vitin 2016 është nënshkruar marrëveshja për themelimin e Zyrës për Bashkëpunim Rinor nga të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor dhe tani më, është ratifikuar nga një numër i këtyre vendeve, duke e bërë implementimin e saj obligim ndërkombëtar.

Ndërtimi i kësaj zyre ka ardhur si nevojë e tejkalimit të sfidave të përbashkëta, sfida këto të cilat janë thelluar edhe më shumë si rezultat i luftërave në dekadat e kaluara. Të gjitha këto konflikte, sfida dhe mungesa e tolerancës ndërmjet grupeve të ndryshme etnike kanë sjellë edhe paragjykime. Në këtë aspekt, si të përbashkëtat e të gjithë të rinjve janë identifikuar dhjetëra probleme duke përfshirë papunësinë në nivele shumë të larta në të gjitha vendet, ikjen e trurit përmes procesit të migrimit, barrierat administrative për bashkëpunim, mungesën e besimit dhe të solidaritetit ndërmjet të rinjve, mungesën e informatave e shumë probleme të tjera që janë në agjendën e aktiviteteve të RYCO-s.

Qëllim thelbësor i RYCO-s është ndërtuar të jetë procesi i pajtimit, i bashkëpunimit ndërmjet të rinjve të Ballkanit Perëndimor përmes programeve të ndryshme të këmbimit të të rinjve.

Themelimi i RYCO-s është parë si instrument i cili e vendos në plan të parë pajtimin, bashkëpunimin dhe fqinjësinë, se në shumë vende të tjera të BE-së, koncepte të tilla kanë funksionuar në përmirësimin e marrëdhënieve ndërmjet shteteve.

Siguria

Sfidat e ngritura të sigurisë, sidomos gjatë vjetëve 2015-2016, kanë qenë pjesë substanciale e diskutimeve në kuadër të Procesit të Berlinit. Agjenda e Samitit të ardhshëm pritet të jetë me theks të veçantë në çështjet e sigurisë dhe të luftimit të terrorizmit. Në këtë fushë, nuk ka pasur ndonjë

aktivitet konkret në kuadër të Procesit të Berlinit, përveç të këmbimit të përvojave dhe të koordinimit të vendeve të rajonit në trajtimin e valëve të refugjatëve nga Lindja e Mesme në drejtim të Evropës.

Hapësira Ekonomike Rajonale

Ndër përfundimet kryesore të të gjitha takimeve të Procesit të Berlinit ka qenë edhe theksimi i nevojës për të rritur bashkëpunimin ekonomik ndërmjet vendeve të rajonit. Kjo sidomos, kur merren parasysh barrierat jotarifore të cilat aplikohen kohë pas kohe nga vendet anëtare të CEFTA-s. Si rrjedhojë e kësaj shtate, është lansuar ideja për krijimin e një tregu të përbashkët të vendeve të Ballkanit Perëndimor. Ky treg i përbashkët, në fillim është përcjellë më nivel të konsiderueshëm të paqartësive, sidomos sa i përket rolit të politikave ekonomike të vendeve anëtare, por po ashtu, rolin e agjencive shtetërore që merren me çështje të ekonomisë, si për shembull, rolin e doganave. Fillimisht është diskutuar opsioni i shtytjes përpara të idesë për union doganor, por kundërshtimet e Kosovës dhe të Malit të Zi kanë sjellë një version të quajtur Hapësira Rajonale Ekonomike. Kjo hapësirë, është mbështetur në Samitin e Triestes me deklaratat e kryeministrave të Ballkanit. Rrjedhimisht, këtu nuk bëhet fjalë për Tregun e përbashkët të vendeve të Ballkanit Perëndimor, e aq më pak për Union Doganor, por për një plan të përbashkët të veprimit të vendeve të Ballkanit Perëndimor për sa i përket:

- **Tregtisë**, ku palët pajtohen se do të fuqizojnë përpjekjet për implementim të suksesshëm të marrëveshjes së CEFTA-s dhe protokolleve shtesë, për të konkluduar edhe me tregtinë në shërbime.
- **Investimeve**, ku palët akordohen për të hartuar një agjendë rajonale të investimeve, e cila përfshinë këmbimin e praktikave më të mira për politikën e investimeve, por edhe harmonizimin e tyre.
- **Lëvizjes së lirë**, ku të gjitha palët pajtohen për të eliminuar çfarëdo lloj pengese për lëvizjen e profesionistëve, si dhe në njohjen reciproke të kualifikimeve profesionale.

- **Tregut Digjital**, ku palët pajtohen që të rrisin bashkëpunimin për të forcuar shpërndarjen e infrastrukturës së teknologjisë së informacionit, të sigurisë së TI-së dhe të mbrojtjes së të dhënave.

Përfundim

1. Procesi i Berlinit ka kontribuar në shtendosjen e marrëdhënieve dhe të proceseve të vendeve të Ballkanit Perëndimor. Rrugën drejt konflikteve e ka orientuar në rrugë të bashkëpunimit dhe të mirëkuptimit.

Ky proces ka siguruar një lidhje të nivelit të lartë të komunikimit të rregullt ndërmjet liderëve dhe institucioneve të Ballkanit Perëndimor me ato të vendeve të fuqishme të BE-së, para së gjithash të Gjermanisë, të Francës, të Italisë, të Austrisë.

Me marrëveshjen për bashkëpunim rinor, pretendohet të zbatohen përvojat nga procesi i pajtimit ndërmjet Gjermanisë dhe Francës, të adoptuara me rrethanat e kohës dhe të diversitetit të kulturave të popujve në Ballkanin Perëndimor, duke u bazuar në gjeneratën e re.

2. Procesi ka nxitur vendet e Ballkanit Perëndimor të ndërtojnë infrastrukturë fizike rrugore e hekurudhore, lidhje me transport ajror dhe bashkëpunim ekonomik me avancim të tregjeve digjitale, të gjitha këto, në suaza të standardeve të BE-së. Kjo do të mundësojë ndërlidhjen pa probleme në të ardhmen e këtyre vendeve me vendet e BE-së.

Procesi ka rezultuar deri më tani me disa marrëveshje konkrete për të gjitha vendet pjesëmarrëse sikurse janë:

- a. Traktati i Komunitetit të Transportit;
- b. Traktati i Komunitetit të Energjisë.
- c. Themelimi i zyrës për Bashkëpunim Rinor

3. Procesi i Berlinit ka nxitur bashkëpunimin tregtar dhe ekonomik ndërmjet vendeve të BE-së, organizimin e përbashkët për tërheqje të investimeve të huaja direkte; thjeshtëzimin e procedurave burokratike dhe uljen e kostos së bizneseve, si rezultat i investimeve në infrastrukturën rrugore, hekurudhore, ajrore, energjetike dhe të telekomunikimeve elektronike.

- Po ashtu është fokusuar edhe në infrastrukturën e butë, atë ligjore, duke siguruar rregulla dhe standarde të përbashkëta të këtyre vendeve me ato të BE-së.
4. Procesi i Berlinit ka dëshmuar njohjen e plotë të sovranitetit shtetëror të Republikës së Kosovës, duke pasur parasysh se, në këtë proces, Kosova është trajtuar krejtësisht e barabartë me vendet e tjera;
Procesi ka nevojë të mbështetet nga vendet e fuqishme të BE-së dhe assesi të rikthejë dominimin politik dhe ekonomik të ndonjë vendi të Ballkanit Perëndimor.
 5. Motivet e vendeve në Ballkan nuk janë identike. Përderisa grupi më i madh i vendeve të rajonit ka prirje të qartë drejt integriteteve Euroatlantike. Prandaj ky proces duhet të bashkërenditet dhe menaxhohet nga qendra të fuqishme të BE-së, të cilat do të mundësojnë lëvizjen koherente të këtyre vendeve drejt integritetit në BE, kurse implementimi i tij të jetë në pronësi rajonale.
 6. Edhe pse ka zëra se Procesi i Berlinit në mënyrë të heshtur shërben si një zëvendësim i përkohshëm i procesit të zgjerimit të BE-së, është argumentuar se ky proces nuk mund të shërbejë si një paradhomë e mbajtjes së këtyre vendeve në pritje të plotësisht të kushteve për anëtarësim në BE, por se çdo vend duhet të plotësojë kushtet veç e veç, si vende sovrane.

LËVIZJA E TREGUT ENERGJETIK TË KOSOVËS DREJT TREGUT RAJONAL DHE E ARDHMJA E TIJ NË TREGUN EVROPIAN

Justina Sh. Pula¹ dhe Adhurim Haxhimusa²

Abstrakti

Republika e Kosovës me qëllim të eliminimit të problemeve të saja energjetike ka bërë përpjekje për harmonizimin e politikave energjetike, të kërkuara nga direktivat e KE-së, me qëllim të integritimit në tregun energjetik rajonal dhe Evropian. Duke e pasur parasysh volatilitetin e madh në ngarkesë, ne tregojmë se integrimi në tregun rajonal, e sidomos me atë shqiptarë, sjellë përfitime të mëdha në sigurinë me furnizim stabil me energji elektrike dhe në stabilizimin e sistemit elektroenergjetik në Kosovë.

Fjalë çelës: Energjia elektrike, Integrimi i tregut, Burimet e ripërtëritshme, Miksi i teknologjive të gjenerimit.

Hyrje

Kosova është shteti më i ri në Evropë. Formimi i institucioneve të qëndrueshme, zhvillimi i një shoqërie demokratike dhe zhvillimi ekonomik i qëndrueshëm janë sfidat kryesore me të cilat përballen Republika e Kosovës. Institucionet e reja kosovare po përballen me vështirësi të shumta nga presioni i një shoqërie të re³ (mosha mesatare 29 vjeç (CIA, 2016)) për të marrë vendime të shpejta për të ndryshuar gjendjen ekonomike dhe sociale në Kosovë. Mungesa e energjisë elektrike në “shekullin e botës së ndërlidhur përmes internetit“ që nga paslufta (viti 1999) ngriti shumë herë zërin e shoqërisë kosovare për furnizim stabil me energji elektrike. Mungesa e furnizimit stabil me

¹ Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Ekonomik, rr. Agim Ramadani p.n. Prishtinë 10000, Republika e Kosovës, justina.pula@uni-pr.edu

² Vienna University of Economics and Business, Research Institute for Regulatory Economics, Welthandelsplatz 1, 1020 Vienna, Austria, +43 1 31336 6336, adhurim.haxhimusa@wu.ac.at

³ Ky presion vjen kryesisht nga emigrimi ilegal i rinisë kosovare drejt shteteve të Evropës perëndimore.

energji elektrike dhe fakti se Kosova ka mbi 12 miliardë ton qymyr është një paradoks në vetvete. Të dyja, së pari institucionet e përkohshme nën administrimin e UNMIK-ut (United Nations Interim Administration Mission in Kosovo) dhe ato pas shpalljes së Pavarësisë, kanë tregu mungesë totale të vullnetit dhe vizionit në zgjidhjen e këtij problemi.

Samiti i organizuar nga Konferenca e Kombeve të Bashkuara për Ndryshime Klimatike në dhjetor të vitit 2015 në Paris bëri shumë të qartë se zgjidhja e problemeve të energjisë duhet të koordinohet me politikat e ruajtjes së ambientit. Kosovës kjo mund t'i shkaktojë kokëçarje më së shumti në rajon për shkak të varësisë së saj në linjit.⁴ Në dekadën e fundit, vendet e Bashkimit Evropian (BE) në pajtim me direktivat e Komisionit Evropian (KE) (Directive 96/92/EC, Directive 2003/54/EC and Directive 2009/72/EC), sidomos Gjermania,⁵ Danimarka, Spanja, Italia dhe Britania e Madhe, implementuan skema shumë të përshtatshme për përkrahjen e investimeve që mundësojnë shfrytëzimin e burimeve të ripërtëritshme të energjisë elektrike (BRE) (p.sh. erës, solare, gjeotermike, etj.) (Eurostat, 2016). Kjo ka bërë të qartë se shfrytëzimi i linjitet nuk është zgjidhje e qëndrueshme e problemeve me furnizim të energjisë elektrike. Kur kësaj i shtojmë faktin se Republika e Kosovës ka shprehur hapur aspiratat e saj për anëtarësim në familjen e BE-së, atëherë institucionet kosovare duhen shpejtuar në hartimin e një strategjie e cila i ka parasysh zhvillimet e fundit në politikat klimatike dhe energjetike të BE-së. Republika e Kosovës është njëherësh nënshkruese e Traktatit të Komunitetit të Energjisë. Ky është një hap i rëndësishëm në harmonizimin e legjislacionit kosovarë të energjisë me atë të BE-së. Nënshkrimi i këtij traktati njëherësh është detyrim i Kosovës t'iu përmbahet obligimeve që vijnë nga direktivat e KE-së (Directive 96/92/EC, Directive 2003/54/EC and Directive 2009/72/EC). Këto direktiva synojnë të dizajnojnë një treg eficient, konkurrues dhe të qëndrueshëm, por njëherësh edhe të harmonizojnë tregjet nacionale brenda BE-së.

Vendet e BE-së për momentin janë duke u përballur me një presion të madh për integritet sa më të shpejtë të tregjeve të energjisë

⁴ Kosova gjeneron rreth 97% të energjisë elektrike nga gjeneratorët që burim primar kanë qymyrin (Ministria e Zhvillimit Ekonomik, 2012).

⁵ Linjiti furnizon rreth 45% të prodhimit total të energjisë elektrike në Gjermani.

elektrike dhe kalim sa më të shpejtë nga shfrytëzimi i qymyrit dhe energjisë atomike në ato të BRE-ve. Si integrimi i tregjeve po ashtu edhe zhvillimi i BRE-ve janë duke i sfiduar shumë vende të BE-së për shkak të përfitimeve ekologjike dhe ekonomike që vijnë nga ulja e çmimit në bursat e energjisë (i njohur si “merit-order effect”) por njëherësh edhe sfidat⁶ që shoqërohen me zhvillimin e BRE-ve. Në këtë rrugë është futur edhe Kosova e posaçërisht pas Samitit të Vjenës të 2015-ës. Nga ky samit, 6 shtetet e Ballkanit Perëndimorë (WB6), duke përfshirë Kosovën, janë zotuar të rrisin kapacitetet e transmisionit dhe interkoneksionit, të themelojnë bursën e energjisë dhe tregun e përbashkët të balancimit të sistemit të energjisë elektrike (Western Balkan Summit Vienna 2015, 2015). Këto do të duhej të mundësonin krijimin e një tregu të përbashkët rajonal. Krijimi i tregut rajonal Ballkanik po ashtu kërkon harmonizimin e politikave nacionale të energjisë dhe zhvillimin e një kornize të përbashkët rregullative.

Problematika të cilën ne në këtë punim duam ta diskutojmë është se cila është gjendja e tregjeve të energjisë në BE dhe në Kosovë dhe cilat janë përfitimet që Kosova do të mund t’i marrë nga integrimi në tregun energjetik rajonal dhe në atë të BE-së?

Struktura e këtij punimi është si në vazhdim. Seksioni i dytë tregon për gjendjen aktuale të sektorit elektroenergjetik në Kosovë. Në seksionin e tretë, ne flasim më shumë për integrimin e tregjeve ku në pjesën e dytë fokusohemi kryesisht në Kosovë dhe rajon. Në seksionin e katërt janë shkruar përfundimet që vijnë nga ky studim.

⁶ Gjenerimi i energjisë elektrike nga BRE-të, veçanërisht nga ajo e erës, është shumë i paqëndrueshëm. Investimet e shumta në këtë teknologji janë duke i rritur shpenzimet për balancim dhe ruajtje të stabilitetit të rrjetit (EWEA, 2015). Në anën tjetër, rrjeti tradicional i transmisionit nuk është plotësisht në përputhje me shpërndarjen hapësinore (gjeografike) të investimeve në BRE. Ky është një problem aktual në zonën Gjermano-Austriake, ku për shkak të mungesës së kapaciteteve të transmisionit energjia e erës e prodhuar në veri të Gjermanisë nuk po mund të transportohet në jug të Gjermanisë dhe në Austri. Si pasojë sistemi Polak dhe Çek i transmisionit kanë pasur problem me rrjedhën e energjisë elektrike që është dashur ta përcjellin nga Gjermania për në Austri (ACER, 2015).

Gjendja aktuale e sektorit elektroenergjetik në Republikën e Kosovës

Që nga paslufta, qytetarët e Republikës së Kosovës janë përballur me ndërprerje të mëdha të energjisë elektrike. Për fat të mirë, pas shumë ndryshimeve strukturore në sistemin elektroenergjetik duke përfshirë edhe privatizimin e rrjetit të distribucionit gjendja e furnizimit është përmirësuar dukshëm, mirëpo ai ende nuk ka stabilitet të qëndrueshëm (ZRRE, 2015).

Republika e Kosovës qysh nën administrimin e UNMIK-ut ka filluar të harmonizojë sistemin elektroenergjetik me atë të BE-së. Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRE) është themeluar në vitin 2004 e përcjellë me themelimin e Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Tregut (KOSTT) nga shthurja e KEK-ut.⁷ Procesi i shthurjes përfundoi me privatizimin e shpërndarjes dhe furnizimit në vitin 2013 dhe me shthurjen e tyre në KEDS dhe CESCO në vitin 2015. Shthurja e KEK-ut është një hap shumë i rëndësishëm në rritjen e konkurrencës si në gjenerim ashtu edhe në furnizim (Jamasb & Pollitt, 2005). Mirëpo Kosova është duke çaluar në përfundimin e procesit të liberalizimit të tregut të energjisë. Sipas ZRRE (2015) janë disa pengesa për liberalizimin e tregut, si p.sh. mungesa e kapaciteteve të mjaftueshme të gjenerimit, varësia e theksueshme nga importet, fleksibilitet i kufizuar i kapaciteteve gjeneruese (sidomos termocentralet A dhe B), humbje të mëdha teknike (në shpërndarje) dhe komerciale, mungesa e qasjes në veri të Kosovës dhe mospranimi i KOSTT si anëtare me të drejta të plota në ENTSO-E (European Network of Transmission System Operators for Electricity). Përpos pengesës së fundit e cila është politike, pengesat e tjera varen nga vendimet që sjellin institucionet kosovare për përshpejtimin e investimeve në kapacitetet e reja gjeneruese qoftë në linjit apo edhe BRE.

⁷ Shthurja (unbundling në anglisht) e aktiviteve të transmisionit në njërin anë dhe të gjenerimit, të shpërndarjes dhe të furnizimit në anën tjetër, është një detyrim që vjen nga direktiva e parë dhe e dytë (96/92/EC dhe 2003/54/EC).

Siç e cekëm më lart, Kosova nga nënshkrimi i Traktatit të Komunitetit të Energjisë duhet t'i përmbushë obligimet që vijnë nga direktivat e KE-së. Kështu, Këshillimi i Ministrave të Komunitetit të Energjisë e detyroi Kosovën që deri në vitin 2020, 25% të konsumit të energjisë duhet të jetë nga BRE-të. Institucionet kosovare, me qëllim të mbështetjes dhe të përshpejtimit të investimit në BRE dhe të përmbushjes së kritereve që dalin nga direktiva e BRE-ve (2009/28/EU), kanë implementuar tarifatat nxitëse (të njohura si feed-in tariff). ZRRE (2015) raporton se në fillim të vitit 2015 janë pranuar në skemën mbështetëse ndërtimi i gjeneratorëve të ndryshëm për prodhimin e energjisë elektrike nga era, uji dhe dielli në kapacitet total prej rreth 2818 MW (Mega Watt). Ndërtimi i këtyre kapaciteteve të reja është i rëndësishëm për arsye se (1) rrit kapacitetin gjenerues të Kosovës (2) rrit konkurrencën midis gjeneruesve të energjisë elektrike dhe (3) rrit fleksibilitetin në zgjedhjen e gjeneratorëve më të përshtatshëm dhe me kosto më të ulët për balancimin e sistemit.

Ndërtimi i kapaciteteve të reja gjeneruese nga linjiti ka mbetur edhe më tej një enigmë e pazgjidhur për institucionet kosovare. Ato patën dhënë zotimin se me mbylljen e termocentralit Kosova A në vitin 2017, termocentrali Kosova e Re do të fillojë gjenerimin e energjisë elektrike. Tani jemi në pjesën e dytë të vitit 2017 dhe ende vendimi për ndërtimin e këtij impianti nuk është marrë. Pra, qytetarët e Republikës së Kosovës fatkeqësisht duhet ta pranojnë faktin se edhe nëse fillon ndërtimi i këtij impianti ata edhe rreth pesë vjet pas fillimit të ndërtimit do të thithin tymin e Termocentralit Kosova A.⁹ Çështja e ndërtimit të termocentralit Kosova e Re duhet zgjidhur sa më shpejtë që është e mundur për shkak të ndotjes së madhe që po e bëjnë kapacitetet e vjetruara gjeneruese dhe efekteve negative në shëndetin e qytetarëve kosovarë (Banka Botërore, 2012).

⁸ Rreth 148 MW janë nga era dhe 133 MW nga uji.

⁹ KOSID (2017) ka publikuar një raport të detajuar për prolongimin e ndërtimit të Termocentralit Kosova e Re.

Kur flitet për sektorin elektroenergjetik, vend të veçantë zë rrjeti i transmisionit. Gjermania është një shembull tipik se politikat e rregullatorit për të përkrahur investimet në rrjetin e transmisionit nuk janë në përputhje me politikat e përkrahjes së BRE-ve.¹⁰ Si pasojë, sistemet e transmisionit në Gjermani janë të detyruara që gjatë tërë kohës të bëjnë ridizajnimin hapësinor të prodhimit dhe të rrjedhës së energjisë elektrike. Kjo ka shkaktuar kosto prej afër 700 milionë Euro në vitin 2016.¹¹ Në këtë aspekt, Kosova duhet të ketë parasysh shpërndarjen gjeografike të BRE-ve, rrjetin e transmisionit dhe qendrat e konsumit, ashtu që të mund të bëjë transportin e energjisë elektrike nga gjeneratorët deri te konsumatorët.

Fatkeqësisht, KOSTT nuk po mundet të anëtarësohet në ENTSO-E, si pasojë e bllokadës që po i bëhet nga operatori i transmisionit të Serbisë. Si rrjedhojë, KOSTT nuk e bën alokimin e resurseve të interkoneksionit dhe arkëtimin e të hyrave përkatëse. Po ashtu investimi në linjën e re (400KV) të interkoneksionit midis Kosovës dhe Shqipërisë nuk është futur ende në funksion. Kjo përpos që e rrit koston e këtij projekti, i shkakton humbje financiare dy operatorëve të transmisionit, atij të Kosovës dhe Shqipëri për çdo orë të mosfunksionimit nga mungesa e alokimit të resurseve të interkoneksionit. Në të njëjtën kohë, siguria e furnizimit me energji elektrike është shumë më e ulët dhe konsumatorët po paguajnë çmim më të lartë ose më të ulët varësisht nga rrjedha e energjisë elektrike.

Integriti i tregjeve të energjisë elektrike

Përvojat nga BE-ja

Tregjet evropiane të energjisë gjenden në procesin e integritit. KE-ja kishte vendosë një objektiv shumë të qartë mirëpo jo edhe aq real në relacion me kohën, kur raportoi se tregjet e energjisë elektrike në Evropë do të jenë plotësisht të integruara qysh në fillim të vitit 2014. Hulumtimet e fundit empirike tregojnë se mbetet shumë punë për tu

¹⁰ Shih fusnotën 4

¹¹ <https://www.netztransparenz.de/EnWG/Redispatch>

bërë që ky objektiv të arrihet (Böckers et al., 2013; Gugler et al., 2016; Pellini, 2012; Zachman, 2008). Sipas Gugler & Haxhimusa (2016) dhe Grossi et al. (2015), midis vendeve të BE-së ekziston edhe më tej një mospërputhje e madhe në politikat e energjisë. Integrimi i tregjeve të BE-së është një kompetencë e KE-së, ndërsa politikat e energjisë janë të decentralizuara në nivel nacional. Zgjedhja e teknologjive të gjenerimit dhe siguria e furnizimit me energji është kompetencë e qeverive të vendeve të BE-së. Si rezultat, shumë vende të BE-së, si pasojë e mungesës së nxitjeve adekuate për investime në kapacitete shtesë të gjenerimit (kjo nuk vlen për BRE-të) dhe të frikës se në të ardhmen mund të kenë probleme me sigurinë e furnizimit, kanë implementuar mekanizma të ndryshëm, ashtuquajturat “capacity remuneration mechanism”. Përmes këtyre mekanizmave disa nga kapacitetet gjeneruese, të cilat nuk janë më profitabile dhe nuk mund të qëndrojnë në treg, marrin një shumë të caktuar vetëm e vetëm që të jenë të gatshme të gjenerojnë energji elektrike atëherë kur vendi ka mungesë të saj. Pse është me rëndësi që politikat e energjisë të vendeve të BE-së të jenë të harmonizuara me politika e energjisë të hartuara nga KE-ja kur tregjet po integrohen çdo ditë e më shumë? Grossi et al. (2015) i ka vlerësuar efektet negative të vendimeve të njëanshme të vendeve të BE-së në fqinjët e tyre, me theks të veçantë në daljen e Gjermanisë nga energjia bërthamore dhe rritja e kapaciteteve gjeneruese nga BRE-të. Ata vlerësojnë se një pjesë të madhe të kostos po e bartin shtetet fqinje të Gjermanisë.¹² Në të njëjtën kohë Gugler & Haxhimusa (2016) vlerësojnë empirikisht se ndryshimet në teknologjitë e gjenerimit kanë edhe një efekt në nivelin e integritit të vendeve të BE-së. Po ashtu, Gugler et al. (2016) dhe Keppler et al. (2016) vlerësojnë se integrimi i BRE-ve ka pasur ndikim negativ në integrimin e tregjeve të BE-së. Për këtë kërkohet që politikat e energjisë së vendeve të BE-së të jenë në koordinim me themelimin e një tregu të vetëm Evropian të energjisë.

¹² Haxhimusa (2017) vlerëson se BRE-të mund të kenë edhe efekt stabilizues në sistemin energjetik të vendeve fqinje. I tërë ky efekt varet nga pjerrësia e lakores së ofertës dhe nga niveli i kërkesës në vendet fqinje.

*Integrimi i tregjeve të energjisë elektrike
të vendeve të Ballkanit Perëndimor*

Austria, Gjermania, Franca, Italia dhe Mbretëria e Bashkuar dhe gjashtë vendet e WB6 në bashkëpunim me KE-në dhe me Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë kanë vendosur të rrisin kapacitetet e transmisionit dhe interkoneksionit, themelimin e bursës së energjisë dhe tregun e përbashkët të balancimit të sistemit të energjisë elektrike në WB6. Ky proces është nën vëzhgimin konstat të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë me seli në Vjenë. Mirëpo ky institucion nuk ka të drejtë ekzakutive, por është vetëm vëzhgues dhe koordinues i këtij procesi, çka bën që i tërë ky proces të jetë nën vullnetin e vendeve të influencuara. Të gjitha zhvillimet, të cilat u përmendën më lart lidhur me integrimin e tregjeve energjetike të BE-së duhen pasur parasysh edhe në procesin e integritit të tregjeve energjetike të WB6.

Në këtë seksion është me rëndësi të shpalojmë përparësitë dhe mangësitë e integritit të tregjeve të energjisë, të cilat literatura i ka shpalosë në të kaluarën. Meqenëse vendet e WB6, e sidomos Kosova dhe Shqipëria, kanë probleme me furnizim të rregullt me energji elektrike, integrimi i tregjeve do të siguronte qasje në një portfolio më të gjerë dhe të diversifikuar me kapacitete gjeneruese. Në vazhdim, në Tabelën 1 po japim një pasqyrë të kapaciteteve aktuale gjeneruese sipas teknologjisë së prodhimit të vendeve të WB6 bazuar në të dhënat nga Energy Community Secretariat (2016). WB6 është një rajon relativisht i vogël me rreth 16GW kapacitete gjeneruese.¹³ Është e dukshme se afërsisht 50% e kapaciteteve gjeneruese janë termocentrale me fleksibilitet jashtëzakonisht të ulët, por me gjenerim konstant, dhe 50% e kapaciteteve janë hidrocentrale me fleksibilitet relativisht të lartë me fluktuacion sezonal. Këto teknologji i plotësojnë jashtëzakonisht mirë njëra tjetrën dhe si rezultat të gjitha vendet e WB6 do të përfitonin nga integrimi i tyre i cili do të rriste sigurinë e sistemit elektroenergjetik dhe të furnizimit me energji elektrike. Për më shumë, integrimi do të

¹³ Sa për krahasim, Austria i ka rreth 22GW kapacitete gjeneruese nga teknologji të ndryshme.

ndikonte në zvogëlimin e kostove nga mbajtja e kapaciteteve rezervë, të cilat janë të domosdoshme për të rritur sigurinë e furnizimit dhe të stabilitetit të rrjetës (Agora-Energiewende, 2015). Nga Tabela 1 mund të shihet qartë se Kosova dhe Shqipëria janë të vetmet të cilat pothuajse fare nuk e kanë të diversifikuar miksin e teknologjive të gjenerimit dhe si pasojë të dyja kanë një siguri të brishtë të stabilitetit të rrjetit dhe furnizimit të rregullt me energji në sezone të ndryshme (dimër/verë). Prandaj Kosova dhe Shqipëria, me diversitet zero të miksit të teknologjive të prodhimit, do të përfitonin jashtëzakonisht shumë nga futja në funksion e linjës së re të transmisionit. Kjo linjë e transmisionit do të mundësonte që këto dy tregje të jenë pothuajse plotësisht të integruara dhe kështu të plotësonin njëra tjetrën duke e diversifikuar miksin e përbashkët të teknologjive të gjenerimit. Kjo njëherësh ndikon në rritjen e konkurrencës midis prodhuesve të energjisë elektrike duke i shtyrë ata të rrisin efikasitetin ashtu që të dalin me çmim më të ulët se konkurrenca e sidomos gjatë kohës kur ngarkesa është e ulët dhe ka mjaft prodhues potencial për të gjeneruar. Një fenomen interesant dhe jo intuitiv mund të ndodhë nga presioni i prodhuesve të energjisë së ujit që vjen nga operatorët e shtetit shqiptarë, e cila mund t'i detyrojë termocentralet kosovare me fleksibilitet të ulët të ofrojnë çmime negative për orë të caktuara kur ngarkesa është e ulët vetëm e vetëm që t'i mos ndalin gjeneratorët (Sensfuß, 2007).

Figura 1 tregon profilin e ngarkesës për vendet e WB6 por edhe për të gjithë rajonin, d.m.th. WB6, për secilin muaj të vitit 2016. Nga kjo figurë shihet qartë se të gjitha vendet e WB6 kanë pothuajse profil të ngjashëm të ngarkesës nëpër secilin sezon. Përfitimet më të mëdha të integritetit janë atëherë kur profilet e ngarkesës, por edhe të gjenerimit nuk janë edhe aq të ngjashme. P.sh. në Figurën 1 mund të shihet se Kosova me dy vendet e saj fqinje, Shqipërinë dhe Malin e Zi, ka profile të ndryshëm të ngarkesës gjatë sezonit turistik në këto dy vendet e fundit.

Tabela 1. Kapacitetet gjeneruese aktive sipas teknologjisë, në MW për vitin 2016

| Vendi | Termocentrale | | Ujë | | Erë | | Solare | | Totali |
|------------------|---------------|--------------|----------------|--------------|--------------|-------------|--------------|-------------|-----------------|
| <i>Shqipëria</i> | 0 | 0.0% | 1797 | 100.0% | 0 | 0.0% | 0 | 0.0% | 1797 |
| <i>B&H</i> | 1856 | 46.2% | 2150 | 53.5% | 0 | 0.0% | 9 | 0.2% | 4015 |
| <i>Kosova</i> | 1171 | 95.8% | 49 | 4.0% | 1 | 0.1% | 0 | 0.0% | 1222 |
| <i>Maqedonia</i> | 800 | 51.5% | 699 | 45.0% | 37 | 2.4% | 17 | 1.1% | 1553 |
| <i>Mali i Zi</i> | 219 | 24.6% | 668 | 75.4% | 0 | 0.0% | 0 | 0.0% | 887 |
| <i>Serbia</i> | 3905 | 57.3% | 2898 | 42.5% | 1 | 0.0% | 11 | 0.2% | 6814 |
| WB6 | 7950.5 | 48.8% | 8261.42 | 50.7% | 38.95 | 0.2% | 36.31 | 0.2% | 16287.18 |

**Figura 1. Ngarkesa mujore për secilin vend të WB6 për vitin 2016**

Burimi: Të dhënat për Kosovën janë marrë nga ZRRE (2015), ndërsa për vendet e tjera të WB6 nga ENTSO-E.

Për më tepër, nga Figura 2 shihet se Kosova dhe Shqipëria kanë profile të ndryshme edhe të gjenerimit, p.sh. gjatë muajit qershor dhe korrik Kosova ka tepricë të energjisë elektrike, ndërsa Shqipëria ka mungesë të saj. Kjo vjen si rezultat i varësisë totale të Shqipërisë nga energjia e ujit, ku gjatë verës prurjet e ujit janë shumë më të vogla se gjatë pranverës ose dimrit. Ndërsa Kosova me kapacitetet e saj gjeneruese nga thëngjilli, mund të furnizoj gjatë kësaj kohe Shqipërinë me energji elektrike. Vërehet se gjatë muajit gusht të vitit 2016 në Kosovë ngarkesa ka qenë më e lartë se gjenerimi. Gjatë kësaj kohe ngarkesa është me e ulët (shih Figurën 1 dhe 2) dhe zakonisht termocentralet ndalin punën për të bërë kontrollet/riparimet e planifikuara të nevojshme për përgatitje për sezonin e dimrit kur ngarkesa është më e lartë. Me integrimin e tregjeve, dhe me rritjen e kapaciteteve gjeneruese si për Kosovën ashtu edhe për Shqipërinë rritet edhe siguria e furnizimit dhe e sistemit elektroenergjetik. Në këtë mënyrë disa nga termocentralet e Kosovës mund t'i bëjnë kontrollet e planifikuara edhe gjatë periudhës kur në Shqipëri ka mjaft ujë për të siguruar furnizim të mjaftueshëm me energji elektrike si për Shqipërinë ashtu edhe për Kosovën (p.sh. shkurt dhe mars – shih Figurën 2). Kjo bën të mundur që gjatë sezonit turistik, atëherë edhe kur gjenerimi i energjisë elektrike nga hidrocentralet është shumë i ulët (shih Figurën 2), termocentralet e Kosovës mund të gjenerojnë pandërprerë energji elektrike dhe në këtë mënyrë të sigurojnë furnizim të mjaftueshëm të energjisë elektrike për të dy vendet.




Figura 2. Gjenerimi i energjisë elektrike dhe ngarkesa gjatë vitit 2015 sipas muajve.

Burimi: Të dhënat janë marrë nga rregullatorët e energjisë së Kosovës¹⁴ dhe të Shqipërisë¹⁵.

¹⁴ http://ero-ks.org/2016/Raportet/Raporti_Vjetor_2015_ZRRE_shq.pdf

¹⁵ <http://www.ere.gov.al/mat.php?idr=283&idm=635&lang=1>

Në Tabelën 2, ne bëjmë një përmbledhje statistikore të ngarkesës për vendet e WB6. Siç shihet Serbia ka tregun energjetik më të madh në rajon, ndërsa Mali i Zi më të voglin. Nga Tabela 2 mund të shohim nga devijimi standard i ngarkesës se tregjet e energjisë elektrike karakterizohen me një volatilitet të madh të ngarkesës. Si rrjedhojë, integrimi i këtyre tregjeve do të mundësonte stabilitet të lartë të sistemit elektroenergjetik dhe të sigurisë së furnizimit me energji elektrike.

Tabela 2. Ngarkesa, në MWh për vitin 2016¹⁶

| Vendi | Mesatarja | Devijimi standard | Min | Max |
|------------------------|-----------|-------------------|------|-------|
| <i>Shqipëria</i> | 749 | 211 | 362 | 1552 |
| <i>B&H</i> | 1362 | 286 | 372 | 2213 |
| <i>Kosova</i> | 650 | - | 270 | 1129 |
| <i>Maqedonia</i> | 786 | 184 | 408 | 1406 |
| <i>Mali i Zi</i> | 366 | 74 | 70 | 570 |
| <i>Serbia</i> | 4419 | 918 | 2414 | 6958 |
| WB6^b | 7624 | 1518 | 4468 | 12644 |

^b Kosova nuk është në këtë kalkulim për shkak të mungesës së të dhënave për çdo orë.

Në Tabelën 3 ne i japim kapacitet gjeneruese që janë parashikuar të jenë aktive në vitin 2020. Nga kjo tabelë mund të shihet se rreth 3GW kapacitete gjeneruese nga BRE-të (kryesisht erë dhe ujë) do të hyjnë në treg deri në vitin 2020 në vendet e WB6. Këto do të diversifikonin padyshim edhe më tej strukturën e gjenerimit të energjisë elektrike në vendet e WB6, çka do të ndikonin në rritjen e sigurisë së furnizimit dhe të sistemit elektroenergjetik. Mirëpo Kosova, për shkak të varësisë totale nga termocentralet me fleksibilitet të ulët, duhet të jetë jashtëzakonisht e kujdesshme në integrimin e kapaciteteve gjeneruese nga era për arsye të paqëndrueshmërisë (intermittency) së lartë në gjenerim që i karakterizojnë këto teknologji. Në anën tjetër, Kosova nuk duhet të injoroj shpërndarjen gjeografike të BRE-ve lidhur me rrjetin e transmisionit dhe qendrat e konsumit, ashtu që të mund të bëjë transportin e energjisë elektrike nga gjeneratorët deri te konsumatorët.

¹⁶ Të dhënat për Kosovën janë marrë nga ZRRE, ndërsa për vendet e tjera të WB6 nga ENTSO-E.

Tabela 3. Kapacitetet gjeneruese sipas teknologjisë, në MW për vitin 2020

| Vendi | Termocentrale | | Ujë | | Erë | | Solare | | Biomasa | | Totali |
|------------------|-------------------|--------------|--------------|--------------|------------|-------------|------------|-------------|------------|-------------|--------------|
| <i>Shqipëria</i> | 0 | 0.0% | 2324 | 96.5% | 30 | 1.2% | 50 | 2.1% | 5 | 0.2% | 2409 |
| <i>B&H</i> | 1856 | 40.0% | 2700 | 58.2% | 33 | 0.7% | 16 | 0.3% | 36 | 0.8% | 4641 |
| <i>Kosova</i> | 1171 ^a | 73.9% | 240 | 15.1% | 150 | 9.5% | 10 | 0.6% | 14 | 0.9% | 1585 |
| <i>Maqedonia</i> | 800 | 50.1% | 709 | 44.4% | 50 | 3.1% | 25 | 1.6% | 14 | 0.9% | 1598 |
| <i>Mali i Zi</i> | 219 | 17.7% | 826 | 66.9% | 151 | 12.2% | 10 | 0.8% | 29 | 2.4% | 1235 |
| <i>Serbia</i> | 3905 | 49.9% | 3276 | 41.9% | 500 | 6.4% | 10 | 0.1% | 130 | 1.7% | 7821 |
| WB6 | 7951 | 41.2% | 10075 | 52.2% | 914 | 4.7% | 122 | 0.6% | 228 | 1.2% | 19289 |

^aNdërtimi i Kosovës së Re dhe largimi i kapaciteteve gjeneruese të Kosovës A nuk janë marrë parasysh.

Nga kjo çka treguam deri më tani, mund të themi se tregjet e energjisë elektrike të vendeve të WB6, posaçërisht Kosova dhe Shqipëria, kanë relativisht diversitet të ulët të miksit të teknologjive të gjenerimit dhe volatilitet të lartë të ngarkesës e cila ka edhe karakteristika të larta sezonale. Si rrjedhim, integrimi i këtyre tregjeve do të kontribuonte në sigurinë e furnizimit stabil me energji elektrike, por edhe do të rriste stabilitetin e sistemit elektroenergjetik. Është me rëndësi të ceket se me integrimin e tregut energjetik kosovar me atë rajonal, atëherë sistemi elektroenergjetik kosovar nuk mund të jetë më imun ndaj çdo ndodhie në sistemet elektroenergjetike të vendeve pjesëmarrëse. Nuk bën të anashkalohen edhe efektet e integritetit të tregjeve në rishpërndarjen e tepicës së konsumatorit dhe të prodhuesit (për më shumë shih Gugler, et al. (2016)).

Përfundim

Republika e Kosovës që nga pas lufta ka bërë hapa të rëndësishëm drejt harmonizimit të legjislaturës dhe të rregulloreve të sektorit energjetik me direktivat e KE-së. Një nga hapat e rëndësishëm është shthurja e KEK-ut, si operatori i vetëm i integruar vertikalisht. Shthurja është një proces mjaft i rëndësishëm për sistemin elektroenergjetik në rritjen e transparencës dhe efijencës në këtë sistem. Njëherësh, ai nuk lejon që nga sektorët e tjerë të bëhet bartja e kostove, p.sh. nga gjenerimi në sistemin e transmisionit ose shpërndarjes. Një hap tjetër i nevojshëm që institucionet kosovare duhet të bëjnë për rritjen e konkurrencës në tregun e energjisë elektrike është liberalizimi i tregut.

Kosovës në hartimin e politikave të përshtatshme dhe të qëndrueshme energjetike iu është shtuar edhe një barrë tjetër që vjen nga Konferenca e Kombeve të Bashkuara për Ndryshime Klimatike e mbajtur në Paris në fund të vitit 2015. Si rrjedhojë, politikat energjetike duhen koordinuar më shumë me politikat ambientale. Nga kjo konferencë bëhet e qartë se shfrytëzimi i thëngjillit për gjenerimin e energjisë elektrike duhet të minimizohet, ndërsa investimet në BRE duhen të intensifikohen. Kjo për Kosovën dhe ekonominë kosovare nuk është edhe aq në favor kur merren parasysh rezervat e mëdha të thëngjillit që Kosova i ka. Në anën tjetër, Kosova është nënshkruese e Traktatit të Komunitetit të Energjisë. Si palë nënshkruese Kosova ka edhe shumë obligime. Një nga këto obligime që vjen nga nënshkrimi i këtij traktati është rritja e investimeve në BRE. Si rezultat, Kosova ka implementuar tarifatat nxitëse në BRE dhe tani kanë filluar punët për ndërtimin e rreth 281MW nga BRE-të që pritet të hyjnë në treg deri në vitin 2020.

Nga Samiti i Vjenës, vendet e WB6 kanë vendosur që t'i rrisin përpjekjet për integrimin e tregjeve energjetike. Kjo do të ishte në interes të të gjitha palëve, e më së shumti Kosovës dhe Shqipërisë, duke e pasur parasysh nivelin e ulët të diversitetit të miksit të gjenerimit. Integrimi i këtyre tregjeve do të rriste konkurrencën midis gjeneratorëve të këtij regjioni, meqë rast operatorët detyrohen të rrisin efikasitetin në procesin e gjenerimit ashtu që të mund të prodhojnë gjatë orëve me ngarkesë të ulët. Të dhënat e shfaqura më lartë tregojnë se integrimi i këtyre tregjeve do të ketë efekt të lartë në rritjen e sigurisë me furnizimit stabil me energji elektrike dhe në stabilitetin e sistemit elektroenergjetik.

Potenciali më i lartë i benefiteve ekonomike nga integrimi i tregjeve është ai midis Kosovës dhe Shqipërisë. Të dyja këto vende do të përfitonin shumë nga teknologjitë e gjenerimit të njëra tjetrës, të cilat e plotësojnë njëra tjetrën sidomos në lidhje me fluktuacionet sezonale të ngarkesës.

Referencat

1. ACER. (2015). *ACER Opinion 09-2015 on the compliance of NRAs' Decisions Approving Methods of Cross-Border Capacity Allocation in the CEE Region*. Ljubljana: ACER.
2. Agora-Energiewende. (2015). *The European Power System in 2030: Flexibility Challenges and Integration Benefits. An Analysis with a Focus on the Pentalateral Energy Forum Region*. Fraunhofer and IWES, Energie.
3. Banka Botërore. (2012). *Analiza mjedisore e shtetit: vlerësimi i kostos së degradimit mjedisor, rishikimi institucional dhe rishikimi i shpenzimeve publike për mjedisin*. Banka Botërore.
4. CIA. (2016). *CIA The World Factbook*. Gjetur në <https://www.cia.gov/library/publications/the-world-factbook/fields/2177.html>
5. EC. (1997). Directive 96/92/EC of the European Parliament and of the Council of 19 December 1996 concerning common rules for the internal market in electricity. *Official Journal of the European Communities*, L(027), fv. 20-29.
6. EC. (2003). Directive 2003/54/EC of the European Parliament and of the Council concerning common rules for the internal market in electricity and repealing Directive 96/92/EC. *Journal of the European Communities*, L(176), fv. 37-55.
7. EC. (2009). Directive 2009/72/EC of the European Parliament and of the Council Concerning Common Rules for the Internal Market in Electricity and Repealing Directive 2003/54/EC. *Official Journal of the European Union*, L211, fv. 55-93.
8. Energy Community Secretariat. (2016). *Annual Implementation Report 2015/2016*. Vienna: Energy Community Secretariat.
9. Eurostat. (2016). Net electricity generation, 1990–2014. Gjetur në [http://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php/File:Net_electricity_generation,_1990%E2%80%932014_\(thousand_GWh\)_YB16.png](http://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php/File:Net_electricity_generation,_1990%E2%80%932014_(thousand_GWh)_YB16.png)
10. EWEA. (2015). *Balancing Responsibility and Costs of Wind Power plants*. The European Wind Energy Association.
11. Grossi, L., Heim, S., Hüschelrath, K., & Waterson, M. (2015). Electricity Market Integration and the Impact of Unilateral Policy Reforms. *ZEW Discussion Paper No. 15-072*.

12. Gugler, K., & Haxhimusa, A. (2016). Cross-Border Technology Differences and Trade Barriers: Evidence from German and French Electricity Markets. *WU Working Paper No. 237*.
13. Gugler, K., Haxhimusa, A., & Liebensteiner, M. (2016a). Integration and Efficiency of European Electricity Markets: Evidence from Spot Prices. *WU Working Paper No. 226*.
14. Haxhimusa, A. (2017). The Effects of German Wind and Solar Electricity on French Spot Price Volatility: An Empirical Investigation. Në *Regulation of Network Industries* (fv. 136-159). Vienna: Bibliothek der WU Wien.
15. Jamasb, T., & Pollitt, M. (2005). Electricity Market Reform in the European Union: Review of Progress toward Liberalization & Integration. *The Energy Journal, Special Edition*(26), fv. 313-320.
16. Keppler, J., Phan, S., LePen, Y., & Boureau, C. (2016). The Impacts of Intermittent Renewable Production and Market Coupling on the Convergence of French and German Electricity Prices. *The Energy Journal*, 3(37), fv. 343-359.
17. KOSID. (2017). *Një histori e shkurtër e një dështimi të madh të politikave të energjisë në Kosovë*. Prishtinë: Kosovo Civil Society Consortium for Sustainable Development.
18. Ministria e Zhvillimit Ekonomik. (2012). *Strategjia Minerare e Republikës së Kosovës 2012-2025*. Prishtinë: Qeveria e Republikës së Kosovës.
19. Pellini, E. (2014). Convergence Across European Electricity Wholesale Spot Markets: Still a Way To Go. Në E. Pellini, *Dissertation: Essays on European Electricity Market Integration* (fv. 100-132). Surrey Energy Economics Centre, University of Surrey.
- Sensfuß, F. (2007). Assessment of the Impact of Renewable Electricity Generation on the German Electricity Sector - An Agent-Based Simulation Approach. *Dissertation of Frank Sensfuß*.
20. Western Balkan Summit Vienna 2015. (2015). *Final Declaration by the Chair of the Vienna Western Balkans Summit*. Vienna: Western Balkan Summit Vienna 2015.
21. Zachman, G. (2008). Electricity Wholesale Market Prices in Europe: Convergence? *Energy Economics*, 4(30), fv. 1659-1671. doi:10.1016/j.eneco.2007.07.002
22. ZRRE. (2015). *Raporti Vjetorë 2015*. Prishtinë: ZRRE.

TREGU I PËRBASHKËT BALLKANIK: KOMENT

Petrit Gashi¹

Konteksti

Qëndrueshmëria ekonomike e Kosovës varet nga integrimi i saj ekonomik me botën, si në tregti, investime, ashtu edhe në lëvizjen e njerëzve. Edhe përkundër faktit që këmbimet tregtare, investimet, dhe dërgesat nga diaspora kanë ushqyer në masë të madhe konsumin në vend, prapë efekti i tyre në zhvillimin ekonomik dhe në mirëqenie është substancial, veçanërisht i remitancave. Mirëpo, rritja ekonomike e bazuar në konsum nuk siguron qëndrueshmëri ekonomike. Andaj, dinamizmat brenda ekonomisë së Kosovës duhet të ndryshojnë me qëllim që integrimi ekonomik të nxitë prodhimin në vend, e në anën tjetër, të stimulojë më pak konsumin. Kjo për faktin se, përvojat nga vendet e tjera, veçanërisht dy dekadat e para të zhvillimit të vendeve ish-socialiste tregojnë se mekanizmat e tillë të integrimi ekonomik kanë bartur peshën kryesore të rritjes ekonomike dhe të ngritjes së kualitetit të jetesës. Ndonëse, sukcesi i këtyre vendeve lidhet në masë të madhe me kushtet fillestare të fillimit të procesit integrues, me stabilitetin politik, me nivelin e zhvillimit institucional, me qasjet në politikëbërje, me nivelin e zhvillimit të burimeve njerëzore, dhe me faktorë të tjerë. E kaluara e afërt e diskriminon Kosovën në secilën nga këto aspekte, andaj edhe integrimi ekonomik nuk ka prodhuar efektet ekonomike që i shohim në pjesën dërmuese të vendeve tranzicion.

Rrjedhimisht, Kosova mbetet me një bilanc tejet të disfavourshëm me botën. Nga të gjitha vendet e Ballkanit, Kosova shënon nivelin më

¹ Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Ekonomik, rr. Agim Ramadani p.n. Prishtinë 10000, Republika e Kosovës, petrit.gashi@uni-pr.edu

të ulët të eksporteve. Kosova ka një raport eksport-import prej një-metre në favor të importeve. Nëse flasim vetëm për tregtinë e mallrave, raporti do të ishte shumë më i disfavorshem, pra një-me-dhjetë. Bilancin e tregtar e përmirëson niveli i lartë i eksporteve të shërbimeve.

Në anën tjetër, Kosova mbetet një prej vendeve më pak atraktive për investimet e huaja, si rezultat i riskut të lartë politik, burimeve njerëzore, dhe faktorëve të ndërlidhur me nivelin e ulët të zhvillimit institucional. Barazimin e bilancit të pagesave e siguron fluksi i madh dhe i qëndrueshëm i dërgesave të emigrantëve, vlera e të cilave i tejkalon €1 miliard, nëse llogariten edhe dërgesat të cilat e bishtojnë sistemin.

Integriti ekonomik i Kosovës

Banka Botërore, në një nga analizat e saj për të mbështetur idenë e tregut të përbashkët Ballkanik, nxjerr në pah fuqinë transformuese të integritit ekonomik. Sipas tyre, integriti ka prodhuar efekte të konsiderueshme gjithandej globit²:

“Vendet kanë arritur në nivelin e ekonomive me të ardhura të larta përmes integritit në tregjet globale, dhe atë përmes integritit të tregtisë, të transportit, dhe të investimeve. Vet procesi i integritit është ndërlidhur me rritje të produktivitetit si rezultat i ekspozimit të ekonomisë ndaj niveleve të larta të konkurrencës, pastaj të ekspozimit ndaj teknologjive të avancuara, ndërsa, për vendet e vogla, përmes mundësive për të realizuar ekonomitë e shkallës. Vendet të ndryshme, si Botsvana, Kosta-Rika, Singapori,

² Jo të gjithë janë entuziast me efektet e integritit ekonomik siç është Banka Botërore. Politikat liberale në përgjithësi nuk janë shumë popullore. Për më tepër, popullariteti i proceseve integruese në nivel global është zbehur veçanërisht pas krizës globale financiare. Ky dekurajim karshi integrimeve, solli ‘tërmete’ politike në botën e zhvilluar. Mirëpo, për shumë vite antiglobalistët në vendet e zhvilluara ankohen për zhdukjen e industrive dhe ikjen e vendeve të punës në vendet e botës së tretë. Të tjerët ankohen për humbje të sovranitetit e deri te tendencat imperialiste të vendeve të zhvilluara. Bizneset janë të pakënaqura me nivelin e konkurrencës nga importet që ua vështirësojnë jetesën.

Polonia, kanë dokumentuar se çelësi i suksesit ekonomik është integrimi. Sot, qytetarët e këtyre vendeve janë më të pasur, më të shëndetshëm, dhe më të edukuar, se sa që kanë qenë ndonjëherë”.

Për më tepër, analiza e Bankës Botërore iu sugjeron vendeve të Ballkanit Perëndimor të stimulojnë sektorët eksportues, pasi që:

“...asnjë vend i vogël (me më pak se 10 milion banorë) nuk ka arritur të bëhet vend me të hyra të larta nëse pjesëmarrja e eksportit në GDP nuk e ka tejkaluar nivelin prej 50%.”

Duke aluduar në këtë formë të të menduarit, apo në argumente të tilla, mekanizmat politikëbërës në Kosovë që nga fillimi i viteve 2000 janë përfshirë në procesin e integritit të vendit në ekonominë globale. Duhet thënë së për momentin, pjesëmarrja e eksporteve në GDP të Kosovës është rreth 20%.

Që në fillim të viteve 2000, barrierat në tregti dhe investime janë zhbërë gati në tërësi. Në këtë kontekst, pas iniciativave të ndryshme të iniciuara nga Bashkimi Evropian për integrimin dhe zhvillimin e Ballkanit, Kosova filloi me njëherë negociatat bilaterale me një pjesë të vendeve fqinje për liberalizimin e tregtisë. Këto negociata u përmyllën me katër marrëveshje tregtare, tri prej të cilave ishin negociuar për herë të parë, ndërsa e katërta, me Maqedoninë, ishte marrëveshje që funksionalizoi një marrëveshje të pjesës së dytë të të nëntëdhjetave të arritur në mes kësaj të fundit dhe ish-Jugosllavisë së atëhershme.

Më vonë këto marrëveshje u shkrinë në marrëveshjen rajonale, të njohur si CEFTA. CEFTA paraqet një integrim më të thellë se sa marrëveshjet bilaterale. Përveç liberalizimit – eliminimit të tarifave doganore dhe barrierave të tjera jotarifore – të tregtisë në mallra, marrëveshja përcakton rregullat e qarta për vendet nënshkruese në kontekst të origjinës së produkteve, të konkurrencës, të investimeve, të ndihmës shtetërore, të prokurimit publik, të të drejtave pronësore intelektuale, si dhe ofron procedura të qarta të zgjidhjes së kontesteve, përfshirë këtu edhe zbatimin e masave kontigjente. Gjithashtu,

marrëveshja mbulon edhe shërbimet. Negociata për liberalizimin e shërbimeve në kuadër të CEFTA-s janë zhvilluar gjatë vitit 2016.

Një zhvillim tjetër në kontekst të integrimit të vendit është Marrëveshja Stabilizim Asocijim e nënshkruar me BE-në. Para kësaj marrëveshje, raportet tregtare Kosovë – BE ishin realizuar nën ombrellën e Masave Preferenciale Autonome, mekanizëm ky i iniciuar njëanshëm nga BE për përkrahje ekonomike të Ballkanit Perëndimor. MSA hyri në fuqi në prill të 2016. Kjo marrëveshje përbën hapin më të avancuar të Kosovës drejt integrimit në BE. Marrëveshja ka shtrirje të gjerë: në njërin anë mbulon liberalizimin e mallrave dhe të shërbimeve, edhe pse në këtë të dytën është relativisht e kufizuar, ndërsa, në anën tjetër, fokusohet në zhvillimin dhe bashkëpunimin ndërinstitucional. Sa i përket liberalizimit tregtar, përveç që marrëveshja mbulon mbi 8,000 produkte, apo linja tarifore, gjithashtu mbulon disa aspekte të liberalizimit të shërbimeve si të drejtën për të veprimtari në tregjet respektive dhe furnizimin me shërbime. Në anën tjetër, marrëveshja vë theks të veçantë në implementimin e *acquis*-it dhe në reformat e tjera institucionale dhe ligjore. Një vend të veçantë zë zbatimi i ligjit. Për më tepër, marrëveshja fokusohet, ndër të tjera, edhe në rregullat e konkurrencës, e lëvizjes së kapitalit, e ndihmës shtetërore, e së drejtës intelektuale, e prokurimit, e emigracionit, e të tjera. Marrëveshja parasheh edhe një gamë të gjerë të fushave të bashkëpunimit si në politikat e bashkëpunimit, të promovimit të investimeve, të zhvillimit të NVM-ve, të prodhimit të statistikave, pastaj të bashkëpunimit në sektorin industrial e të turizmit, e deri te bashkëpunimi për ndjekjen e krimit të organizuar dhe të luftimit të terrorizmit. Marrëveshja, gjithashtu e obligon Kosovën t'u përmbahet zotimeve të saj për dialog politik me BE-në dhe fqinjët, si dhe respektim të marrëveshjeve të mëhershme tregtare me vendet e rajonit.

Për fund, sikur u tha, integrimi ekonomik shkon përtej integrimit tregtar në mallra e shërbime. Integrimi ekonomik mbulon edhe fluksin e kapitalit, si dhe lëvizjen e lirë të njerëzve. Sa i përket të parës, politikëbërja në Kosovë ka eliminuar të gjitha kufizimet në fluksin e kapitalit, dhe në mënyrë konstante kërkon investitorë. Me një numër

vendesh ka nënshkruar marrëveshje për mbrojtje të investimeve dhe eliminim të taksimit të dyfishtë. Edhe përkundër këtyre përpjekjeve, fluksi i investimeve të huaja në vend mbetet konstant i vogël. Faktorët janë të ndryshëm, mirëpo me të rëndësishmit lidhen me jostabilitetin politik, nivelin e shkathtësive të fuqisë punëtore, si dhe me kualitetin e ulët institucional në Kosovë. Këto rrisin në masë të madhe riskun e të bërit biznes në Kosovë. Dimensionin e dytë, lëvizja e njerëzve, është edhe më e kufizuar. Kosova mbetet ndër vendet me të izoluarat në Europë. Përkundër kësaj, disa valë të emigracionit të pas luftës së dytë botërore kanë krijuar një Diasporë të fuqishme veçanërisht në vendet e Europës Perëndimore. Diaspora, është një ndër kontribuuesit kryesor të zhvillimit ekonomik në vend.

Tregu i përbashkët Ballkanik

Propozimi i tregut të përbashkët Ballkanik për gjashtë vende të Ballkanit Perëndimor shihet si një mekanizëm shtesë përmes të cilit mund të aktivizohen potenciale të reja të rritjes ekonomike.

Si trampolinë për në BE, ky nivel integrimi duhet të jetë edhe një dëshmi shtesë që vërteton përkushtimin e vendeve të Ballkanit për “një të ardhme të përbashkët brenda” BE-së.

Propozimi për treg të përbashkët merr për bazë iniciativat e deritanishme të rajonit me qëllim të thellimit të integritimit ekonomik (siç është CEFTA), si dhe përpjekjet e këtyre vendeve për të harmonizuar legjislacionin dhe strukturat e tyre institucionale me ato të BE-së (që reflektohet në MSA). Gjithashtu, kjo iniciativë mbështetet edhe në mekanizma të tjerë si në kornizën e konvergencës për anëtarësim në BE, të njohur si ‘Europa Juglindore 2020’, si dhe të ashtuquajturën Agjendën e Ndërlidhjes – mekanizëm ky që ndihmon integritimin e sistemeve të transportit dhe të energjisë në rajon.

Është evidente se integrimi ekonomik i gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor, sado i thellë të jetë, nuk siguron konvergencë me nivelet e zhvillimit ekonomik të vendeve të BE-së. Prandaj, propozimi bëhet më gjithëpërfshirës përmes qasjes dydrejtimëshe që

përveç integrimit ekonomik duhet të stimulohen edhe raportet investive dhe ato në mes të bizneseve. Për të arritur këtë, vendet e përfshira në këtë proces zotohen për investime në përmirësimin e kapitalit njerëzor, avancimit të infrastrukturës që stimulon inovacionet, dhe digjitalizimin e ekonomisë me qëllim që më lehtë këto ekonomi t'u përgjigjen sfidave të shekullit 21.

Përgjatë tërë procesit theksohet nevoja e bashkërendimit dhe koordinimit të përpjekjeve nga gjashtë vendet pjesëmarrëse në këtë iniciativë për të realizuar qëllimet e këtij propozimi. Formula e propozuar nënkupton integrim përgjatë katër dimensioneve të veçanta:

- Treg të përbashkët për mallra, shërbime, dhe kapital;
- Lëvizje të lirë të fuqisë së shkathtë punëtore dhe integrimi i saj në rrjetet profesionale dhe akademike të BE-së;
- Treg të përbashkët digjital;
- Hapësirë dinamike investive.

Të katër objektivat synohen të arrihen deri në vitin 2020.

Dimensioni i parë ka për qëllim të krijojë një hapësirë të përbashkët investive dhe tregtare përmes eliminimit të barrierave ekzistente në tregti dhe në investime, si dhe duke krijuar një rrafsh të barabartë, apo jodikriminues, në treg, për të gjithë pjesëmarrësit. Në kontekst të tregtisë, lehtësimi i tregtisë tërheqë vëmendje të veçantë. Kjo ndërlidhet me proceset që ndodhin në kufi gjatë realizimit të një transaksioni ndërkombëtar në mes të palëve. Pretendimi është që në këtë rast të bëhet edhe më tepër se sa që parasheh Marrëveshja për Lehtësimin e Tregtisë e OBT-së. Ky është një hap pozitiv, pasi që burokracia e institucioneve që kontrollojnë mallrat në kufi ka shkaktuar kokëçarje për bizneset që operojnë në tregjet e jashtme. Për më tepër, qasja e përbashkët ndërshtetërore është e vetmja mënyrë për zgjidhjen e problemeve në kufi.

Aspekti i dytë pretendon të mundësojë qarkullimi i lirë i fuqisë punëtore me shkathtësi të larta, si dhe integrimin e saj në rrjetet profesionale, akademike, dhe hulumtuese të BE-së.

Në anën tjetër, tregu i përbashkët digjital synon krijimin e një ekonomie dhe shoqërie digjitale unike. Më specifikisht, ky segment synon integrimin ndërkufitar, harmonizimin e sistemeve dhe infrastrukturës së teknologjisë informative dhe komunikuese (ICT), si dhe avancimin e procesit të shkëmbimit të të dhënave dhe informatave. Këto aspekte do t'i mundësonin vendeve të Ballkanit Perëndimor integrimin e lehtë në tregun digjital pan-Europian, pasi që këto aspekte do të ndikonin në avancim të kornizës legjislative në këtë fushë, përmirësim të infrastrukturës transmetuese (*broadband*), qasje në mallrat dhe shërbimet digjitale, si dhe edukim gjithëpërfshirës digjital (*digital literacy*).

Në fund, qëllimi përfundimtar i hapësirës dinamike investive në Ballkanin Perëndimor është shndërrimi i këtyre vendeve në ekonomi të bazuara në dije. Një gjë e tillë kërkon shfrytëzim eficient të dijes, shkathtësive, dhe potencialit inovues brenda rajonit, si determinuese të përparësive konkurruese në treg. Specifikisht, vendet zotohen që bashkërisht të ndërtojnë agjendë investive, të implementojnë reforma në këtë fushë, dhe të promovojnë bashkërisht investimet.

Kur dështon integrimi ekonomik?

Tregu i përbashkët Ballkanik duket si një CEFTA+ (lexo: CEFTA plus), pasi që vet marrëveshjen CEFTA e avancon në nivele që e përafrojnë me MSA-në. Pra, si iniciative është diku në mes të CEFTA-s dhe MSA-së. Mirëpo, risitë që i sjell kjo iniciative janë veçanërisht të lidhura me lëvizjen e lirë të njerëzve, krijimin e tregut të përbashkët digjital, si dhe krijimin e një hapësirë të integruar investive. Lëvizja e lirë e ekspertëve, profesionistëve, dhe studentëve, dhe integrimi i tyre në rrjetet hulumtuese dhe akademike të BE-së në vetvete fuqizon kapacitetet njerëzore dhe akumulon dije në Kosovë dhe në vendet e tjera të përfshira në proces. Për më tepër, duket që tregu digjital do t'u shërbejë në masë të madhe sektorit në ngritje të shërbimeve në Kosovë dhe gjetkë në rajon. Edhe në anën e investimeve, Kosova do të përfitojë nga politikat e integruara investive dhe promovimi i përbashkët i investimeve. Përmes këtyre iniciativave, Kosova mund të tërheqë më

tepër investime si dhe mund të përfshihet në zinxhirët rajonal apo European të vlerës.

Mirëpo, kjo iniciativë duhet të merret me rezervë. Në këtë kontekst, dy aspekte të përgjithshme janë veçanërisht të rëndësishme për proceset integruese të Kosovës, dhe vendet me nivel të njëjtë të zhvillimit ekonomik, si Kosova. I pari ka të bëjë me nevojën që integrimi ekonomik, veçanërisht ai tregtar, të komplementohet me politika dhe masa të tjera institucionale që ngritin kapacitetet prodhuese në vend. Dhe e dyta ka të bëjë me faktin që integrimi ekonomik krijon një ambient të favorshëm që vendet të ballafaqohen me goditje (dëme) eksterne ose të jashtme.

Rasti i parë është evidentuar në raste të shumta. Efektet e liberalizimit tregtar kushtëzohen në masë të madhe nga faktorët a determinantet e ofertës. Thënë thjesht, efektet e tregtisë së lirë do të jenë të kufizuara nëse vendi i përfshirë në këtë liberalizim nuk ka çfarë t'i ofrojë tregut tjetër. Kjo është vërtetuar në studime të ndryshme edhe të vet Bankës Botërore dhe të Organizatës Botërore të Tregtisë. Në bashkautorësi, autori i këtij komenti e ka vërtetuar empirikisht të njëjtën gjë edhe për Kosovën. Analiza është bazuar në 'modelin e gravitetit' për të studiuar raportet tregtare në mes të Kosovës dhe të BE-së, dhe efektet potenciale të MSA-së në tregtinë në mes këtyre dy partnerëve. Analiza ka mbuluar 8 vjet të këmbimeve tregtare, dhe ka konkluduar se në mesin e faktorëve të tjerë, pengesat në anën e ofertës do të kufizojnë përfitimet potenciale të Kosovës nga MSA-ja.

Rreziku i dytë nga integrimi qëndron në atë se ky proces hap rrugë për shoke të jashtme. Tregtia, investimet, dhe diaspora janë të gjitha kanale përmes të cilave mund të transmetohen krizat në mes të vendeve. Kjo pikërisht ndodhi gjatë krizës globale financiare të fundit të viteve 2000. *Raporti i Tranzicionit 2009* i EBRD vjen në përfundim se sa më të integruara me botën vendet e bllokut ish-socialist, aq më të prekura kanë qenë nga kriza globale. Kriza globale solli rënie ekonomike dyshifrore të disa prej vendeve thellë të integruara ish-socialiste, rritja e të cilave varej nga investimet e huaja dhe tregtia ndërkombëtare. Edhe

zhvillimet ekonomike në Kosovë gjatë 2008 dhe 2009 ofrojnë mbështetje këtij argumenti. Kosova si një prej vendeve më pak të integruara, u ndikua vetëm sipërfaqësisht nga kriza, dhe atë kryesisht në reduktimin e fluksit të remitancave.

Në mënyrë specifike, rezultatet e kësaj iniciative rajonale mund t'i kufizojnë edhe aspektet në vijim:

Së pari, nëse kjo iniciative nuk është e sigurtë nga ana e BE-së, si iniciuese e këtij procesi, atëherë gjasat janë të mëdha që do të dështojë. Nëse BE-ja e sheh këtë iniciativë si mënyrë për të blerë kohë, pra si një justifikim për prolongim të procesit të anëtarësimit të vendeve të Ballkanit Perëndimor në BE, atëherë implikimet negative do të jenë edhe më të mëdha. Në këtë rast, në vendet e Ballkanit Perëndimor zhgënjimi me BE-në do të rritet, ndërsa entuziazmi për reforma do të zbehet. Kjo e fundit është veçanërisht e rëndësishme pasi që procesi i integrimi Evropian është mjeti më i fuqishëm për nxitjen e reformave në vendet e rajonit.

Një tjetër determinantë e suksesit potencial të kësaj iniciative lidhet me animositetet ndëretnike në rajon. Kohët e fundit po i shohim edhe më të theksuara, veçanërisht në relacionet në mes të Serbisë me vendet e tjera, kryesisht me Kosovën. Është paksa optimiste të mendohet për suksesin e plotë të iniciativave të reja integruese në rajon nëse vendet e po të njëjtit rajon nuk e njohin ekzistencën e njëri-tjetrit a edhe kanë ende pretendime territoriale ndaj njëra-tjetres. Në këto kushte, realizimi i qarkullimit të lirë të punëtorëve me shkathtësi të larta duket i përzemësueshëm në kontekstin aktual. E njëjta ka gjasa të ndodhë edhe me dimensionet e tjera, si të promovimit të përbashkët të investimeve, a të ndërtimit të politikave të përbashkëta investive, etj. Së paku, nëse e marrim pikë reference lëvizjen e lirë të mallrave brenda CEFTA-s, iniciativa e re nuk është shumë premtuese.

Për më tepër, kjo iniciativë mbështetet në struktura të qeverisjes, monitorimit, dhe koordinimit të ngjashme sikur ato të CEFTA-s. Strukturat e CEFTA-s në nivel rajonal janë karakterizuar me inefficiencë

të mëdha. Për më tepër, koordinimi me autoritetet nacionale nuk ka qenë në nivelin e duhur.

Dhe për fund, horizonti kohor i realizimit të objektivave të kësaj iniciative duket të jetë shumë optimist.

Përfundim

Edhe pse sfidat janë të mëdha, tregu i përbashkët Ballkanik mund të prodhojë efekte pozitive, veçanërisht në kontekst të lëvizjes së lirë të fuqisë së shkathët punëtore, integritet në tregun digjital, dhe në hapësirën e integruar investive. Përkundër sfidave që përndjekin integritetin në rajonin e Ballkanit që nga viti 2000, për Kosovën do të jetë sfiduese ngritja apo rigjenerimi i industrive, a ngritja e kapaciteteve prodhuese në vend. Në rastin e Kosovës, problemet mbesin të njëjta pa marrë parasysh kuadrin, CEFTA a tregu i përbashkët Ballkanik. Kosovës ‘topi’ i mbetet në fushën e saj, dhe duhet të shohë më tepër në drejtim të eliminimit të defekteve strukturore brenda vetë sistemit. Kjo nënkupton një qasje proaktive të qeverisë në përmirësimin e ambientit biznesor, të ngritjes së kapaciteteve njerëzore, të zbatimit të ligjit në përgjithësi e të kontratave në veçanti, të avancimit të mekanizmave për sigurimin e kualitetit të produkteve, promovimit të investimeve të huaja, e deri të mbështetja e drejtpërdrejtë e bizneseve me potencial të lartë të rritjes dhe të zhvillimit.

INTEGRIMI I TREGUT TË ENERGJISË SË KOSOVËS ME RAJONIN DHE EVROPËN

Drita Konxheli Radoniqi¹ dhe Kadri Kadriu²

Abstrakti

Vendet e Ballkanit Perëndimor, ku bënë pjesë edhe Kosova, aspirojnë të jenë anëtare të Bashkimit Evropian. Njëra prej fushave, për të cilën Bashkimi Evropian ka vënë kritere për anëtarësim, është edhe fusha e energjisë. Ky punim do të diskutojë për kriteret e vëna nga Bashkimi Evropian në këtë fushë, hapat që ka ndërmarrë Kosova për t'i plotësuar këto kritere, sfidat me të cilat përballet dhe që e presin në të ardhmen. Ky punim gjithashtu do të ketë në fokus përparimin që ka bërë Kosova për t'u integruar në tregun rajonal dhe të Evropës, si dhe përfitimet nga tregu i përbashkët energjetik me theks të veçantë nga tregu Kosovë-Shqipëri.

Fjalë çelës: Kosova, Bashkimi Evropian, Tregu i Përbashkët, Energjia, Integrimi i Tregut

Hyrje

Kur flasim për Bashkimin Evropian mendja na shkon për zhvillimin ekonomik të shteteve anëtare dhe për tregun e madh të përbashkët që kanë këto vende. Në raportin “White Paper – The Future of Europe” të përgatitur nga Komisioni Evropian (2017), thuhet se Bashkimi Evropian është tregu i përbashkët më i madh në botë dhe se valuta euro është valuta e dytë më e përdorur në botë. Më tej në këtë raport thuhet se Bashkimi Evropian është shumë atraktiv për partnerët e tij dhe se pothuajse të gjitha vendet e kontinentit të Evropës pretendojnë të jenë pjesë e BE-së. Si vende që pretendojnë të jenë anëtare të BE-së janë sidomos vendet e Ballkanit Perëndimor –

¹ Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Ekonomik, rr. Agim Ramadani p.n. Prishtinë 10000, Republika e Kosovës, drita.konxheli@uni-pr.edu.

² Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike – FIEK, kadri.kadriu@uni-pr.edu

Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Maqedonia, Kosova, Mali i Zi dhe Serbia (Sanfey, Milatovic & Krestic, 2016). Këto vende para së gjithash pretendojnë të integrohen ekonomikisht sepse integrimi ekonomik nënkupton uljen ose eliminimin e barrierave tregtare midis vendeve që bashkohen (Mwasha, 2011 & Salvatore, 2006). Ky punim do të ketë një fokus në një prej sektorëve më të rëndësishëm për zhvillimin ekonomik, sektorin e energjisë. Fillimisht do të diskutohet në përgjithësi për tregun e përbashkët të energjisë ku nëpërmjet rishikimit të literaturës do të jepen mendimet e autorëve të tjerë në lidhje me këtë temë . Në pjesën e dytë do të diskutohet rasti i vendeve të Ballkanit Perëndimor me theks të veçantë rasti i Kosovës ku do të shtjellohet integrimi i tregut të energjisë së Kosovës në rajon dhe Evropë. Në pjesën e tretë do të prezantohet një përmbledhje e studimit REPOWER, të përgatitur nga AECOM Inc. me mbështetje nga USAID për tregun e përbashkët të energjisë mes Kosovës dhe Shqipërisë si hap i parë drejt tregut të përbashkët të energjisë në Bashkimin Evropian. Në fund do të jepen përfundimet nga ky punim.

Në përgjithësi për tregun e përbashkët të energjisë

Bockers, Haucap & Heimeshof (2013), kur definojnë tregun që për produkt ka energjinë, një rëndësi kryesore i japin shtrirjes gjeografike të vendit. Këta autorë shpjegojnë se shtrirja gjeografike e vendit është elementi më i rëndësishëm në përcaktimin e tregut të energjisë, sepse energjia transmetohet nëpërmjet rrjetit të përbashkët të energjisë dhe nëse një vend nuk ka interkonjeksione me vendet e tjera, atëherë nuk mund të funksionojnë si një treg i përbashkët. Nevoja për treg të liberalizuar të tregut të energjisë u krijua meqenëse kompanitë energjetike tradicionalisht kanë qenë vertikalisht të integruara, që domethënë prodhimi i energjisë, transmissioni dhe shpërndarja, përfshirë edhe furnizuesin kanë qenë pjesë e një kompanie e ky zinxhir i organizimit nuk ka krijuar efikasitet në tërë zinxhirin e aktiviteteve, sepse ndër të tjera shpenzimet operative për prodhim të energjisë kanë qenë shumë të larta (Joskow, 2008). Ndarja dhe privatizimi, së pari, në sektorët konkurrues ka filluar në mesin e viteve 80-të në Amerikën

Latine dhe në Mbretërinë e Bashkuar (Srivastava et al, 2011; Shahidehpour & Alomoush, 2001; Rahimi & Vojdani, 1999). Sipas faqes zyrtare të internetit të Komisionit Evropian, në Evropë, liberalizimi i tregut të energjisë elektrike fillon në mënyrë intensive nga viti 1996, kur Komisioni Evropian ka nxjerrë direktivat për mbështetjen e liberalizimit të tregut dhe rritjen e shkëmbimeve ndërkufitare me qëllim rritjen e diversitetit dhe rritjen e numrit të pjesëmarrësve në treg. Mbi këtë parim ndërtohen tregjet konkurruese me shumicë dhe pakicë. Krijimi i tregut konkurrues ofron burime gjeneruese me kosto më të lira te konsumatorët, shërbime më efikënte të operatorëve të ndryshëm dhe përkrah teknologjitë e reja inovative (Joskow, 2008).

Integriti i tregut të energjisë së Ballkanit Perëndimor, veçanërisht Kosovës me Rajonin dhe me Evropën

Në raportin “Energjia në Ballkanin Perëndimor – Rruga drejt reformimit dhe rindërtimit” (Energy in the Western Balkans –The Path to Reform and Reconstruction), publikuar në vitin 2008 nga Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë (International Energy Agency) dhe UNDP (në vazhdim IEA &UNDP), thuhet se shtetet e Ballkanit Perëndimor për shkak të pozitës gjeografike strategjike që kanë paraqesin një rajon me shumë rëndësi për Bashkimin Evropian sepse janë urë lidhëse mes rajoneve të pasura me hidrokarbon (Rusia & Lindja e Mesme) dhe rajoneve në Evropën Qendrore dhe Perëndimore. Më tej në këtë raport thuhet se këto vende kanë trashëguar një infrastrukturë të dëmtuar nga konfliktet për ndarjen e Jugosllavisë, andaj zhvillimi dhe reformimi i sektorit të energjisë në shtetet e Ballkanit Perëndimor do të ishte shumë i dobishëm dhe fitimprurës fillimisht për vetë këto vende, por edhe për tërë Evropën në përgjithësi. Deitz, Stirton & Wright (2008), kanë potencuar se agjencitë ndërkombëtare, si: Komisioni Evropian, Banka Botërore e Banka Evropiane për Rindërtim e Zhvillim, kanë pasur dhe vazhdojnë të luajnë një rol kyç në zhvillimin e sektorit të energjisë, gjë që ndikon direkt në zhvillimin ekonomik dhe integritimin e këtij regjioni në Bashkimin Evropian. Për të integruar Ballkanin Perëndimor në një treg të avancuar të energjisë, si Bashkimi Evropian, një varg reformash

në sektorin energjetik duhen ndodhur (Uvalic, 2012). Më tej kjo autore potencon se këto reforma kanë për qëllim ristrukturimin e kompanive të energjisë, liberalizimin e tregut të energjisë në nivelin nacional, zhvillimin e tregut rajonal, zhvillimin e tregut balancues regjional, krijimin e bursave të energjisë në nivelin nacional dhe bashkimin e tyre në nivelin regjional dhe më gjerë. Hapat që ka ndërmarrë Bashkimi Evropian për të integruar shtetet e Ballkanit Perëndimor drejt një tregu regjional janë Procesi i Athinës i mbajtur në vitin 2002 i cili i ka hapur rrugë Traktatit të Komunitetit të Energjisë, i cili është i nënshkruar në vitin 2005 nga të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor e që ka për qëllim krijimin e një tregu të përbashkët regjional në harmoni me legjislacionin e Bashkimit Evropian (Deitz, Stirton & Wright, 2008; IEA & UNDP 2008, Uvalic, 2012). Të qenit pjesë e Procesit të Athinës dhe e Traktatit të Komunitetit të Energjisë paraqet hapin fillestar të shteteve të Ballkanit Perëndimor drejt një tregu të përbashkët me rajonin dhe Evropën, por cilat janë obligimet që kanë dalë nga këto traktate dhe cilat janë reformat konkrete që është dashur të ndërmerren nga këto vende për të përmbushur kriteret e vëna nga Bashkimi Evropian? Përgjigjet në këto pyetje do të shtjellohen nga perspektiva e Kosovës, ku në vijim do të flitet për reformat që ka ndërmarrë Kosova, si nënshkruese e Procesit të Athinës dhe e Traktatit të Komunitetit të Energjisë, që të plotësojë kriteret e Bashkimit Evropian në sektorin e energjisë.

Në kapitullin e dhjetë të raportit “Energjia në Ballkanin Perëndimor – Rruga drejt reformimit dhe rindërtimit”, publikuar në vitin 2008 nga IEA & UNDP flitet në detaje për hapat që ka ndërmarrë Kosova drejt integritet në tregun rajonal e evropian. Në këtë raport fillimisht flitet se në vitin 2002, në vazhdimësinë e reformave të zhvillimit të tregut përmes Strategjisë së Komisionit Evropian për liberalizim të tregut, është zhvilluar procesi i Athinës me qëllim që në Evropën Juglindore të promovohen:

- Siguria e furnizimit
- Rritja ekonomike
- Rritja e investimeve

Në këtë aspekt, në këtë raport thuhet se në vitin 2004 në Kosovë fillon ristrukturimi i sektorit të energjisë elektrike. Së pari, Kosova është zotuar për procesin e shthurjes së kompanive të integruara vertikalisht në Korporatën Energjetike të Kosovës - KEK dhe krijimin e kushteve fillestare për liberalizimin e tregut të energjisë. Në vitin 2004 janë aprovuar shumë ligje në sektorin e energjisë në harmoni me kriteret e Bashkimit Evropian. Disa prej tyre janë: Legjislacioni Primar i Energjisë, Ligji i Energjisë, Ligji i Energjisë Elektrike, Ligji i Rregullatorit të Energjisë, Ligji për Eficiencën e Energjisë e Ligji për Miniera e Minerale. Në vitin 2006 është bërë ndarja dhe themelimi i Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe të Tregut që konsiderohet shthurja e parë nga Kompania vertikalisht e integruar në KEK. Siç mund të kuptohet, këto reforma të përmendura në raportin e lartcekur janë për periudhën deri në vitin 2008 kur Kosova ishte nën administrimin e UNMIK-ut dhe kur statusi i saj akoma nuk ishte i definuar. Me shpalljen e Pavarësisë së Kosovës në vitin 2008, rruga e nisur ka vazhduar edhe më tej. Qeveria e Republikës së Kosovës duke u bazuar në Strategjinë për Energjinë 2005-2015 në shtator të vitit 2008 merr vendim që të vazhdohet procesi i shthurjes së KEK-ut (Vendimi 04/36 i Qeverisë së Kosovës), ku i hapet rrugë privatizimit të distribucionit dhe themelimit të furnizuesit të pavarur. Ky proces finalizohet në vitin 2012 me nënshkrimin e kontratës në mes Qeverisë së Kosovës dhe konsorciumit fitues (MZHE, 2012). Në kuadër të rritjes së investimeve dhe krijimit të tregut të përbashkët energjetik, Kosova dhe Shqipëria në fund të vitit 2013, kanë nënshkruar Kontratën për Ndërtimin e Interkoneksionit 400kV ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës (KOSTT, 2014), punimet e të cilit kanë përfunduar në vitin 2016, kur edhe ky projekt u inaugurua (KOSTT, 2016). Në këtë aspekt janë bërë studime të përfitimeve të tregut të përbashkët Kosovë-Shqipëri dhe rezultatet janë mjaft pozitive. Për këtë studim do të diskutohet në vazhdim të punimit.

Rasti i studimor i përfitimeve të tregut të përbashkët Kosovë-Shqipëri

Agjencia Amerikane për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID), në mesin e shumë aktiviteteve për mbështetjen e Qeverisë së Kosovës, në

vitin 2014 ka filluar aktivitetin për Energjinë e Rinovueshme në Kosovë (REPOWER), i cili aktivitet mbështet Qeverinë e Kosovës në reformat në sektorin e energjisë. (USAID, 2017). Pjesë e këtij aktiviteti është studimi i përfitimeve nga tregu i përbashkët të energjisë në mes Kosovës dhe Shqipërisë, studim ky i bërë nga AECOM Inc. Ky studim është bërë në bazë të të dhënave nga Operatori i Sistemit, Transmisionit e Tregut në Kosovë (KOSTT) dhe në Shqipëri (OST). Kjo pjesë e këtij punimi është një përmbledhje e këtij studimi ku janë prezantuar përfitimet më të mëdha nga tregu i përbashkët i energjisë për të dy vendet.

Kosova dhe Shqipëria paraqesin një rast të veçantë ku prodhimi i energjisë elektrike pothuajse në dy vendet mbulohet nga prodhimi që është mbi 90% nga Termocentralet dhe 100% nga Hidrocentralet. Të dy sistemet operojnë në tregje të ndara dhe janë rrjete importuese të energjisë elektrike. Operimi i sistemeve në rrethana të tilla në rastin e Kosovës është mjaft i vështirë për shkak të balancimit të sistemit si pasojë e njësisive gjeneruese joflekisibile. Në Shqipëri kemi varësinë e lartë nga importi dhe vështirësitë lajmërohen sidomos gjatë sezonit me thatësira. Të dy tregjet janë tregje të vogla dhe jolikuide për të organizuar një treg të mirëfilltë të liberalizuar. Po ashtu nxitja për investimet bazuar në treg është e ulët nëse operojnë si tregje të ndara. Megjithatë liberalizimi i tregut i promovuar nga BE mundëson që këto tregje të bashkohen. Për të operuar tregjet si një treg i përbashkët është e domosdoshme të ketë kapacitete transmetuese të lira. Linja Kosovë-Shqipëri mundëson që tregu Kosovë-Shqipëri mbi 98% të kohës të operojë si një zonë tregtare që d.m.th. çmimet e dy zonave konvergjojnë në një çmim. Në orët kur paraqiten kongjestione kemi ndarje në dy zona tregtare dhe rrjedhimisht paraqiten dy çmime, mirëpo numri i këtyre orëve është i vogël gjatë vitit. Bazuar në kërkesën nacionale të dy vendeve në figurën 1, janë dhënë skenarët e prodhimit të energjisë elektrike nga njësitë gjeneruese në Kosovë dhe në Shqipëri për të mbuluar kërkesën kur tregjet operojnë si tregje të ndara dhe si një treg i përbashkët.




Figura 1. Krahasimi i prodhimit të energjisë elektrike në baza mujore në Kosovë dhe Shqipëri kur tregjet janë të ndara dhe kur operojnë si një treg i përbashkët.

Burimi: Repower

Në bazë të rezultateve të fituara me simulime rezulton që energjia elektrike e prodhuar nga njësitë gjeneruese në Shqipëri për shkak të varësisë nga konditat hidrologjike, energjinë e akumuluar do ta shfrytëzojë në tërësi. Ndryshimi i vetëm që do të ndodhë është përdorimi i kësaj energjie për të mbuluar ngarkesën variable dhe të pikut në vend d.m.th. kjo energji do të zhvendoset në diagramin e konsumit nga energjia bazë në energji variable. Energjia variable është me kosto më të lartë dhe kështu direkt do të sjellë të hyra më të larta për prodhuesit në Shqipëri për energjinë e njëjtë të prodhuar. Me integrimin e tregut gjeneratorët në Kosovë do ta ndërrojnë regjimin e punës dhe profilin e prodhimit mujor. Kjo ndodh për shkak të rrethanave hidrologjike në Shqipëri, ku piku i kërkesës së sistemeve është i ndryshëm, si dhe çmimi i lirë që ofrojnë TC në Kosovë në krahasim me çmimin e importit. Pra, nga figura 1, mund të përfundojmë se termocentralet e Kosovës do ta rrisin prodhimin për të mbuluar edhe një pjesë të konsumit të Shqipërisë. Kjo do të ndikojë në rritjen e portfolios së prodhimit të Termocentraleve që është shumë me rëndësi nga aspekti i qëndrueshmërisë ekonomike të Termocentraleve. Gjatë periudhës kur kemi teprica të prodhimit në Shqipëri veçanërisht nga muaji prill deri në muajin qershor prodhimi i energjisë elektrike në Kosovë

do të zvogëlohet. Kjo ndodh për shkak se kostoja variabile e Hidrocentraleve është shumë më e lirë se e Termocentraleve dhe kjo ndikon që çmimi marginal të vendoset nga ndikimi i pjesëmarrjes së këtyre Hidrocentraleve. Kjo periudhë mund të shfrytëzohet për mirëmbajtje të Termocentraleve. Në anën tjetër bashkimi i tregjeve nuk i balancon të gjitha kërkesat për energji gjatë gjithë kohës. Tepricat e prodhimit/mungesat do të eksportohen dhe importohen nga regjioni. Në figurën 2, janë paraqitur si do të ndryshojnë eksportet/importet kur sistemet operojnë si tregje të ndara dhe kur operojnë si një treg i përbashkët.




Figura 2. Importet/eksportet në tregjet e ndara dhe në tregun e përbashkët

Burimi: Repower

Në tregun e përbashkët Shqipëria do të importojë 2680 GWh (42% më shumë se në rastin e tregut të ndarë), derisa eksporton 1556 GWh (99% rritje në raport me tregun e ndarë). Në tregun e përbashkët, Kosova importon 1609 GWh (110% rritet në raport me tregun e ndarë) dhe eksporton 2802 GWh (107% rritje). Aktualisht shkëmbimi i energjisë elektrike ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës është shumë i ulët ndoshta i papërfillshëm. Shkëmbimet e energjisë që ndodhin janë kryesisht ndërmjet KEK-ut dhe KESH-it. Në tregun e përbashkët shkëmbimet e energjisë ndërmjet dy vendeve do të jenë të mëdha. Këto shkëmbime janë paraqitur në figurën 3.




Figura 3. Shkëmbimet e energjisë në baza mujore në tregun e përbashkët Kosovë-Shqipëri.

Burimi: Repower

Një element tjetër i këtij tregu është krahasimi i çmimit të energjisë në rastin e operimit të tregjeve të ndara dhe operimi si një treg i përbashkët. Në figurën 4, janë paraqitur çmimet marginale të sistemeve, respektivisht çmimi i ekuilibruar.




Figura 4. Çmimet mesatare mujore në tregun Kosovë/ Shqipëri nëse tregjet operojnë të ndara dhe operojnë si një treg i përbashkët.

Burimi: Repower

Në tregun e përbashkët çmimet e energjisë elektrike kryesisht konvergjojnë në një çmim të njëjtë për të dy zonat për shkak të kapaciteteve të mjaftueshme transmetuese. Po ashtu çmimi rezulton të jetë më i ulët që nënkupton që konsumatorët do të përfitojnë nga ulja e çmimit. Tregu i përbashkët zvogëlon riskun e çmimit të lartë i cili mund

të paraqitet në rastet e tregjeve të ndara që janë rezultat i mungesës së energjisë në treg për shkak të konditave hidrologjike. Në figurën 5, është dhënë çmimi mesatar para dhe pas bashkimit të tregjeve. Në përgjithësi çmimi do të bie në rastin e tregut të përbashkët në të dy tregjet në Kosovë dhe në Shqipëri. Pra në tregjet e ndara çmimi mesatar me shumicë në tregun e Shqipërisë është 52,73 €/MWh, kurse në Kosovë do të jetë 52,01 €/MWh. Në tregun e përbashkët çmimi i energjisë elektrike në Shqipëri do të bie mesatarisht për 10,20% d.m.th. deri 47,35 €/MWh, kurse në Kosovë për 10,34%, pra deri në 46,63 €/MWh .




Figura 5. Krahasimi i çmimit mesatar të energjisë në të dy tregjet nëse operojnë si të ndara dhe nëse operojnë si një treg i përbashkët.

Burimi: Repower

Për shkak të rritjes së kapacitetit transmetues ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë me ndërtimin e linjës 400kV në shumë pak orë brenda vitit (mbi 124 orë) do të kemi kongjestione të cilat kufizojnë shkëmbimet energjetike bazuar në treg ndërmjet dy vendeve. Nga këto të dhëna të përmendura më lart rezulton që përfitimet ekonomike nga bashkimi i këtyre tregjeve janë:

- Optimizimi i kostos së operimit të centraleve
- Rritja e prodhimit nga TC në Kosovë duke e plasuar energjinë elektrike në tregun e Shqipërisë që do të ndikojë në rritjen e të

hyrave për Termocentralet në Kosovë e që kjo bën që Termocentralet të kenë një qëndrueshmëri financiare.

- Ndryshimi i modit të operimit të Hidrocentraleve në Shqipëri duke ofruar energji variable në treg në vend të energjisë bazë ndikon në rritjen e të hyrave të Hidrocentraleve në Shqipëri. Energjia variable dhe e pikut është me kosto më të lartë në treg.
- Zvogëlimi i varësisë nga importet me çmim të lartë
- Rritja e mundësisë për eksport
- Rritja e tregut dhe e diversitetit të burimeve të energjisë elektrike në treg
- Rritja e likuiditetit të tregut
- Rritja e sinjalit për investime të reja në gjenerim dhe në përgjithësi në sektor

Shqipëria ka kapacitete të mëdha të rezervave për balancim të sistemit, përderisa Kosova ka kapacitete të kufizuara për balancim. Pra, Shqipëria dhe Kosova kanë potenciale të mëdha të shkëmbimit të rezervave të balancimit dhe këto rezerva mund të përdoren në përputhje me kodet e reja si kodi i balancimit dhe kodi i rregullimit frekuencë – fuqi. Në veçanti Shqipëria ka kapacitete të mëdha për të ofruar rezerva në treg për balancim të sistemeve. Rezervat balancuese janë shumë të rëndësishme për sistemin elektroenergetik në Kosovë për shkak të njëjësive gjeneruese jofleksibile. Ndarja/shkëmbimi i rezervave dhe dimensionimi i përbashkët i rezervave të sistemit ndërmjet KOSTT-it dhe OST-it ndikon në zvogëlimin e kërkesës së dy sistemeve për rezerva. Kjo nënkupton zvogëlimin e kostos së rezervës dhe kjo ndikon direkt në koston e energjisë të konsumatorët. Çështja e rezervave është një fushë e veçantë studimore që nuk do të jetë pjesë e këtij punimi.

Nga ky studim mund të konkludohet se tregu i përbashkët i energjisë në mes të Kosovës dhe të Shqipërisë është i një rëndësie të veçantë për të dy vendet. Ky treg, përpos që do të mbulojë nevojat për energji të të dy vendeve, do të krijojë edhe mundësi shumë të mëdha për eksporte që do të ndikojë në zhvillim më të madh ekonomik. Me tregun e përbashkët të energjisë Kosova dhe Shqipëria do të jenë më afër Bashkimit Evropian sepse me treg të përbashkët të energjisë, këto vende

pretenduese për anëtare të Bashkimit Evropian, do të kenë plotësuar kritere në një fushë shumë të rëndësishme siç është fusha e energjisë.

Përfundim

Sektori i energjisë ka një rëndësi shumë të madhe në zhvillimin ekonomik të një vendi. Kosova, si një vend që ka aspirata të bëhet shtet anëtar në Bashkimin Evropian, duhet të plotësojë shumë kritere edhe në sektorin e energjisë. Më tej mund të themi se Kosova ka bërë hapa konkret përparimi në këtë sektor. Aprovimi i ligjeve në bazë të kërkesave të Bashkimit Evropian, themelimi Operatorit të Sistemit e të Tregut, si shturja e parë nga kompania e integruar vertikalisht në KEK, privatizimi i distribucionit e investimi në Interkoneksionin 400 kV ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë, janë vetëm nga disa hapat pozitiv që ka marrë Kosova për t'u integruar në tregun rajonal dhe evropian të energjisë. Kur flasim për Interkoneksionin 400 kV ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë, lirisht mund të themi se është hap i parë e konkret që është bërë drejt një tregu të përbashkët regjional e me përfitime të larta për konsumatorët e dy vendeve, kompanive gjeneruese dhe furnizuese në dy vendet. Sipas studimeve të bëra nga USAID-i përmes projektit Repower rezulton që nga tregu i përbashkët Kosovë-Shqipëri kemi përfitime të prodhuesve të Hidrocentraleve në Shqipëri dhe të Termocentraleve në Kosovë, rritjet e shkëmbimeve të energjisë elektrike ndërmjet dy vendeve, uljen e çmimit marginal të dy sistemeve, zvogëlimin e riskut nga rritja e çmimit, nga rritja e likuiditetit të tregut, nga ulja e kostove të rezervave etj. Natyrisht që zgjerimi i tregut dhe bashkimi me tregjet e tjera regjionale është synim i Traktatit të Komunitetit të Energjisë dhe në këtë drejtim tregjet do të rriten deri në tregun e përbashkët të madh të njohur si pan-evropian.

Referencat

1. AECOM Inc & USAID, (2016), Draft – Albania and Kosovo common market study.
2. Bockers,V, Haucap,J & Heimeshof,U. (2013). Benefits of an integrated European electricity market: the role of competition
3. Deitz,L Stirton,L Wright,K. (2009). South East Europe’s electricity sector: Attractions, obstacles and challenges of Europeanisation. *Utilities Policy*. 17 (1), 4-12.
4. European Commission – Energy and Environment
http://ec.europa.eu/competition/sectors/energy/overview_en.html
5. International Energy Agency (IEA) & United Nations Development Programme (UNDP). (2008). Energy in the Western Balkans –The Path to Reform and Reconstruction
<https://www.iaea.org/publications/freepublications/publication/balkans2008.pdf>
6. Joskow,P.L. (2008). Lessons Learned From Electricity Market Liberalization. *The Energy Journal*. Special Issue on the Future of Electricity, 9-42.
7. KOSTT, Buletini nr.9, Viti VII, 2014 -
http://www.kostt.com/website/images/stories/dokumente/buletini/Buletini_9_2014_gusht.pdf
8. KOSTT, Buletini nr.12, Viti IX, 2016 -
http://www.kostt.com/website/images/stories/dokumente/buletini/Buletini_tetor_2016_shq.pdf
9. Ministria e Zhvillimit Ekonomik (2012) - Privatizimi i KKDFE-së, hap i rëndësishëm për të ardhmen energjetike të Kosovës
<http://mzhe-ks.net/sq/lajmet/privatizimi-i-kkdfе-se-hap-i-rendesishem-per-te-ardhmen-energjetike-te-kosoves#.WeIlkFuCzIU>
10. Mwashu,O.N. (2011). The Benefits of Regional Economic Integration for Developing Countries in Africa: A Case of East African Community (EAC)*. *Korea Review of International Studies*. 69-92.

11. Qeveria e Republikës së Kosovës –Vendimi i Qeverisë me nr. 04/36 i datës 17.09.2008.
http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimet_e_Mbledhjes_se_36-te_te_Qeverise_2008.pdf
12. Rahimi, F.A. Vojdani, A. (1999). Meet the emerging transmission market segments. *EEE Computer Applications in Power*. 12 (1), 26-32
13. Salvatore,D. International Economics, 8Ed, Wiley International Edition, USA, 2006
14. Sanfey,P ,Milatovic,J & Kresic,A. (2016). How the Western Balkans can catch up. EBRD.
15. Shahidehpour, M. Alomoush, M. (2001). *Restructured Electrical Power Systems: Operation, Trading, and Volatility*. New-York, Basel: Mercel Dekker, Inc.
16. Srivastava,A K,Kamalasadan,S Pater,D Sankar,S Al-Olimat,K.S. (2011). Electricity markets: an overview and comparative study. *International Journal of Energy Sector Management*. 5 (2), 169-200.
17. USAID, 2017 – Repower Kosovo.
<https://www.usaid.gov/kosovo/fact-sheets/repower-kosovo>
18. Uvalic, M. (ed) (2012). Electricity Markets and Reforms in Europe, Collana di Economia e Politica Industriale, Franco Angeli, Milano. 133-158
19. White Paper on the Future of Europe. (2017). European Commission. https://ec.europa.eu/commission/sites/beta-political/files/white_paper_on_the_future_of_europe_en.pdf

KOSOVA DHE MARRËVESHJA PËR STABILIZIM ASOCIIM ME BE-në

Hykmete Bajrami¹ dhe Lulzim Krasniqi²

Pikëpamjet e shprehura në këtë punim janë të autorëve dhe nuk reflektojnë pikëpamjet e institucioneve ku autorët janë të angazhuar.

Abstrakti

Përmes Marrëveshjes për Stabilizim Asociim (MSA) Kosova ka filluar rrugën e saj të integritit evropian bazuar në parimin e kriterëve të forta të kushtëzimit politik dhe ekonomik. MSA është korniza kontraktuale e bashkëpunimit të Kosovës me BE-në. Rruga transformuese drejt forcimit të ekonomisë së tregut, reformimit institucional dhe konsolidimit të demokracisë – si parakushte për integrim në BE – përbën sfida të konsiderueshme për institucionet e Kosovës. Megjithatë, meqë perspektiva evropiane gëzon mbështetje të lartë publike në Kosovë, është i rëndësishëm institucionalizimi i bashkëpunimit në mes të qeverisë dhe të gjitha grupeve të interesit në avancimin e kësaj agjende.

Ky punim analizon tipologjinë e kriterëve të kushtëzimit politik dhe ekonomik të aplikuar nga BE në kuadër të Procesit të Stabilizim Asociimit, duke vazhduar me shpjegimin e sfidave që kanë të bëjnë me reformat rreth implementimit të MSA-së dhe efektet që këto reforma prodhojnë në strukturën ekonomike të Kosovës.

Hyrje

Kosova ka nënshkruar Marrëveshjen për Stabilizim Asociim (MSA) me Bashkimin Evropian në vitin 2015. Marrëveshja ka hyrë në fuqi që nga muaji prill 2016 duke shënuar kështu fillimin e bashkëpunimit kontraktual të Kosovës me BE-në përmes të cilit bashkëpunim Kosova ka nisur rrugën e saj të integritit evropian.

¹ Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Ekonomik, rr. Agim Ramadani p.n. Prishtinë 10000, Republika e Kosovës, hykmete.bajrami@uni-pr.edu

² Konsulent i UNDP-së, Kosovë.

MSA-ja është komponentë e rëndësishme e Procesit të Stabilizim Asociimit (PSA) për Ballkanin Perëndimor që është strategjia politike e BE-së dedikuar këtyre vendeve me qëllim të stabilizimit dhe transformimit të tyre deri tek ‘anëtarësimi eventual’ në BE (EU Commission, 2005).

Progresi drejt rrugës integruese evropiane të Kosovës, sikurse edhe i vendeve tjera të rajonit, është i bazuar në kriteret e forta të kushtëzimit politik dhe ekonomik, ku përfshihen reforma të gjera në fushën e ekonomisë, të sundimit të ligjit dhe të forcimit të institucioneve demokratike dhe të qëndrueshme.

Një tipar i rëndësishëm i kushtëzimit që përfshin PSA-ja është edhe bashkëpunimi rajonal dhe marrëdhëniet e mira fqinjësore në mes të vendeve të Ballkanit Perëndimor. Kjo nënkupton se rruga integruese drejt BE-së është e kushtëzuar me gatishmërinë e vendeve të rajonit për të kultivuar fqinjësi të mirë dhe për të thelluar bashkëpunimin ekonomik në nivel rajonal, në frymën e vlerave dhe të parimeve të Bashkimit Evropian.

PSA-ja për Ballkanin Perëndimor është e karakterit regjionalist. Megjithatë, progresi i arritur në zbatimin e reformave e përcakton afatin kohor të integrimit në BE të secilit vend individualisht.

Punimi është i organizuar në tri pjesë. Pjesa e parë sjell një interpretim teorik të Procesit të Stabilizim Asociimit për Ballkanin Perëndimor dhe të kriterëve të kushtëzimit politik dhe ekonomik të aplikuar nga BE-ja. Pjesa e dytë analizon disa nga sfidat kryesore rreth implementimit të MSA-së dhe të efekteve që prodhojnë reformat e ndërlydhura me MSA-në në strukturën ekonomike në vend. Pjesa e tretë ofron një përmbledhje të konkluzioneve dhe rekomandimeve duke nënvizuar, në njërin anë, se MSA-ja ofron rrugën e reformimit institucional dhe ekonomik të vendit për të qenë pjesë konkurruese e tregut të përbashkët dhe e mekanizmave institucionalë të BE-së, dhe në anën tjetër, duke konstatuar se MSA-ja, si e tillë, nuk garanton progres zhvillimor në rast se nuk shoqërohet me reforma gjithëpërfshirëse në

fushën e ekonomisë, të sundimit të rendit dhe të ligjit, si dhe të fuqizimit të institucioneve demokratike.

Marrë parasysh se për procesin e integritet në BE ekziston një konsensus i gjerë politik dhe shoqëror në Kosovë, është me rëndësi që zbatimi i reformave të bëhet në bashkërendim me grupet e interesit. Kjo do të sigurote konsistencë dhe efikasitet në implementimin e agjendës evropiane të vendit duke ruajtur mbështetjen e lartë të publikut për procesin integruar, por edhe duke kontribuar në evitimin e tendencës së ‘lodhjes nga reformat’ komplekse me të cilat kanë predispozita të përballen vendet në tranzicion, sikurse Kosova.

Kosova, Procesi i Stabilizim Asociimit dhe kriteret e kushtëzimit politik dhe ekonomik

Pas përfundimit të luftërave në ish-Jugosllavi dhe tranzicionit të vështirë me të cilin po ballafaqohej Shqipëria që nga rënia e sistemit komunist, Bashkimi Evropian lansoi Procesin e Stabilizim Asociimit për Ballkanin Perëndimor. Procesi u dizajnuar me synim që t’u ofronte këtyre vendeve një perspektivë ‘solide dhe realiste’ (Schenker, 2008) për integritet në BE duke aplikuar parimin e kushtëzimit politik dhe ekonomik (political and economic conditionality) në shkëmbim të reformave që secili nga këto vende duhet të ndër marrë. PSA-ja u lansua në qershor të vitit 1999 dhe u fuqizua më tej në Samitin e Selanikut të mbajtur në qershor 2003, duke konfirmuar kështu të ardhmen evropiane për vendet e Ballkanit Perëndimor (EU Commission, 2003).

Qasja regionaliste (regional approach) për Ballkanin Perëndimor, e cila ishte konturuar nga BE në vitin 1996 - menjëherë pas Marrëveshjes së Dejtonit (1995) përmes së cilës iu dha fund luftës në Bosnje dhe Hercegovinë - u zgjerua më tej pas përfundimit të luftës në Kosovë, duke vendosur si kriter të ri të kushtëzimit politik për vendet e Ballkanit Perëndimor edhe ‘bashkëpunimin rajonal dhe marrëdhëniet e mira fqinjësore.’ Bashkëpunimi ndërmjet vendeve tani u vendos si “parakusht për krijimin e lidhjeve më të ngushta me BE-në dhe për përfitimin e asistencës nga BE” (EU Commission, 1999). Ky kriter i ri

BE-së u bë me synimin që vendet e Ballkanit Perëndimor të vendosin themelet e bashkëpunimit fqinjësor dhe rajonal, të forcimit të paqes dhe të krijimit të stabilitetit politik si parakushte të nevojshme për rritjen e bashkëpunimit ekonomik në fusha të ndryshme (ibid.; Bartlett dhe Samardžija, 2000).

Në mënyrë që të nxisë motivimin politik të qeverive në ndërmarrjen e reformave dhe plotësimin e kritereve për anëtarësim, BE-ja mobilizoi resurse financiare dhe mekanizma institucionale për t'i asistuar këto vende në fuqizimin e kapaciteteve institucionale për ndërmarrjen e reformave në sferën e sundimit të ligjit, të forcimit të institucioneve dhe të transformimit drejt modelit të ekonomisë së tregut të lirë (Schenker, 2008).

Në kuadër të strategjisë regjionaliste, BE-ja la po ashtu hapësirë që të marrë parasysh edhe adresimin e nevojave specifike (tipareve individuale) të vendeve veç e veç (p.sh. nëse vendet e dala nga ish-Jugosllavia kishin disa të përbashkëta nga fakti se kishin jetuar brenda një sistemi shtetëror më të hapur dhe ndërveprues ndërkombëtarisht, e njëjta nuk vlente për Shqipërinë, e cila kishte një traditë izolacioniste në rrafshin politik dhe ekonomik. Pra, qasja dominante regjionaliste u kombinua deri në një farë mase me një dozë fleksibiliteti në favor të qasjes individualiste karshi procesit integruar (aty).

Vlen të qartësohet se integrimi final në BE (në kuptimin formal) bëhet përmes parimit bilateralist (bilateralism approach), pra përmes lidhjes së marrëdhënies kontraktuale 'BE – vend aspirues.' Mirëpo, qasja regjionaliste nënkupton adoptimin e një seti të madh reformash politike, ekonomike dhe institucionale (në frymën e vlerave evropiane) të ngjashme për të gjitha shtetet e Ballkanit Perëndimor.

Në këtë kontekst, për t'i dhënë shtytje kësaj agjende dhe për të forcuar pronësinë rajonale në këtë proces, BE-ja sponsoroi (përmes asistencës teknike dhe financiare) mekanizmat që kontribuojnë në thellimin e bashkëpunimit rajonal në shumë fusha (p.sh. përmes mbështetjes së Sekretariatit dhe mekanizmave të CEFTA-s e deri te formimi, në vitin 2008, i Këshillit për Bashkëpunim Rajonal - KBR).

Lavenex (2011) nënvizon se KBR-ja “ilustron një zhvillim i cili ka për qëllim të institucionalizojë forumet rajonale të Ballkanit Perëndimor me qëllim të promovimit të qeverisjes rregullatore në përputhje me kornizën rregullative të BE-së gjatë fazës së paraanëtarësimit.”

Vlen të theksohet se në vitin 2014 me iniciativën e qeverisë gjermane u krijua i ashtuquajtur i Procesi i Berlinit për Ballkanin Perëndimor me synimin që t’i jepet një dinamikë e re rritjes së bashkëpunimit rajonal dhe përfshirjes së vendeve të Ballkanit Perëndimor në iniciativa bashkëpunimi të cilat do t’i “transformojnë këto vende duke ua hapur rrugën drejt Bashkimit Evropian” (Lilyanova, 2016).³

MSA-ja është njëra nga komponentat e rëndësishme të Procesit të Stabilizim Asociimit për Ballkanin Perëndimor i cili proces përfshin katër shtylla bazike, siç janë: Marrëdhëniet kontraktuale në mes të BE-së dhe të vendeve aspiruese (Marrëveshja për Stabilizim Asociim); Marrëdhëniet tregtare (masat autonome tregtare) të cilat tashmë janë zëvendësuar nga Marrëveshjet për Stabilizim Asociim; Asistencë financiare (Instrumenti i Ndihmës së Para-Aderimit – IPA), dhe Bashkëpunimi Rajonal dhe Marrëdhëniet e mira fqinjësore (European Commission, URL).

MSA-ja është udhërrëfyese i agjendës së Kosovës në rrugën transformuese drejt ekonomisë së tregut, të reformimit institucional dhe të ndërtimit të një demokracie të konsoliduar, si kritere bazike për integrim në BE.

Në aspektin e raporteve tregtare me BE-në, duhet theksuar se Preferencat Autonome Tregtare (PAT) të cilat ishin ofruar nga Bashkimi Evropian për vendet e Ballkanit Perëndimor, përfshirë edhe Kosovën, krijuan mundësi për zgjerimin e tregtisë bilaterale me BE-në. Megjithatë, siç vërejnë Kaminski dhe De la Rocha (2003), ato nuk

³ Procesi i Berlinit u lansua pas deklarimit të Presidentit të Komisionit Evropian, Jean-Claude Juncker, në vitin 2014, se nuk do të ketë pranime të reja në BE përgjatë periudhës 5 vjeçare. Kjo iniciativë u komentua si përpjekje për të mos lejuar dekurajimin e vendeve të Ballkanit Perëndimor nga agjenda integruese evropiane dhe bashkëpunimi rajonal.

sollën përfitime të theksuara në drejtim të rritjes së volumit të eksporteve të vendeve të Ballkanit në tregun e BE-së për shkak të fuqisë së ulët konkurruese të këtyre të fundit. MSA-ja, për dallim nga PAT, nuk është vetëm marrëveshje për liberalizimin e tregtisë bilaterale, por shoqërohet me mbështetje direkte (financiare dhe teknike) nga BE-ja lidhur me zbatimin e saj, duke nxitur njëkohësisht vendet e rajonit të përfshihen në procesin e ‘integritit të thellë’ (deep integration) i cili ka synim të krijojë predispozitat për rritjen e fuqisë konkurruese brenda tregut të liberalizuar. Sipas Hoekman dhe Konan (1998, fq. 1) termi ‘integritim i thellë’ nënkupton

“(...) veprime të qarta të ndërmarra nga qeveritë për të reduktuar efektet e segmentimit të tregut, të politikave të brendshme nëpërmjet bashkërendimit dhe bashkëpunimit dhe përfshin masa që kanë të bëjnë me rregulloret e shëndetit dhe sigurisë, specifikimet teknike për produktet (standardet), ligjet e konkurrencës, regjimet e licensimit dhe certifikimit (...) dhe procedurat administrative.”

Siç vë në dukje Lawrence (1997) integritimi i thellë kërkon që vendet të mos kufizohen vetëm në mënjanimin e barrierave kufitare (doganore) dhe në aplikimin e kuotave dhe të tarifave, por të ndërtojnë një bashkëpunim të gjerë dhe të harmonizuar që mbulon shumë fusha rregullatore, duke shndërruar në mënyrë graduale politikat e ndryshme kombëtare në politika të përbashkëta në nivel rajonal.

Me një fjalë, integritimi i thellë, nënkupton një kornizë të përbashkët të politikave rregullatore të cilat bëhen për të ndërtuar parakushtet që mund të ndikojnë në zgjerimin e tregtisë dhe të bashkëpunimit ekonomik midis vendeve sipas rregullave dhe parimeve që aplikohen në Bashkimin Evropian. Kjo strategji, sipas BE-së, kontribuon në thellimin e bashkëpunimit ekonomik në mes vendeve të Ballkanit Perëndimor, në njërën anë, si dhe shtyn përpara procesin e integritit të këtyre vendeve në Bashkimin Evropian.

Përmbajtja, sfidat e implementimit dhe efektet ekonomike të MSA-së

MSA ndërmjet Kosovës dhe BE-së u nënshkrua më 27 tetor 2015. Ratifikimi i saj, nga Kuvendi i Kosovës, u bë më 2 nëntor 2015. Marrëveshja ka hyrë në fuqi më 1 prill 2016. Marrëveshja ka për synim krijimin në mënyrë graduale (brenda një periudhe 10 vjeçare) të një zone të tregtisë së lirë me BE-në në respekt të rregullave të ekonomisë së tregut të lirë.

Përmes MSA-së Kosova ka marrë obligime që të zbatojë reforma gjithëpërfshirëse ku përfshihen ndërtimi i institucioneve të forta demokratike, funksionale dhe efektive, të tilla që do të jenë në gjendje t'u dalin zot sfidave që kanë të bëjnë me procesin e europianizimit të vendit. Në këtë kuadër, vend të veçantë zë edhe adoptimi i *acquis*. Pra, përmes MSA-së Kosova ka marrë përsipër plotësimin e Kriterëve të Kopenhagës - ato politike, ekonomike, dhe kriteret administrative, përkatësisht arritjen e kapacitetit të plotë institucional për të implementuar dhe zbatuar *acquis*-në e BE-së.

Në kuptimin e liberalizimit të tregtisë me BE-në, ngjashëm me marrëveshjet e vendeve të tjera nga Ballkani Perëndimor, MSA-ja është favorizuese për Kosovën për faktin se pothuajse shumica e produkteve kosovare janë liruar menjëherë (me hyrjen në fuqi) nga taksat doganore për t'u eksportuar në tregun e BE-së, me disa përjashtime, sikurse: mishi i viçit, sheqeri, por dhe verërat të cilat, përkundër rritjes së kuotës, janë të kufizuara në kuptimin sasior.⁴ Në anën tjetër, Kosova do t'i heq taksat për import nga vendet e BE-së në mënyrë graduale për periudhën 10 vjeçare. Përgjatë kësaj periudhe parashihet të mundësohet rritja e konkurrueshmërisë së sektorëve prodhues në vend për të ndërvepruar me tregun e BE-së, në njërin anë, si dhe të rritet kapaciteti i agjencive dhe i institucioneve kosovare për të ofruar shërbime cilësore dhe efikase

⁴ Kuota e eksportit të verës kosovare në tregun e BE-së është rritur përmes MSA-së nga 20,000 hekto litra në 50,000 hekto litra në vit.

për bizneset, për produktet dhe për shërbimet e tyre, si dhe për lehtësimin e tregtisë.⁵

Zbatimi i MSA-së zë vend qendror në agjendën politike të vendit. Qeveria e Kosovës ka hartuar Programin Kombëtar për Zbatimin e MSA-së (PKZMSA 2017-2021)⁶ i cili dokument specifikon detyrat dhe obligimet që ndërliken me zbatimin e marrëveshjes për periudhën afatshkurtër dhe afatmesme, ku përfshihen masat si dhe institucionet përgjegjëse për zbatimin e tyre. Përveç PKZMSA-së, është formuluar edhe dokumenti tjetër i quajtur Agjenda për Reforma Evropiane (ARE) ku përfshihen prioritetet kryesore në procesin e aderimit (reformat kyçe ekonomike, fuqizimi i sundimit të ligjit dhe konsolidimit të qeverisjes së mirë), prioritetet të cilat diskutohen në mënyrë të vazhdueshme me Komisionin Evropian nga niveli më i lartë i përfaqësimit politik (shih, PKZMSA 2017-2021).

Lidhur me mekanizmat institucional për mbikqyrjen dhe monitorimin e zbatimit të MSA-së, janë formuar organet e përbashkëta Kosovë – BE, që është Këshilli i Stabilizim-Asociimit, komiteti, nënkomitetet dhe grupet e veçanta, si dhe Komiteti Parlamentar i Stabilizim-Asociimit, si dhe baza ligjore për funksionimin e tyre.⁷

Implementimi i MSA-së përfshin një rrugë të gjerë të transformimit institucional dhe ekonomik. Dhe, siç është evidentuar

⁵ Përmes MSA-së, BE i ofron mbështetje Kosovës në procesin e përgatitjeve për t'u anëtarësuar në organizatat evropiane relevante të infrastrukturës së cilësisë, si: agjencia e standardizimit, agjencia e akreditimit, agjencia e pronësisë industriale, etj.

⁶ Sa i përket përmbajtjes, PKZMSA 2017-2021 përbën një "kornizë gjithëpërfshirëse të reformave afatmesme (për periudhën pesëvjeçare: 2017-2021) për zbatimin e MSA-së dhe përfarimin e legjislacionit kombëtar me atë të BE-së, si dhe zbatimin e legjislacionit të përafuar. Bazuar në strukturën e Kriterëve të Kopenhagës, të gjitha masat dhe prioritetet janë të ndara në tri blloqe: *Kriteret Politike, Kriteret Ekonomike, dhe Standardet Evropiane – Përafrimi i Legjislacionit të Kosovës me Acquis-në e BE-së*. Përveç reformave kyçe politike e ekonomike që kërkon MSA, aty parashihen masa konkrete në kuadër të 33 kapitujve të *acquis*-së së BE-së (me përjashtim të kapitullit 34 dhe 35, të cilët do të mbulohen në një fazë të mëvonshme të aderimit)" (PKZMSA 2017 – 2021).

⁷ Për një shpjegim më të gjerë rreth mekanizmave institucional për zbatimin dhe monitorimin e MSA-së, shih (PKZMSA 2017-2021).

edhe në Agjendën e Selanikut (2003), vendet e Ballkanit Perëndimor kanë mungesa të kapaciteteve, resurseve dhe përvojës për planifikimin dhe për zbatimin e reformave strukturore për të transformuar ekonominë, për të përmirësuar mjedisin afarist, për të rritur kapacitetin absorbues të IHD-ve dhe për të fuqizuar produktivitetin dhe konkurrueshmërinë. Për këtë arsye, siç u tha më lart, BE-ja ka ofruar në dispozicion edhe asistencë për shtetet që ato të rrisin efikasitetin në zbatimin e reformave. Përveç asistencës teknike, BE ofron edhe skemë të financimit të projekteve që ndërlidhen me implementimin e MSA-së, përmes fondeve të IPA-s.

Procesi i liberalizimit të tregtisë me BE-në duhet të përcillet me rol të fortë institucional, për të qenë në gjendje t'u ofrohen bizneseve shërbime efikase administrative, por edhe të krijohen kapacitete të larta zbatuese dhe monitoruese për bizneset sa i përket respektimit të rregullave dhe standardeve të cilat kërkohen përmes MSA-së, sikurse mbrojtja e pronësisë intelektuale, prokurimi publik, politikat e konkurrencës, etj. Pra, roli i institucioneve është i dyfishtë: në njërin anë, institucionet duhen forcuar vetë, në përputhje me standardet e BE-së, dhe në anën tjetër, të ndihmojnë kompanitë në procesin e trajnimit dhe të certifikimit ekuivalent me standardet që kërkohen për të operuar në arenën e tregtisë dhe të afarizmit konkurrues të tregut të BE-së.

Nga aspekti i ndikimit në strukturën ekonomike, integrimi në tregun e BE-së dhe transformimi ekonomik i vendeve aspiruese përcillet me ndryshime thelbësore tek shumë sektorë industrial të cilët duhen përshtatur në një realitet të ri dhe konkurrues. Përvojat nga shumë vende tregojnë se disa industri dalin përfituese nga ky proces, ndërsa disa të tjera nuk mund t'u mbijetojnë sfidave të konkurrencës. Në këtë kontekst të ri, siç thekson Zahariadis (2007), ekonomitë mund të përfitojnë duke u specializuar bazuar në përparësitë krahasuese. Për këtë arsye, sugjerohet që të studiohen me kujdes sektorët premtues të cilët duhen trajtuar me prioritet përmes politikave qeveritare. Vlen të thuhet se Kosova ka potenciale në disa fusha, sikurse sektori i përpunimit të drurit, të metaleve, i teknologjisë së informacionit, i shërbimeve të konsulencës, etj.

Bazuar në përvojat e vendeve të tjera, duhet nënvizuar se përfitimet nga liberalizimi tregtisë me BE-në nuk përcillen me efekte të menjëhershme, por varen nga suksesi i reformave në zbatimin e MSA-së ku përfshihen: angazhimi në fuqizimin e konkurrueshmërisë së bizneseve përmes rritjes së performancës dhe të kapacitetit prodhues,⁸ krijimi i politikave bashkëkohore arsimore, ruajtja e stabilitetit financiar dhe makroekonomik, përmirësimi i infrastrukturës, etj.

Sa u takon humbjeve buxhetore që vijnë si rezultat i lirimit nga taksat doganore të produkteve të importuara nga BE, me avancimin e reformave ekonomike dhe në forcimin e institucioneve këto humbje bëhen jorelevante për shkak të zgjerimit të bazës së tatimpaguesve, zvogëlimit të ekonomisë joformale dhe të rritjes së shkallës së produktivitetit të kompanive, duke transferuar kështu në mënyrë graduale burimin e të hyrave buxhetore të shtetit nga dogana tek vjelja e tatimeve nga aktiviteti ekonomik i realizuar brenda vendit.

Sigurisht, zbatimi i MSA-së, përkatësisht ecja përpara drejt integritet në BE, është sfidë që kërkon mobilizim të të gjitha kapaciteteve shtetërore, të komunitetit të biznesit dhe të shoqërisë civile. Megjithatë, duhet pasur kujdes që ky proces të ketë konsistencë dhe pritshmëri realiste në aspektin kohor të hapave integruar. Sepse, siç thekson Ott (2006) kur bëhet fjalë për shtetet e vogla, me mungesë kapacitetesh institucionale dhe ekspertizë të mjaftueshme për të zbatuar

⁸ Një shembull ilustrues në këtë drejtim është projekti për “Fuqizimin e Konkurrencës dhe Gatishmërisë për Eksport” i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë dhe Bankës Botërore, i cili ka për qëllim rritjen e pozitës konkurruese të prodhuesve kosovarë për eksportim të produkteve të tyre në tregjet ndërkombëtare. Projekti do të ndihmojë në zvogëlimin e kostove për firmat kosovare sa i përket testimit të produkteve dhe marrjes së certifikatave të njohura ndërkombëtarisht duke ua hapur rrugën për depërtim në tregjet e BE-së dhe më gjerë. Përveç të tjerash, projekti do të ndihmojë Agjencinë Kosovare të Metrologjisë dhe të Akreditimit, që të kualifikohen për të nënshkruar marrëveshjet për njohje me Komitetin Ndërkombëtar të Peshave dhe të Masave dhe Forumin Ndërkombëtar për Bashkëpunim dhe Akreditim të Laboratorëve. Ky kualifikim mund të mbështesë qëndrueshmërinë e Sistemit Kombëtar të Infrastrukturës së Cilësisë të Kosovës. Këto përpjekje do të ndihmojnë këtë sistem ashtu dhe laboratorët e vendit që të njihen në tregjet me vlerë të lartë, sikurse ai i Bashkimit Evropian.

detyra me volum të madh dhe afate të ngjeshura, ekziston gjithnjë rreziku që në vend të reformave cilësore mund të krijohet legjislacion dhe politikëbërje jokualitative duke prodhuar edhe rezultate kundërproduktive.

Përfundim

Siç u potencua më lart, përmes MSA-së, Kosova ka nisur rrugën e saj të integritimit evropian bazuar në parimin e kriterëve të forta të kushtëzimit politik dhe ekonomik. Wallace, Polack dhe Young (2010) nënvizojnë se procesi politikëbërës në BE bazohet në përvojat e vendeve të Evropës Perëndimore. Pra, vendeve themeluese të Bashkimit Evropian; me ekonomi të tregut të lirë dhe trashëgimi liberal demokratike. Kushtëzimi politik dhe ekonomik për vendet aspiruese buron nga këto parime të cilat secili nga shtetet që synon anëtarësimin në BE duhet t'i përvetësojë.

Në rastin e integritimit të Kosovës dhe të vendeve të tjera të Ballkanit Perëndimor, BE-ja ka shtuar si kriter thellimin e bashkëpunimit rajonal dhe ndërtimin e marrëdhënieve të mira fqinjësore. Në këtë mënyrë, paralelisht me rrugën integruese në BE, Kosova dhe vendet e rajonit kanë për obligim të rrisin bashkëpunimin ekonomik dhe politik në mes tyre. Synimi i BE-së për të kushtëzuar bashkëpunimin rajonal u bë nën argumentimin se konsolidimi i paqes dhe i sigurisë në rajonin e Ballkanit Perëndimor krijon premisa për zhvillim ekonomik dhe shërben po ashtu si kriter matës i maturimit demokratik të këtyre vendeve për të qenë pjesë e BE-së.

Duhet theksuar se përfitimet ekonomike nga MSA-ja nuk vijnë me automatizëm, por vetëm si rezultat i zbatimit të suksesshëm të reformave, të përmirësimit të mjedisit afarist dhe të rritjes së konkurrueshmërisë së bizneseve vendore përmes adoptimit të standardeve të cilësisë të cilat kontribuojnë në fuqizimin e industrisë dhe në rritjen e besueshmërisë në produkte e shërbime të certifikuar në përputhje me standardet rregullatore të vendeve të BE-së. Po ashtu, harmonizimi i legjislacionit, dhe i kornizës rregullatore në përputhje me

acquis-në kontribuon në ngritjen e besueshmërisë së investitorëve për të sjellë investime kualitative dhe afatgjata duke kontribuar në rritjen e punësimit, transfer të teknologjisë dhe integritet të vendit në zinxhirin ndërkombëtar të vlerës.

Së këndejmi, është e domosdoshme që Qeveria e Kosovës të punojë në rritjen e performancës institucionale për t'u ofruar bizneseve shërbime efikase, dhe (ashtu siç parashihet në Marrëveshjen për Stabilizim Asociim) të ndërmarrë një sërë politikash prioritare, si fuqizimi i industrive me përparësi krahasuese, promovimi i NVM-ve, zhvillimi i kapaciteteve njerëzore, përmirësimi i shërbimeve bankare dhe financiare, ruajtja e stabilitetit makro-ekonomik të vendit, mënjanimi i barrierave tregtare, mbrojtja e pronësisë intelektuale, përmirësimi i prokurimit publik dhe i politikave të konkurrencës, zhvillimi i infrastrukturës, etj.

Është me rëndësi që qasja ndaj agjendës së zbatimit të MSA-së të mos kuptohet si një proces i kryerjes së 'detyrave të shtëpisë' në shkëmbim të progresit në hapat integruar në BE, por si objektiv që ndikon në forcimin e institucioneve demokratike dhe në zhvillimin ekonomik të vendit.

Marrë parasysh se perspektiva evropiane gëzon mbështetje të lartë publike në Kosovë, është i rëndësishëm institucionalizimi i bashkëpunimit në mes të qeverisë dhe të grupeve të interesit në avancimin e kësaj agjende.

Sigurisht, nga ana e saj, BE-ja mund të mbajë të motivuar qeverinë për ekzekutimin e reformave përmes ushtrimit të vëmendjes së duhur në asistencë dhe monitorim, por edhe përmes dhënies së afateve më të qarta kohore për pranim në BE. Mungesa e koncensusit dhe paqartësitë rreth politikës së zgjerimit të Bashkimit Evropian mund të ndikojnë në uljen e dinamikës së zbatimit të agjendës integruare, gjë që do të vononte jo vetëm kohën e anëtarësimit në BE, por do të reflektonte negativisht edhe në ritmin e rritjes ekonomike.

Referencat

1. Bartlett, W. and Samardžija, V., 2000. *The Reconstruction of South East Europe, the Stability Pact and the Role of the EU: An Overview*. MOCT-MOST 2: 245-263. Kluwer Academic Publishers.
2. EC., 1999. *Commission Communication to the Council and European Parliament on the Stabilization and Association process for countries of South-Eastern Europe*. Brussels: European Commission. COM (99) 235.
3. EC., 2003. *EU-Western Balkans Summit*. European Commission [online]. Në dispozicion në: [http://europa.eu/rapid/press-release_PRES-03-163_en.htm]
4. EC., 2005. *Regional cooperation in the Western Balkans: A policy priority for the European Union*. Brussels: European Commission.
5. EC., n.d. *European Neighbourhood Policy And Enlargement Negotiations* [online]. Brussels: European Commission. Në dispozicion në: [https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/policy/glossary/terms/sap_en]
6. Hoekman, B. and Konan, E., 1998. *Deep Integration, Non-discrimination and European Free Trade*. Paper presented at conference Regionalism in Europe: Geometries and Strategies after 2000. Bonn, November 6-8.
7. Kaminski, B., 2001. *How Accession to the European Union Has Affected External Trade and Foreign Direct Investment in Central European Economies*. Policy Research Working Paper 2578. Development Research Group-Trade. Washington DC: The World Bank.
8. Kaminski, B. and De la Rocha, M., 2003. *Stabilization and Association Process in the Balkans: Integration Options and their Assessment*. Policy Research Working Papers. Washington DC: The World Bank.
10. Lavenex, S., 2011. *Concentric circles of flexible 'EUropean' integration: A typology of EU external governance relations*. Comparative European Politics. vol. 9, no. 4-5, p.372-393. Në dispozicion në: [<http://archive-ouverte.unige.ch/unige:76472>]

11. Lawrence, R., 1997. *Preferential Trade Agreements: the Traditional and the Old*. in A.
12. Galal and B. Hoekman eds., *Regional Partners in Global Markets: Limits and Possibilities of the Euro-Med Agreements*. London: Center for Economic Policy Research.
13. Lilyanova, V., 2016. *The Western Balkans' Berlin process: A new impulse for regional cooperation*. Brussels: European Parliament [online]. Në dispozicion në: [[http://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/BRIE/2016/586602/EPRS_BRI\(2016\)586602_EN.pdf](http://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/BRIE/2016/586602/EPRS_BRI(2016)586602_EN.pdf)]
14. Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit [online]. Në dispozicion në: [http://www.mei-ks.net/repository/docs/kosovo-eu_saa_final_sq.pdf]
15. Ott, K., 2006. *Croatian Accession to the European Union: The challenges of participation* [online] in: K. Ott, ed. *Croatian Accession to the European Union: The challenges of participation*. Zagreb: Institute of Public Finance: Friedrich Ebert Stiftung, 1-28. Në dispozicion në: [<http://www.ijf.hr/eng/EU4/eu-eng.pdf>].
16. Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (PKZMSA) 2017 – 2021 [online]. Në dispozicion në: [<http://www.mei-ks.net/sq/pkzmsa-2017-2021>]
17. Schenker, H., 2008. *The Stabilization and Association Process: An Engine of European Integration in Need of Tuning*. JEMIE 7. European Centre for Minority Issues 1.
18. Wallace, H., Polack, M. and Young, A., 2010. *Policy-Making in the European Union*, 6th edition. Oxford: Oxford University Press.
19. Zahariadis, Y., 2007. *The Effects of the Albania-EU Stabilization and Association*
20. *Agreement: Economic Impact and Social Implications*. ESAU Working Paper 17. London: Overseas Development Institute.

REFORMAT STRUKTUREORE DHE KONVERGJENCA EKONOMIKE E BALLKANIT PERËNDIMOR ME BASHKIMIN EVROPIAN

Fatmir Besimi¹

Abstrakti

Rritja e vëmendjes në Brukselit dhe BE për Ballkanin Perëndimor është një sinjal i mirë për procesin e zgjerimit të BE-së të pasuruar me iniciativa të reja si Ballkani Perëndimor 6, Agjenda e Lidhjes, Procesi i Berlinit, Procesi Brdo-Brijuni, Berlin Plus dhe të tjerë. Në vitet e fundit, procesi i zgjidhur i zgjerimit të BE-së për Ballkanin Perëndimor dhe skepticizmi i ngritur brenda anëtarëve të BE-së dhe populizmit në vendet candidate ngacmoi kredibilitetin e këtij procesi i cili kërkon mbështetje të fortë nga BE dhe angazhime serioze nga vendet candidate për të e kthyer Ballkanin Perëndimor rrugë më të shpejt për integrimin në BE.

Konvergjenca: Ekziston evidence e konvergencës, megjithatë hendeku është i lartë dhe procesi është ngadalësuar pas krizës ekonomike

Integrimi në BE ka qenë një proces i rëndësishëm i transformimit ekonomik, politik dhe shoqëror të Ballkanit Perëndimor dhe të konvergencës së tij me Bashkimin Evropian. Gjatë 25 vjetëve të fundit dëshmitë e Ballkanit Perëndimor dhe të Evropës Qendrore dhe Lindore tregojnë se ka pasur një konvergencë me nivelin mesatar të standardit të jetesës të BE gjatë periudhës së tranzicionit të viteve 1990 dhe më vonë përmes procesit të integrimit në BE. Megjithatë, ende vazhdon të ekzistojë një hendek krahasuar me standardin jetësor të BE-së dhe,

¹ Universiteti i Evropës Juglindore, Fakulteti i Biznesit, Tetovë, Maqedoni, f.besimi@gmail.com.

vendet e Ballkanit Perëndimor duhet të përshpejtojnë rritjen ekonomike në mënyrë që të arrijnë nivelin e BE-së. Gjithashtu, në vitet e fundit konvergjenca ka ngadalësim, dhe pas krizës ekonomike ajo është më e ngadalshme në Ballkanin Perëndimor krahasuar me shtetet anëtare të reja të BE-së (Figura 1).




Figura 1. Konvergjenca sipas PBB-së për kokë banori dhe përafrimi

Burimi: Kalkulime të autorit bazuar në të dhëna nga Eurostat: PBB-së për kokë banori (PPS) si përqindje e mesatares së BE-28

Sfida është si të përshpejtohet procesi i integritit në BE dhe konvergjenca ekonomike e Ballkanit Perëndimor me Bashkimin Evropian. Kjo supozon reforma strukturore për të rritur konkurrueshmërinë e ekonomive të tyre. Megjithatë, siç thuhet nga FMN (2015b) "procesi i transformimit strukturor filloi të ulet në mesin e viteve 2000 dhe mbetet e paplotë, përballë interesave të vena dhe lodhjes nga reformat të vendosura". Përveç kësaj, siç procesi i zgjerimit të BE stërzgjetet, Stanfey et al. (2016) argumenton se "mbeten sfida afatgjata, të tilla si ngadalësimi i reformave ...". Duke analizuar në të gjithë kriteret e konvergencës së Kopenhagës, dëshmitë nga Ballkani Perëndimor tregojnë se vendet e rajonit kanë treguar përparim më të ngadalshëm në përmbushjen e kriterëve politike krahasuar me kriteret ekonomike dhe përafrimin me "Acquis" evropian (Figura 2).




Figura 2. Kriteret e konvergencës të Kopenhagës: Progres dhe gatishmëri (2016)

Burimi: Ilustrim i autorit bazuar në Raportet e KE (European Commission, 2015a, 2015b, 2016a & 2016b)

Hapi tjetër është fokusimi në hulumtim të marrëdhënieve midis reformave strukturore dhe të konvergencës ekonomike. Fillimisht, ne shikojmë statistikën krahasuese në lidhje me marrëdhëniet e kriterëve të konvergencës së Kopenhagës dhe PBB-së për kokë banori të vendit, si pjesë e mesatares së BE-28 përmes një diagrami shpërndarës dhe të analizës së thjeshtë të regresionit linear që tregojnë marrëdhënie pozitive në të tri kriteret: politike, ekonomike dhe acquis (Figura 3).




Figura 3. Kriteret e konvergencës të Kopenhagës dhe PBB-së për kokë banori si përqindje e mesatares së BE-28

Burimi: Ilustrim i autorit bazuar në Raportet e KE (European Commission, 2015a, 2015b, 2016a & 2016b) & Eurostat

Reformat strukturore: Reformat strukturore kanë ndikim pozitiv në përafrimin, por ndikimi ndryshon sipas reformave dhe gjatë kohës

Ka një literaturë në rritje e ndikimit të faktorëve strukturorë në konvergencë, megjithëse kryesisht në panelet më të mëdha të vendeve. FMN (2015b) gjeti marrëdhënie pozitive të reformave strukturore me produktivitetin dhe konvergencën, ndërsa në analizën e mëposhtme të literaturës (Acemoglu et al., 2005; Aghion, Howitt dhe Mayer-Foulkes 2005, Campos dhe Coricelli 2002, Che dhe Spilimbergo 2012, Ciccone dhe Papaioannou 2009; Dabla-Norris et al 2016; FMN 2015a; dhe Fung 2009) ata përmbledhin se prioritetet e reformave për qëndrueshmërinë e konvergencës janë gjetur të ndryshojnë me nivelet e të ardhurave. Rezultatet tregojnë se dividenda e produktivitetit varen nga pozicioni ku një vend është në procesin e zhvillimit, duke theksuar nevojën për kalibrimin e reformave në fazën e zhvillimit ekonomik. Siç ekonomitë dhe strukturat financiare zhvillohen dhe bëhen më të sofistikuara, ndryshimet e reformave dhe prioritetet ndryshojnë. Duke përfshirë kërkime për horizonte më të gjata, analiza empirike konstaton se dividendat e produktivitetit ndryshojnë sipas reformave dhe me kalimin e kohës. Rezultatet gjithashtu sugjerojnë se përfitimet e reformave tentojnë të bëhen më të theksuara kur reformat janë të kombinuara bashkë. Për më tepër, përvojat nga vende të ndryshme sygjerojnë mësimet e mundshme për reforma efektive, duke përfshirë rëndësinë e pronësisë së fortë, aftësinë për të mbështetur reformat dhe nevojën për politika plotësuese makroekonomike dhe strukturore. Përkatesisht, reformat e politikave mund të kenë efekte jolineare që mund të jenë të kushtëzuara nga cilësia e institucioneve politike dhe ekonomike.

Çështjet e hapura në literaturë në lidhje me zgjerimin e BE-së dhe të Ballkanit Perëndimor mbeten: afrimi me standardin jetësor të BE-së dhe thellimi i reformave strukturore. Gjegjesisht, Sanfey et al. (2016) shënojnë se "Çështja kyçe është nëse vendet e Ballkanit Perëndimor mund të ngushtojnë hendekun në dekadën e ardhshme dhe, nëse po, çfarë duhet të bëjnë për të arritur këtë". Një përfundim i ngjashëm është bërë nga FMN-ja (2015b) "Atëherë, çfarë duhet të bëhet? Ruajtja e stabilitetit makroekonomik është me rëndësi për rritje

të qëndrueshme... Kryerja e një reforme të thellë strukturore është një prioritet kyç i politikës për rajonin ", thuhet në mënyrë të qartë edhe nga Komisioni Evropian (2015) në 'Strategjinë e Zgjerimit të BE-së': " Zgjerimi duhet të kuptohet si një proces që mbështet reformat dhe ndryshimet fundamentale të nevojshme për të përmbushur detyrimet e anëtarësimit në BE... Zgjerimi mund të jetë i dobishëm për BE-në dhe për vendet partnere vetëm nëse ka një reformë të vërtetë dhe të qëndrueshme. Përmes këtij procesi vendet do të bëhen plotësisht të gatshme për t'u bashkuar me BE-në dhe të jenë në gjendje të përfitojnë, si dhe të marrin detyrimet që rrjedhin nga anëtarësia."

Endogjeniteti: Anëtarësimi në BE ka ndikim pozitiv në konvergencë që sinjalizon për endogjenitetin e procesit të integritit të BE-së

Pas studimeve empirike të mësipërme, ne vazhdojmë me analizën e regresionit të ndikimit të reformave strukturore në konvergencën për Ballkanin Perëndimor dhe të shteteve anëtare të reja për periudhën 1996-2014. Për të hetuar këtë ndikim ne kemi ekzaminuar 25 regresione të të dhënave në panel, pasi korrelacioni i lartë në indekset e reformës kërkon që ata të futen në regresione veç e veç. Kështu regresionet nuk do të japin llogari për komplementaritetet e reformave. Në mënyrë që të mbulojmë më shumë aspekte të reformave, kemi shqyrtuar tri grupe regresioneve për ndikimin e reformave në konvergencë: qeverisja botërore (zëri dhe llogaridhënia, stabiliteti politik, cilësia rregullative, efektiviteti i qeverisjes, sundimi i ligjit, kontrolli i korrupsionit); treguesit e tranzicionit (privatizimi në shkallë të gjerë, privatizimi i vogël, qeverisja dhe ristrukturimi i ndërmarrjeve, liberalizimi i çmimeve, tregtia dhe sistemi i tregut devizor, politika e konkurrencës); dhe indeksi i konkurrencës globale (institucionet, infrastruktura, mjedisi makroekonomik, shëndetësia dhe arsimiti fillor, arsimiti i lartë dhe trajnimi, efikasiteti i tregut, madhësia e tregut, efikasiteti i tregut të punës, zhvillimi i tregut financiar, gatishmëria e teknologjisë, madhësia e tregut, sofistikimi i biznesit). Gjithashtu, interesi i hulumtimit ishte të shqyrtojë ndikimin e anëtarësimit në Bashkimin Evropian në

konvergjencë, në mënyrë që të kontrollojë rreth endogjenitetit të procesit të integritit. Meqenëse marrim parasysh të dhënat e paneleve dinamike ne gjithashtu paraqesim vonesat e variablave të varura për specifikimin më të mirë të modelit, si më poshtë:

$$GC_{c,t} = \alpha_0 + \alpha_{1,l} \sum_{l=1}^L GC_{c,t-l} + \alpha_2 SR_{c,t} + \alpha_3 EU_{c,t} + \varepsilon_{c,t}$$

ku, GC – PBB-ja për kokë banori e vendit si pjesë e PBB-së mesatare të BE-së për kokë banori; SR - reforma strukturore; BE - ndryshore instrumentale për anëtarësimin në BE sipas shteteve; ε - gabim i rastit; α - koeficientet e vlerësuar; L - numri i vonesave (i); dhe indekset c , t - vendi dhe viti. Rezultatet sugjerojnë tri gjetjet e mëposhtme: Konvergjenca është proces afatgjatë dhe i qëndrueshëm; Reformat strukturore kanë ndikim pozitiv në konvergjencën; dhe anëtarësimi në BE rrit konvergjencën. Konvergjenca është proces i qëndrueshëm (persistent) me ndikim të konsiderueshëm të vonesave nga tri vjetët e parë. Ky është një proces stabil në kumulativ me vonesa dyvjeçare, ndonëse vonesa e parë ka një koeficient më të madh se 1, vonesa e dytë është ndikim negativ duke stabilizuar kështu ndikimin kumulativ. Ndikimi i reformave strukturore në konvergjencën është pozitiv dhe statistikisht i rëndësishëm në shumicën e treguesve të reformës. Ndikimi i reformave në konvergjencë bëhet i rëndësishëm kur paraqitet më shumë vonesa të konvergjencës për të kontrolluar efektin e autokorrelacionit. Kjo supozon se ndikimi i reformave është në afat të gjatë për shkak të efektit të qëndrueshmërisë (persistencës). Ndikimi pozitiv i anëtarësimit në BE në konvergjencën, gjegjësisht pas anëtarësimit në BE vendet performojnë më mirë me konvergjencën, tregon endogjenitetin e procesit të integritit në BE, i cili gjithashtu do të ketë implikime politike në adresimin e rolit që BE-ja mund të luajë në përmirësimin e reformave strukturore dhe në integrimin e Ballkanit Perëndimor në BE.

Tabela 1. Ndikimi i reformave strukturore në konvergencë

| Dependent variable: Country's GDP p.c. as a share of average EU-15 | | | | | | |
|--|---------------------------|------------------------------|---|------------------------------|-------------------------------|------------------------------|
| World governance indicators | Voice and accountability | Political stability | Regulatory quality | Governance effectiveness | Rule of law | Control of corruption |
| | 1.723*** (0.393) | 1.360*** (0.525) | 0.762* (0.419) | 1.295*** (0.373) | 0.861** (0.402) | 0.901** (0.394) |
| Transition indicators | Large scale privatisation | Small scale privatisation | Governance and enterprise restructuring | Price liberalisation | Trade and forex system | Competition policy |
| | 0.463*** (0.139) | 0.518*** (0.160) | 0.663*** (0.170) | 0.371* (0.206) | 0.259** (0.127) | 0.361* (0.196) |
| Global competitiveness indicators | Institutions | Infrastructure | Macroeconomic environment | Health and primary education | Higher education and training | Goods market efficiency |
| | 0.578*** (0.137) | 0.0305 (0.513) | 0.00721 (0.246) | 0.622* (0.358) | 0.452 (0.397) | 0.562** (0.248) |
| Innovation | Labour market efficiency | Financial market development | Technology readiness | Market size | Business sophistication | Global competitiveness index |
| | 0.35 (0.428) | 1.228*** (0.184) | 0.680*** (0.210) | -0.0579 (0.245) | -0.19 (0.146) | 1.596*** (0.577) |

Note: *** p<0.01, ** p<0.05, * p<0.1 (Robust standard errors in parenthesis)

M d t i l i A di T bl 1A 2A d3A

Përfundim

Pas analizës së mësipërme empirike mund të përfundojmë me tri vërejtjet e mëposhtme të politikave. Së pari, konvergjenca është një proces i qëndrueshëm (persistent), ndërkohë që ndikimi kumulativ i autokorrelacionit është pozitiv dhe i qëndrueshëm, ka koeficient negativ të autokorrelacionit të vonësës së dytë që mund të interpretohet si pasqyrim i ndikimit negativ fraksional të reformave strukturore në konvergencë për shkak të efektit të shpërndarjes (distribuit) dhe humbjes së përfitimeve (rentave) për grupe të caktuara të interesit në shoqëri. Kjo e fundit hap mundësinë për debatin mbi ekonominë politike të reformave strukturore dhe integrimin në BE. Së dyti, reformat strukturore kanë ndikim pozitiv në konvergencën si një proces afatgjatë, ndërkohë që ndikimi ndryshon përgjatë reformave dhe me kalimin e kohës dhe ndikimi i tyre është gjithashtu jolinear e varet nga cilësia e institucioneve politike dhe ekonomike. Së fundi, dëshmitë

tregojnë se anëtarësimi në BE ka luajtur një ndikim të rëndësishëm pozitiv në konvergencën e shteteve të reja anëtare, që tregon për endogjenitetin e procesit të integritet në BE, kështu që mund të sugjerojmë që BE-ja mund të luajë një rol në përmirësimin e reformave strukturore të besueshme dhe konvergencën e mëtijshme të Ballkanit Perëndimor me BE-në. Prandaj, ne konsiderojmë se 'Qasja e re' dhe iniciativat e reja për mbështetje nga BE-ja do të përshpejtojnë reformat, duke zënë hapin e Ballkanit Perëndimor me BE-në.

Referencat

1. Acemoglu D., Johnson S. & J. Robinson (2005), 'Institutions as a Fundamental Cause of Long-Run Growth', *Handbook of Economic Growth*, Chapter 6, Vol.1, Part A, pp. 385-472
2. Aghion Ph., Howitt P., & D. Mayer-Foulkes (2005), 'The Effect of Financial Development on Convergence: Theory and Evidence', *The Quarterly Journal of Economics*, Vol. February, pp. 173-222
3. Campos N. F. & F. Coricelli (2002), 'Growth in Transition: What We Know, What We Don't, and What We Should', *Journal of Economic Literature*, Vol.11, pp. 783-836.
4. Che N. & A. Spilimbergo (2012), 'Structural Reforms and Regional Convergence', IMF Working Paper , WP/12/106, Washington D.C.
5. Ciccone A. & E. Papaioannou, (2009), 'Human Capital, the Structure of Production, and Growth', *Review of Economics and Statistics*, Vol. 91, Iss.1, pp. 66-82
6. Dabla-Norris E., Ho G. & A. Kyobe (2016), 'Structural Reforms and Productivity Growth in Emerging Market and Developing Economies', IMF Working Paper, WP/16/15, Washington D.C. (February 2016)
7. European Commission (2015), 'EU Enlargement Strategy', Three years strategy on annual basis

8. Fung M. K. (2009), 'Financial Development and Economic Growth: Convergence or Divergence?', *Journal of International Money and Finance*, Vol.28, Iss.1, pp. 56–67
9. International Monetary Fund (2015a), 'Structural Reforms and Macroeconomic Performance: Initial Considerations for The Fund', Staff Report, Washington D.C., (October 2015)
10. International Monetary Fund (2015b), 'The Western Balkans: 15 Years of Economic Transition', Regional Economic Issues, Special Report, Washington D.C., (March 2015)
11. Sanfey et al. (2016), 'How the Western Balkans can catch up', European Banks for Reconstruction and Development, Working Paper No. 185, London (January 2016)

PËRSHTATSHMËRIA E LEGJISLACIONIT TË KOSOVËS ME ACQUIS-COMMUNAUTAIRE TË BASHKIMIT EVROPIAN

Avdullah Hoti¹

Abstrakti

Në këtë punim është analizuar procesi i përafrimit të legjislacionit të Kosovës me atë të BE-së, si dhe janë identifikuar sfidat në këtë aspekt. Bazuar në shumë vlerësime, Kosova është vendi më proevropian në rajon dhe ka koncenzus të gjerë shoqëror për integrimet evropiane, gjë e cila e lehtëson procesin e miratimit të legjislacionit për përafrim me BE-në. Kosova ka bërë progres në ndërtimin e konjunkturës institucionale dhe ligjore që është kompatible me kriteret e BE-së. Në procesin e miratimit të legjislacionit, janë vendosur struktura formale që sigurojnë se legjislacioni i miratuar përputhet me atë të BE-së, i njohur gjerësisht si *'acquis communautaire'*. Megjithatë, mbeten shumë sfida që strukturat institucionale të ndërtuara sipas standardeve të BE-së të kenë kapacitetet e nevojshme njerëzore dhe financiare në zbatimin e këtij legjislacioni. Për më tepër, e drejta evropiane parashih një seri të gjerë të institucioneve komplekse, të pavarura në vendim-marrje, por të ndërtuara në funksionimin efikas dhe të gjithmbarshëm të tyre. Në këtë drejtim, Kosova po përballet me sfida serioze që lidhen me ndërtimin e kulturës për funksionim të pavarur të këtyre institucioneve, por brenda kompleksitetit të përgjithshëm institucional të vendit. Kjo është tepër e rëndësishme për të qar shoqërinë kosovare përpara drejt integritimit evropian.

Hyrje

Në të gjitha matjet e opinionit publik, qytetarët e Kosovës cilësohen si më pro-evropianët në rajon dhe më gjerë. Shteti i Kosovës është formuar me mbështetjen e Bashkësisë Evropiane (BE) dhe të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (SHBA). Që nga fillimi i përpjekjeve për liri dhe pavarësi të popullit të Kosovës në fillim të viteve të 90-ta, pikësynim në ndërtimin dhe konsolidimin e shtetit të Kosovës ka qenë integrimi evropian. Deklarata e pavarësisë e vitit 2008

¹ Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Ekonomik, rr. Agim Ramadani p.n. Prishtinë 10000, Republika e Kosovës, avdullah.hoti@uni-pr.edu.

ka referenca të qarta tek standardet më të mira evropiane që duhen synuar në procesin e ndërtimit të shtetit të ri të Kosovës. Rrjedhimisht, i gjithë legjislacioni i nxjerrë nga institucionet e Kosovës që nga shpallja e pavarësisë më 2008 është trajtuar veçanërisht nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së.

Qëllimi i këtij punimi është analiza e përputhshmërisë së legjislacionit të Kosovës me atë të BE-së dhe identifikimi i sfidave në rrugëtimin drejt BE-së në këtë aspekt. Punimi fillimisht ofron një pasqyrë të platformës mbi të cilën sigurohet integriti i Kosovës në BE. Pastaj, analizohet Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit dhe mundësitë që ofron kjo marrëveshje në lehtësimin dhe qartësimin e rrugës euro-integruese të Kosovës. Këtu në veçanti analizohen kërkesat që dalin nga rregullativa ligjore e BE-së, e njohur si '*acquis communautaire*'. Më tutje analizohen procedurat e nxjerrjes së legjislacionit në Kosovë dhe procesi që siguron se ky legjislacion është në përputhje me '*acquis communautaire*'. Në fund të punimit jepet një vlerësim i arritjeve të Kosovës sa i përket përafrimit të legjislacionit me '*acquis communautaire*' dhe sfidat në të ardhmen e afërt.

Integriti i Kosovës në BE – kriteret

BA-ja, si një organizatë komplekse politike, ekonomike dhe institucionale, ka vendosur kriteret të qarta që duhen përmbushur nga vendet që aspirojnë të bashkohen në këtë organizatë. Sot, vetë termi Bashkim Evropian nxit një sërë kuptimesh, duke filluar nga kriteret për mënyrën e jetesës, të të bërit biznes, të sjelljes në shoqëri, të organizimit të jetës në komunitet, të sjelljes ndaj ambientit, e deri në fundament të përcaktimit të vlerave më elementare humane individuale, të familjes dhe të komunitetit.

Kriteret për integrim në BE janë gjerësisht të ndara në tre grupe, të organizuar në 35 kapituj, që negociohen në detale me secilin vend aspirues gjatë procesit të integritit.

Grupi i parë përfshinë kriteret politike. Këtu në rend të parë hynë stabiliteti institucional i vendit, që nënkupton institucione të

qëndrueshme, të zgjedhura në mënyrë demokratike, që janë përfaqësuese të qytetarëve pa dallim, me ndarje të qartë të përgjegjësi në mes të shtyllave të pushtetit dhe që kanë pavarësi në funksionimin e tyre. Në këtë drejtim, Kosova ka bërë progres në ndërtimin e gjithë kompleksitetit institucional që është kompatibil me kriteret e BE-së. Në vitet e fundit është bërë progres në organizimin më demokratik të mënyrës së përzgjedhjes të përfaqësuesve të institucioneve, megjithëse ka shumë për tu bërë në këtë drejtim. Pavarësia në vendimmarrje e këtyre institucioneve mbetet të forcohet në të ardhmen.

Grupi i dytë i kriterëve mbulon fushën e ekonomisë. BE-ja bazohet në principet e funksionimit të ekonomisë së hapur të tregut dhe kërkon nga secili vend që aspiron të bashkohet me BE-në të ndërtojë një ekonomi të tillë tregu. Megjithatë, niveli i një ekonomie funksionale të tregut në shumë raste është i diskutueshëm. Sot ka plot vende të BE-së që mbajnë brenda sektorit publik kompani apo sektorë të tërë ekonomikë që lehtësisht dhe në mënyrë më efikase mund të funksionojnë në sektorin privat. Prandaj, në këtë drejtim duhen parë edhe interesat strategjike të vendeve kur bëhet fjalë për ndërtimin e ekonomisë së tregut. Përveç kësaj, BE-ja i kërkon secilit vend aspirues ndërtimin e një ekonomie që është e aftë të përballet me konkurrencën që vjen nga tregu i përbashkët. Kjo gjë është përfituese në rend të parë për vendin aspirues. Stabiliteti financiar dhe ai buxhetor po ashtu janë të rëndësishëm si kriterë në vete pasi mundësojnë stabilitet të përgjithshëm ekonomik dhe social në vend. Kontrolli i nivelit të inflacionit dhe i kursit të këmbimit janë gjithashtu të rëndësishëm si kriterë për të përcaktuar stabilitetin e përgjithshëm të një ekonomie në periudha afatshkurtra dhe afatmesme.

Në kuadër të këtij grupi të kriterëve, Kosova ka krijuar kornizën institucionale që në parim siguron funksionimin e ekonomisë së hapur të tregut. Sektori financiar është duke funksionuar mirë, pa ndonjë tronditje për shumë vite me radhë. Ndërkaq, inflacioni ka qenë në nivele të ulëta në shumicën e viteve dhe kryesisht i përcaktuar nga lëvizjet ndërkombëtare të çmimeve të mallrave. Megjithatë, ekonomia kosovare mbetet fragjile, me deficit të lartë tregtar, me eksport të koncentruar në

disa mallra bazë që janë subjekt i ndryshimeve të shpeshta të çmimeve në tregjet ndërkombëtare. Gjendja ekonomike gjithashtu karakterizohet me papunësi të lartë, me varësi të madhe nga remitancat dhe me pjesëmarrje të lartë të konsumit në Bruto Prodhimin Vendor. Investimet janë relativisht të ulëta, duke qenë se kostoja e investimeve ka qenë e lartë deri së fundmi. Të gjitha këto karakteristika ekonomike të Kosovës bëjnë që aftësia e saj konkurruese në tregun e përbashkët të BE-së të jetë e diskutueshme në periudha afatshkurtra dhe afatmesme.

Grupi i tretë i kriterëve, me të cilat merremi në këtë punim, ka të bëjë me aspektin legjislativ apo '*acquis communautaire*'. Në këtë grup të kriterëve hyjnë të gjitha aktet ligjore, rregullativa institucionale, vendimet gjyqësore dhe çështje të tjera të ndërlidhura me këto dhe që përbëjnë të drejtën evropiane.

Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit dhe përafrimi i Kosovës me BE-në

Kosova ende nuk njihet si shtet i pavarur nga ana e pesë vendeve të BE-së. Si rezultat, marrëdhëniet kontraktuale të Kosovës me BE-në janë më specifike krahasuar me vendet e tjera në regjion. Marrëdhënia e parë formale kontraktuale e Kosovës me BE-në shënohet me nënshkrimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (MSA) më 27 tetor 2015. Ky është hapi parë konkret i përafrimit të Kosovës me BE-në.

Kjo marrëveshje është gjithëpërfshirëse në përcaktimin e kriterëve politike, ekonomike dhe ligjore që duhen përmbushur Kosova në rrugën e vet drejt BE-së. Aspektet ekonomike janë pjesë qendrore e kësaj marrëveshje, ku përfshihen çështjet tregtare, çështjet legjislative dhe çështjet e strukturave qeverisëse. Përmes kësaj marrëveshje, BE-ja ndihmon Kosovën në fushën ekonomike gjatë procesit të integritet për të ndërtuar një ekonomi tregu funksionale dhe në përputhje me rregullat dhe standardet evropiane.

MSA-ja do të ndihet sidomos në çështjet tregtare dhe në këtë drejtim kjo është një marrëveshje asimetrike në favor të Kosovës. Prodhimet nga Kosova (përveç atyre me kuota) kanë qasje të pakufizuar

në tregun e BE-së, ndërkaq qasja e prodhimeve nga BE-ja në tregun e Kosovës do të ndodhë në faza përmes një procesi gradual të liberalizimit, i cili merr parasysh aftësinë e ekonomisë kosovare për tu përbashkuar me konkurrencën nga tregu i përbashkët. Për më tepër, për disa produkte që paraqesin potencial ekonomik për Kosovën, liberalizimi i plotë merr deri në dhjetë vjet kohë.

Në rastin e Kosovës, në fushën e kriterëve ekonomike janë dy aspekte shumë të rëndësishme. Aspekti i parë është përafrimi i legjislacionit, në veçanti për cilësinë, pronësinë intelektuale, mbikëqyrjen e tregut, mbrojtjen e konsumatorit, konkurrencën dhe ndihmën shtetërore. Ndërkaq, aspekti i dytë ka të bëjë me ndërtimin e strukturave institucionale funksionale dhe efektive për të mundësuar një ekonomi tregu, siç janë komisioni për mbrojtjen e konkurrencës në treg, inspektorati, agjencia e ushqimit dhe agjencitë e ndryshme dhe konjuktura e institucioneve të drejtësisë që rregullojnë tregun dhe marrëdhëniet ekonomike.

***Acquis communautaire* dhe miratimi i legjislacionit në Kosovë**

Ekziston një konsensus i gjerë shoqëror në Kosovës për integrimet evropiane, e cila gjë në fakt po i përcakton zhvillimet ekonomike dhe shoqërore përgjithësisht. Sigurisht se një konsensus i tillë e lehtëson procesin e arritjes së konsensusit politik brenda institucioneve vendimmarrëse për miratimin e legjislacionit adekuat për përafrim me BE-në.

Duhet theksuar se Kosova ka miratuar legjislacion në përputhje me standardet e BE-së edhe përpara se të nënshkruante MSA-në. Që nga shpallja e pavarësisë më 2008, por edhe përpara saj, Kosova një anshëm ka marrë parasysh kriteret e BE-së në procesin e përgatitjes së legjislacionit të vet dhe në ndërtimin e gjithë infrastrukturës institucionale dhe ligjore. Ndërkaq, sot procesi i miratimit të legjislacionit në Kosovë formalisht është i rregulluar ashtu që siguron se legjislacioni që miratohet është në përputhje me *acquis communautaire*.

Janë një numër rregulloresh dhe aktesh të ndryshme që sigurojnë një proces formal dhe rigoroz të sigurimit të përputhshmërisë së

legjislacionit që nxirren nga institucionet kosovare me *acquis communautaire*. Këtu hyjnë në veçanti Rregullorja 09/2011 për Punën e Qeverisë, Rregullorja 13/2013 për Shërbimin Ligjor Qeveritar, Udhëzimi Administrativ 03/2013 për Standardet e Hartimit të Akteve Normative dhe të akteve të tjera ligjore.

Këto rregullore i obligojnë institucionet që propozojnë dhe nxjerrin akte ligjore që paraprakisht të vlerësojë përputhshmërinë e akteve me të drejtën e BE-së apo *acquis communautaire*. Secili institucion që nxjerr një akt ligjor duhet paraprakisht të sigurojë “*Deklaratën dhe tabelat e përputhshmërisë me të drejtën e BE-së*” për aktin ligjor në shqyrtim, që përgatitet nga Ministria e Integritimeve Evropiane. Procedura standarde e miratimit të legjislacionit në Kosovë është e rregulluar në formën e paraqitur në vijim.




Figura 1: Procesi i përgatitjes dhe i miratimit të akteve ligjore nga institucionet e Kosovës

Burimi: *Qeveria e Kosovës (2014). Udhëzime Praktike për Përafrimin e Legjislacionit të Republikës së Kosovës me Legjislacionin e Bashkimit Evropian. Prishtinë.*

Hapat e paraqitur më lart në procesin e miratimit të legjislacionit janë të obligueshëm nga institucionet që nxjerrin akte ligjore.

Rigoroziteti me të cilin trajtohet çdo legjislacion i ri sa i përket përputhshmërisë me *acquis communautaire* është fuqizuar sidomos pas nënshkrimit të MSA-së. Kështu, në nenin 74 të MSA-së, specifikohet se Kosova do të sigurojë që ligjet e saj gradualisht përafrohen me *acquis communautaire*. Procesi i përafrimit do të shtrihet përgjatë periudhës transitore prej dhjetë vjetësh, të përcaktuar me nenin 9. Në fillim të zbatimit të MSA-së, fokusi do të jetë tek shtyllat kryesore të *acquis communautaire*, që lidhen në veçanti me tregun e brendshëm, me lirinë, me sigurinë e drejtësinë dhe me tregtinë.

Ashtu siç kërkohet nga MSA-ja, në baza të rregullta vjetore miratohet “Plani kombëtar për zbatimin e MSA-së”. Ky plan përcakton detyrat e secilit institucion, legjislacionin që duhet të miratohet dhe afatet kohore dhe implikimet organizative dhe buxhetore të legjislacionit që miratohet. Çdo tre muaj raportohet për progresin, përfshirë në veçanti përafrimin e legjislacionit.

Në kuadër të “Planit Kombëtar për zbatimin e MSA-së”, për secilin nga 35 kapitujt, përcaktohet lista e veprimeve dhe akteve ligjore që duhet të miratohen. Në kuadër të 35 kapitujve përfshihet:

1. Lëvizja e lirë e mallrave
2. Liria e lëvizjes së punonjësve
3. E drejta e themelimit të kompanive dhe liria e ofrimit të shërbimeve
4. Lëvizja e lirë e kapitalit
5. Prokurimi publik
6. E drejta e kompanive
7. E drejta e pronësisë intelektuale
8. Politikat e konkurrencës
9. Shërbimet financiare
10. Shoqëria e informacionit dhe mediet
11. Bujqësia dhe zhvillimi rural
12. Politikat e sigurisë ushqimore, veterinarisë dhe ato të fitosanitarisë
13. Peshkataria

14. Politikat e transportit
15. Energjia
16. Tatimet
19. Politikat sociale dhe punësimi
20. Politikat e ndërmarrjeve dhe ato të industrisë
21. Rrjetet transevropiane
22. Politikat rajonale dhe koordinimi i instrumenteve strukturore
23. Gjyqësori dhe të drejtat themelore
24. Drejtësia, liria dhe siguria
25. Shkenca dhe kërkimet shkencore
26. Arsimi dhe kultura
27. Mjedisi
28. Mbrojtja e konsumatorit dhe e shëndetit
29. Unioni Doganor
30. Marrëdhëniet me jashtë
31. Politika e jashtme, e sigurisë dhe ajo e mbrojtjes
32. Kontrolli financiar
33. Dispozitat financiare dhe buxhetore
34. Institucionet
35. Çështjet e tjera

MSA-ja gjithashtu parasheh që Kosova, në marrëveshje me Komisionin Evropian, do të ndërtojë strukturat për zbatimin e obligimeve që ka Kosova në procesin e integritet evropian. Komisioni Parlamentar për MSA, që përbëhet nga deputetë të Kuvendit të Kosovës dhe të Parlamentit Evropian, takohet në baza të rregullta dhe monitoron obligimet sa i përket përafrimit të legjislacionit që buron nga MSA-ja. Përveç kësaj, BE-ja ka përkrahur vazhdimisht shoqërinë civile që të mbikëqyrë institucionet e vendit, si një formë e përfshirjes qytetare në procesin e integritimeve evropiane.

Përfundim

Kosova ka vendosur procedura të qarta për miratimin e legjislacionit, të cilat procedura sigurojnë se aktet ligjore që aprovohen janë në përputhje me *acquis communautaire*. Ky vlerësim jepet nga shumica e analistëve të fushës dhe nga vlerësime ndërkombëtare të rregullta dhe sporadike sa i përket procesit të integritet evropian të Kosovës. Megjithatë, ka shumë punë për të siguruar zbatim efektiv të legjislacionit të miratuar.

Së pari, duhen ndërtuar struktura institucionale adekuate për zbatimin e legjislacionit. Në plot raste, institucionet zbatuese nuk i kanë kapacitetet e nevojshme për zbatim, si financiare ashtu edhe ato njerëzore. Në këtë drejtim, derisa në nivelin qendror në masë të konsiderueshme janë krijuar këto kapacitete, në nivelin lokal dhe tek institucionet e pavarura ka mungesa të konsiderueshme. Mungesa e të kuptuarit të legjislacionit të BE-së në vendimmarrje të institucioneve të drejtësisë është vërejtur në plot raste. Në veçanti, kjo vërehet në numrin e lëndëve që lidhen me konteste ekonomike, të cilat referohen në gjykata ndërkombëtare. Këtu duhen përmendur posaçërisht klauzolat e kontratave për transaksione ekonomike në mes të bizneseve, të cilat parashohin të referojnë ndonjë mosmarrëveshjeve eventuale në gjykata ndërkombëtare (arbitrazh).

Së dyti, e drejta evropiane parasheh një gamë të gjerë të institucioneve që mbështesin gjyqësorin në mënyrë që të kemi një drejtësi efektive në fushën ekonomike. Këtu përfshihen, në mes të tjerash, noterët, përmbauesit, ndërmjetësuesit dhe institucione të tjera. Është vlerësim i përgjithshëm se këto institucione duhet zhvilluar më tutje, si për nga numri i tyre ashtu edhe nga efikasiteti i funksionimit.

Referencat

1. Bashkimi Evropian (2010). ABC-ja e të drejtës së Bashkimit Evropian. Bashkimi Evropian. Bruksel.
2. Bashkimi Evropian (2013). Si funksionon Bashkimi Evropian: Udhëzuesi juaj për institucionet e BE-së. Bashkimi Evropian. Bruksel.
3. Borçard, Klaus-Diter (2010). ABC-ja e të Drejtës të Bashkimit Evropian. Bashkimi Evropian. Bruksel.
4. Palokaj, A. Dhe Tuhina, Gj. (2016). Çfarë pas MSA: Raportet Kosovës-BE. Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur. Prishtinë.
5. Qeveria e Kosovës (...). Manual për plotësimin e deklaratës dhe tabelave të përputhshmërisë. Prishtinë.
6. Qeveria e Kosovës (2010). Manual për plotësimin e tabelave dhe deklaratës së përputhshmërisë. Prishtinë.
7. Qeveria e Kosovës (2014). Udhëzime praktike për përafrimin e legjislacionit të Republikës së Kosovës me legjislacionin e Bashkimit Evropian. Prishtinë.
8. Qeveria e Kosovës (2015). Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian dhe Komunitetit Evropian të Energjisë Atomike. Prishtinë.
9. Qeveria e Kosovës (2016). Përmbledhje legjislacioni për procesin e hartimit të politikave dhe legjislacionit në Republikën e Kosovës. Prishtinë.
10. Qeveria e Kosovës (2017). Programi kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit 2017-2021. Prishtinë.

INTEGRIMI TREGTAR NË BALLKANIN PERËNDIMOR: CEFTA 2006

Gazmend Qorraj¹

Abstrakti

Ekzistojnë teori të ndryshme sa i përket efekteve të tregtisë së lirë në zhvillimin ekonomik të vendeve të ndryshme. Në përgjithësi ekziston bindja se liberalizimi tregtar ofron mundësi dhe qasje për firma në tregje të reja, ofron asortiment më të larte të produkteve për konsumatorët ndërsa nga këndvështrimi tjetër integrimi tregtar është sfidë për të hyrat buxhetore por edhe për rritjen dhe zhvillimin e firmave lokale si shkak i konkurrencës rajonale dhe globale. CEFTA 2006 si marrëveshje multilaterale e adoptuar nga CEFTA e viteve 90-ta konsiderohet si marrëveshja e pare multilaterale që teston marrëdhëniet rajonale të vendeve të Ballkanit Perëndimor, bazuar në faktin që vendet e rajonit kanë një të kaluar historike me tensione politike dhe raporte jo të mira ndërfaqinësore. Përveç këtij fakti në sfidë shtesë për vendet e Ballkanit e posaçërisht për Kosovën është aftësia konkurruese e firmave në raport me vendet e rajonit. Bazuar në të dhënat nga eksporti dhe importi i Kosovës me vendet e CEFTA-s mund të konkludojmë se Kosova nuk ka mundur të shfrytëzojë mundësitë që ofron tregu i përbashkët i CEFTA-s si pasojë e sfidave me të cilat përballen firmat lokale.

Fjalë çelës: Cefta, integrimi, tregtia e lirë, firmat.

Integrimi ekonomik

Integrimi Evropian si fazë fillestare e konsideron integrimin ekonomik për te vazhduar me integrimin politik, bazuar ne faktin që komponenta ekonomike është me e pranueshme edhe nga vendet me probleme nga e kaluara.

¹ Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Ekonomik, rr. Agim Ramadani p.n. Prishtinë 10000, Republika e Kosovës, gazmend.qorraj@uni-pr.edu.

Integrimi ekonomik nënkuptohet si eliminim i barrierave ekonomike ndërmjet dy apo më shumë vendeve, me qëllim të lëvizjes së lirë të mallrave dhe të shërbimeve, të kapitalit dhe të personave.

Sipas Hitiris (2003), progresi drejt integritit ekonomik varet kryesisht edhe nga vullneti i vendeve anëtare që të transferojnë fuqitë e tyre reale nga vendet e tyre të Bashkimit Evropian. Bazuar në teorinë ekonomike, kryesisht integrimi ekonomik konceptohet si integrim i tregut dhe integrim i politikave ekonomike.

Integrimi i tregut përfshin eliminimin e barrierave tregtare ndërmjet dy apo më shumë vendeve të caktuara. Integrimi i tregut konsiderohet si faza e parë dhe bazë e integritit për të vazhduar me integrimin e politikave ekonomike. Integrimi i Politikave ekonomike përfshin: kooperimin dhe koordinimin e politikave. Ky integrim është më i komplikuar dhe është debat i gjerë për efektet e tij në Bashkimin Evropian, sepse konsiderohet që integrimi i politikave ekonomike kërkon konsensus më të gjerë ndërmjet vendeve pasi që përveç eliminimit të barrierave këtu kërkohet edhe unifikim dhe koordinim i politikave ndërmjet vendeve të ndryshme (Balassa, 1961).

Vlen të theksohen edhe efektet nga integrimi tregtar. Sipas Hine (1994) efektet statike nga integrimi i tregut në periudhë afatshkurtër nënkupton efektet pozitive nga zonat e tregtisë së lirë dhe nga unionet doganore, meqë në këto faza të integritit eliminohen barrierat tregtare dhe unifikohen politikat ndaj vendeve të tjera që nuk bëjnë pjesë në Union.

Ndërsa efektet e tjera statike në periudhë afatmesme janë efektet nga konkurrenca duke e intensifikuar konkurrencën në kuadër të unionit doganor. Po ashtu edhe ekonomizimi i shkallës dhe mobilitetit i faktorëve konsiderohen faktorë shumë të rëndësishëm në kuadër të efekteve statike të integritit të tregut. Ndërsa në periudhë afatgjatë rritja ekonomike konsiderohet faktor i rëndësishëm në kuadër të efekteve dinamike nga integrimi i tregut. Në mënyrë që vendet e Ballkanit Perëndimor të arrijnë integrimin në Bashkimin Evropian,

duhen intensifikuar raportet tregtare ndërmjet vete, por edhe me vendet e Bashkimit Evropian (Hadjinski,2010).

Marrëveshjet e Tregtisë së Lirë

Konsiderohet se marrëveshjet e tregtisë së lirë krijojnë efekte pozitive ekonomike, edhe pse me kalimin e kohës liberalizimi tregtar ka nxitur debate rreth efekteve të marrëveshjeve të tregtisë së lirë dhe në përgjithësi efekteve nga integrimi ekonomik. Autorë të ndryshëm mbështesin idenë se proteksionizmi ju mundëson vendeve që të mbrohen ekonomikisht dhe më vonë të zhvillojnë kapacitetet e tyre prodhuese, në mënyrë që në periudha afatmesme të sigurojnë qasje në tregjet e jashtme. Ndërsa në anën tjetër proceset integruese kërkojnë hapjen dhe liberalizimin e tregut, sepse konsiderohet se hapja dhe integrimi i tregut ju mundësojnë vendeve të ballafaqohen me konkurrencën e tregut dhe të zhvillohen në mënyrë të vazhdueshme. Rast për studim që pasqyron efektet pozitive nga integrimi tregtar janë vendet e Europës Qendrore të cilat pas integritimit tregtar kanë arritur që në vitin 2004 të integrohen suksesshëm në Bashkimin Evropian. Ideja kryesore për krijimin e Marrëveshjeve Tregtare në Evropën Juglindore është arritur dhe nënshkruar në Memorandumin e Mirëkuptimit për Liberalizimin e Tregut në vitin 2001² nga vendet e Evropës Juglindore dhe nga Moldavia.

Qëllimet kryesore ekonomike të kësaj marrëveshje ishin:

- Arritja e marrëveshjeve bilaterale për tregti të lirë me të gjitha vendet nënshkruese deri në fund të vitit 2002.
- Liberalizimi 90% i tregut në Ballkanin Perëndimor deri në fund të vitit 2008.
- Krijimi i një strukture unike të rregullave të origjinës në Ballkanin Perëndimor
- Masa jo diskriminuese lidhur me prokurimin publik, ndihmat shtetërore etj.

² Stability Pact for South East Europe, MOU on Trade Liberalization, June 2001.

- Mbrojtja e pronës intelektuale konform standardeve të OBT-së.
- Harmonizimi i legjislacionit të tregut me atë të Bashkimit Evropian e posaçërisht procedurat doganore, ligji për konkurrencë, ligji për kompanitë etj.

Kosova edhe përkundër sfidave politike të shkaktuara nga disa vende të rajonit ka arritur që të jetë pjesëmarrëse në të gjitha iniciativat për tregti të lirë të iniciuara nga Pakti i Stabilitetit për Evropën Juglindore, dhe njëkohësisht kishte filluar negociatat bilaterale për tregti të lirë me Shqipërinë dhe Maqedoninë si dy vendet fqinje me të cilat ka këmbime tregtare dhe marrëdhënie të qëndrueshme politike.

Objektivat e marrëveshjeve të tregtisë së lirë

Qëllimet kryesore të marrëveshjeve të tregtisë së lirë janë: Liberalizimi dhe zgjerimi i tregut, Përafrimi me rregullat e Bashkimit Evropian si dhe Integrimi gradual në Bashkimin Evropian.

Liberalizimi dhe Zgjerimi i Tregut: Me këtë është arritur harmonizimi i zhvillimit ekonomik dhe konsolidimi i raporteve ndërmjet vendeve nënshkruese përmes zgjerimit të tregtisë. Aspekt tjetër është dhe intensifikimi i aktiviteteve afariste të cilat ndikojnë në rritjen e standardit të jetës, si dhe sigurojnë mundësi të mëdha punësimi, rritjen e produktivitetit dhe stabilitetit financiar. Ky mekanizëm po ashtu ofron partneritet të barabartë ndërmjet palëve me anë të eliminimit të barrierave të ndryshme tregtare.

Përafrimi me rregullat e BE-së: Anëtarësimi në CEFTA nuk nënkupton që vendet t'i plotësojnë të gjitha kriteret menjëherë, por me këtë nënkuptohet që vendet zotohen se do t'i plotësojnë këto kriteret në vazhdimësi. Sipas Nilsson 2006, kriteret të cilat duhet ti plotësojnë vendet në kuadër të CEFTA-s janë³ me sa vijon: Masat sanitare dhe fitosanitare, Rregullat e origjinës, Konkurrenca, Ndihmat shtetërore, Masat antidumping, Shërbimet, Investimet, Prokurimet qeveritare si dhe Të drejtat e pronësisë intelektuale. Kërkohej nga Institucionet e

³ Lars Nilsson (2006): Regional trade Agreements: An EU Perspective, DG Trade, EU Commission.

vendeve anëtare të CEFTA-s që në mënyrë permanente dhe të koordinuar të përmbushin këto kritere në vazhdimësi. Përmbushja e këtyre kritereve krijon efekte pozitive për vendin, por edhe e përafron me standardet e BE-së.

Integrimi në BE: Përveç aspekteve tregtare, CEFTA ka kontribuar edhe për procesin e Integritit Evropian. Anëtarësimi në Bashkimin Evropian gjithnjë ka qenë qëllimi kryesor i vendeve që kanë aderuar në CEFTA. Kjo marrëveshje ka rezultuar si përpjekje e anëtarëve të saj për anëtarësim në Bashkimin Evropian pasi që një pjesë e konsiderueshme e tregut të tyre të jashtëm është me vendet e Bashkimit Evropian. Duhet theksuar po ashtu se është edhe kërkesë e BE-së që një vend duhet së pari të jetë anëtar i CEFTA-s për tu përgatitur që më vonë të jetë anëtar i Bashkimit Evropian, d.m.th. është një mekanizëm tranzitor drejt Bashkimit Evropian. Pesë vendet si Republika Çeke, Hungaria, Polonia, Sllovenia dhe Sllovakia kishin arritur këtë objektiv në vitin 2004 gjersa Rumania dhe Bullgaria janë anëtarësuar në BE në vitin 2007.

Marrëveshja Unike e Tregtisë së Lirë – CEFTA 2006

Vendet e Evropës Qendrore në vitin 1992 kanë arritur pëlqimin për krijimin e një marrëveshje të tregtisë së lirë të njohur si CEFTA. Në të kaluarën kjo marrëveshje ka kontribuar për shumë vite në përmirësimin e marrëdhënieve tregtare, si dhe parapërgatitjen e këtyre vendeve për integrim në Bashkimin Evropian. Marrëveshja është nënshkruar në dhjetor të vitit 1992 në Krakovë të Polonisë me vendet themeluese, si Republikën Çeke, Sllovakinë, Poloninë, Hungarinë ndërsa në vitin 1996 këtij mekanizmi i bashkohet edhe Sllovenia, me 1997 Rumania, me 1999 Bullgaria, me 2003 Kroacia, kurse në vitin 2006 edhe Maqedonia. Në vitin 1996 janë iniciuar negociatat për një aneks të ri që kishte të bëjë me rregullat e prejardhjes së produkteve me të cilin aneks përcaktoheshin rregullat e reja të prejardhjes dhe është nënshkruar më 13 shtator 1996 në Jasna të Sllovakisë. Vendet anëtare të CEFTA-s përveç Hungarisë dhe Polonisë në vitin 1996 kanë filluar që të zbatojnë protokollin për rregullat e prejardhjes. Rregullat e reja të

aplikuara mundësojnë një unifikim të rregullave ndërmjet vendeve anëtare. Kushti për integrimin e vendeve të reja në CEFTA është përcaktuar sipas Deklaratës së Poznanit sipas së cilës një anëtar i OBT-së - Organizatës Botërore të Tregtisë që njëherësh është edhe nënshkrues i Marrëveshjes së Përafrimit me Bashkimin Evropian mund të bëhet anëtar i CEFTA-s, por pas miratimit edhe nga anëtarët e tjerë të CEFTA-s.

Ideja që Marrëveshjes Unike të Tregtisë së Lirë për vendet e Evropës Qendrore - CEFTA-s t'i bashkohen edhe vendet e Evropës Juglindore është lansuar zyrtarisht gjatë viteve 2005 dhe 2006. Kjo ide është mbështetur edhe nga Ministrat e Evropës Juglindore drejtuar Grupit Punues për Tregti të Paktit të Stabilitetit për Europën Juglindore ku është kërkuar që të intensifikohen bisedimet dhe më vonë të arrihet një marrëveshje unike për tregti bazuar në tekstin e mëparshëm të CEFTA-s 2006. Deklarata a konsensusi politik nga kryeministrat e rajonit është arritur në Bukuresht të Rumanisë në vitin 2006 ku kryeministrat e vendeve të Evropës Juglindore kanë arritur pëlqimin politik dhe janë dakorduar që të fillojnë negociatat për zgjerimin⁴ dhe ndryshimin e CEFTA-s nën mbikëqyrjen e Paktit të Stabilitetit, Komisionit Evropian. Nënshkrimi i marrëveshjes së CEFTA-s 2006 është arritur më 19 dhjetor në Bukuresht të Rumanisë ku edhe Kosova arrin të jetë pjesë e marrëveshjes.

Në vazhdimësi shohim të dhëna në lidhje me raportet tregtare të Kosovës me vendet e ndryshme.

⁴ Samiti i Kryeministrave të Evropës Juglindore për zgjerimin dhe ndryshimin e CEFTA-s, Bukuresht 2006.

Tabela 1: Qarkullimi i mallrave në tregtinë e jashtme të Kosovës

| Periudha | Eksportet | Importet | Bilanci tregtar | Përqindja e mbulimit |
|----------|-----------|-----------|-----------------|----------------------|
| 2007 | 165,112 | 1,576,186 | -1,411,074 | 10.5 |
| 2008 | 198,463 | 1,928,236 | -1,729,773 | 10.3 |
| 2009 | 165,328 | 1,935,541 | -1,770,213 | 8.5 |
| 2010 | 295,957 | 2,157,725 | -1,861,769 | 13.7 |
| 2011 | 319,165 | 2,492,348 | -2,173,184 | 12.8 |
| 2012 | 276,100 | 2,507,609 | -2,231,509 | 11.0 |
| 2013 | 293,842 | 2,449,064 | -2,155,221 | 12.0 |
| 2014 | 324,543 | 2,538,337 | -2,213,794 | 12,8 |
| 2015 | 325,294 | 2,634,693 | -2,309,399 | 12,3 |

Burimi: ASK – Statistikat e Tregtisë së Jashtme, 2007-2015

Bazuar në të dhënat nga tabela e mësipërme shohim se Kosova realizon bilanc tregtar negativ, në rritje të vazhdueshme në vlerë absolute duke mbuluar importin me një përqindje simbolike. Në vitin 2007 kemi një përqindje prej 10.5% të mbulimit të importit me eksport, ndërsa deri në vitin 2014 nuk kemi më shumë se 12% përqindjen e mbulimit të importit me eksport.

Tabela 2: Partnerët kryesor për eksport të Kosovës 2014

| Vendet | Vlera ne vitin 2014 | % |
|-----------|---------------------|------|
| Shqipëria | 44,011 | 13.6 |
| India | 27,425 | 8.5 |
| Maqedonia | 35,960 | 11.1 |
| Serbia | 27,292 | 8.4 |
| Belgjika | 716 | 0.2 |
| Italia | 49,660 | 15.3 |
| Austria | 6,416 | 2.0 |
| Mali i Zi | 16,069 | 5.0 |
| Zvicra | 10,038 | 3.1 |
| Gjermania | 11,340 | 3.5 |

Burimi: ASK- Tregtia e jashtme, 2015

Nga tabela më lart mund të analizojmë eksportet e Kosovës për vitin 2014, si dhe analizojmë partnerët kryesorë tregtarë të Kosovës.

Italia për vitin 2014 konsiderohet si një partner tregtar me rëndësi në vlerë prej 49,660,000€ ose më 15.3%.Vendet e tjera ku Kosova eksporton një vlerë të konsiderueshme të mallrave është edhe Shqipëria që përbën rreth 13.6 % për vitin 2014 që do të thotë është njëra nga partnerët kryesor të Kosovës për eksport në rajon.

Nga vendet e tjera ku Kosova eksporton mallra është edhe Maqedonia, Serbia dhe Belgjika që përbëjnë 10.3 %, 9.95 përkatësisht 7.5 %. Nga tabela mund të shihet që partneret kryesore tregtare të Kosovës janë kryesisht vendet e rajonit si Shqipëria, Maqedonia, Mali i Zi, ndërsa nga vendet e BE-së janë: Italia, Gjermania, dhe Austria.

Tabela 3: Partnerët kryesorë për import të Kosovës 2014

| Vendet | Vlera-2014 | % |
|----------------------|------------|------|
| Serbia | 368,234 | 14.5 |
| Gjermania | 272,973 | 10.8 |
| Turqia | 238,268 | 9.4 |
| Kina | 204,789 | 8.1 |
| Italia | 203,068 | 8.0 |
| Shqipëria | 133,702 | 5.3 |
| Maqedonia | 139,668 | 5.5 |
| Greqia | 137,544 | 5.4 |
| Bosnja & Hercegovina | 64,793 | 2.6 |
| Polonia | 55,785 | 2.2 |

Burimi: ASK-Tregtia e jashtme, 2015

Sa i përket importeve nga tabela 3, shihet se Serbia dominon me importe për vitin 2014, e që arrin me 14.5 % të importit të përgjithshëm dhe kryesisht dominon me mallra të konsumit dhe të atij ndërtimor. Partner tjetër prej së cilës Kosova importon është Gjermania që në vitin 2014 arrin me 10.8 % të importit të përgjithshëm që është vend nga i cili importojmë mallra të teknologjisë, industrisë së makinave dhe mallra të tjera. Vendet e tjera nga të cilat importojmë janë edhe Turqia me 9.4%, Kina me 8.1%, ndërsa vendet e rajonit Shqipëria me 5.3 %, Maqedonia me 5.5 % dhe Greqia me 5.4%. Bazuar në të dhënat statistikore konsiderohet se regjioni i Ballkanit Perëndimor, nuk ka arritur të sigurojë rritje ekonomike të qëndrueshme nga liberalizimi tregtar, si dhe nga preferencialet tregtare me BE-në (Kathuria, 2008).

Përfundim

Bazuar në të dhënat e vendeve të Ballkanit Perëndimor e posaçërisht nga të dhënat për eksportet e Kosovës, mund të arrijmë të këto konkludime:

- Liberalizimi tregtar ose integrimi i tregut është proces i domosdoshëm për vendet në procesin e integritit Evropian dhe kusht i përcaktuar nga Bashkimi Evropian.
- Liberalizimi tregtar është parakusht i rëndësishëm por jo i mjaftueshëm për rritjen e eksporteve të Kosovës në mënyrë signifikante.
- Liberalizimi tregtar nuk jep efekte pozitive pa përmirësimin e ambientit biznesor, marre parasysh faktin që ende në tregun lokal ekzistojë barriera biznesore që pengojnë afarizmin e qëndrueshëm të firmave lokale.
- Liberalizimi Tregtar nuk jep efekte pozitive pa përmirësimin e performancës së firmave lokale si: menaxhment të bazuar në edukim me të avancuar, kualitet të produkteve dhe shërbimeve, financim me kosto me të lire, si dhe participim aktiv në programet e Bashkimit Evropian si Erasmus+, Horizon 2020, COSME etj., në mënyrë që firmat të jene pjesë aktive e aktiviteteve inovative.
- Struktura e eksporteve të Kosovës nuk është e favorshme, marre parasysh se vlera e shtuar e produkteve që eksportohen është shumë e ultë.

Ndërsa rekomandimet kryesore për institucionet e Kosovës janë:

- Identifikimin e përparësive krahasuese në nivel nacional pasi që ende ka dilema se në cilin sektor, respektivisht produkt apo shërbime Kosova ka përparësi krahasuese.
- Specializimi është një nga faktorët me rëndësi pas identifikimit të përparësive krahasuese, pra Kosova duhet të specializohet në sektorët në të cilët ka identifikuar përparësitë krahasuese.
- Eksporti i atyre produkteve dhe shërbimeve, duhet mbështetur me metoda proaktive.

- Përmirësimi i strukturës së eksporteve aktuale, dhe lansimi i strategjive konkrete për zëvendësimin e disa importeve nga vendet e rajonit me produkte lokale.
- Po ashtu aspekt tjetër me rëndësi është edhe krijimi i institucioneve efikase me kuadro të përgatitura profesionalisht për adresimin e sfidave dhe përmbushjen e kritereve që rrjedhin nga integrimi i tregut.

Referencat

1. ASK - Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2015.
2. Balassa, B (1961): *The Theory of Economic Integration*, London: Allen and Unwin.
3. Lars Nilsson (2006): *Regional Trade Agreements: An EU Perspective*, DG Trade, EU Commission.
4. Handjiski, B., Lucas, R., Martin, P & Guerin, SS, 2010. *Enhancing Regional Trade Integration in Southeast Europe, World.*
5. Hitiris, Theo (2003) *European Union Economics*, Person Education Limited.
6. Hine, R.C. (1994) *International Economic Integratio*, in Greenaway, D. and Winters, A.L *Surveys in International Trade*, Blackwell, Oxford, 234-72.
7. Kathuria, Sanjay (2008): *Western Balkan Integration and the EU: An agenda for Trade and Growth*, Washington DC, World Bank.
8. Qorraj, G (2010): *Integrating the Western Balkans in to European Union; Overcoming Political and Economic constraints*, *Journal of European Perspectives on Western Balkans*, Vol 2, No.2, pp 79-92.
9. *Stability Pact for South Eastern Europe, Annual Report 2005.*
10. *Stability Pact for South East Europe, MOU on Trade Liberalization*, June 2001.
11. Samiti i Kryeministrave të Evropës Juglindore për zgjerimin dhe ndryshimin e CEFTA-s, Bukuresht 2006.

INFRASTRUKTURA LIGJORE DHE RREGULLATORE NË SEKTORIN E ENERGJISË NË KOSOVË – ANA LIGJORE

Justina Shiroka Pula¹

Abstrakti

Zhvillimi ekonomik i një vendi varet nga shfrytëzimi dhe zhvillimi i burimeve/resurseve natyrore dhe njerëzore, nga politikat dhe reformat e duhura ekonomike dhe shkencore që mundësojnë shfrytëzimin sa me racional të këtyre resurseve natyrore dhe njerëzore.

Energjia është burim që rrjedh nga burimet natyrore, është një nga përparësitë e favorshme dhe e cila na mundëson një zhvillim me të qëndrueshëm ekonomik.

Qëllimi i këtij punimi është të paraqitet analiza dhe infrastruktura ligjore dhe rregullatore e energjisë, në harmonizim me legjisllacionin e BE-së dhe me direktivat përkatëse të BE-së që kanë të bëjnë me energji. Hartimi dhe zbatimi i infrastrukturës ligjore në fushën e energjisë në Kosovë, është një ndër përparësitë me të mëdha në zhvillimin e politikave energjetike.

Fjalë çelës: energji, legjisllacion, infrastrukturë, strategji, analizë.

Hyrje

Burimet natyrore dhe njerëzore, janë pjesë e rëndësishme e çdo shteti, që krijojnë dhe ofrojnë avantazhe konkurruese për tërheqjen e investimeve kapitale, janë esenciale për zhvillim të qëndrueshëm.

Prandaj një ndër mundësitë dhe përparësitë për një zhvillim ekonomik në Kosovë është edhe energjia. Përgjegjësitë për qeverisjen dhe rregullimin e sektorit të energjisë e përcakton dhe e rregullon legjisllacioni në fuqi.

¹ Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Ekonomik, rr. Agim Ramadani p.n. Prishtinë 10000, Republika e Kosovës, justina.pula@uni-pr.edu.

Hartimi i politikave, organizimi, rregullimi dhe menaxhimi i sektorit të energjisë në Kosovë bëhet nëpërmjet infrastrukturës ligjore dhe rregullatore që përgjithësisht është në përputhje me *Acquis Communautaire*² të BE-së për energjinë. Kosova është nënshkruese e Traktatit të Komunitetit të Energjisë (TKE). I cili është një hap i rëndësishëm në harmonizimin e legjislacionit të Kosovës në sektorin e energjisë me atë të BE-së. Nënshkrimi i këtij traktati është detyrim i Kosovës që t'iu përmbahet obligimeve që vijnë nga direktivat e KE-së (Directive 96/92/EC, Directive 2003/54/ EC and Directive 2009/72/EC). Këto direktiva synojnë të dizajnojnë një treg eficient, konkurrues dhe të qëndrueshëm, por njëherësh edhe të harmonizojnë tregjet nacionale brenda BE-së.

Politika ekonomike dhe strategjia zhvillimore

Zhvillimi i qëndrueshëm i sektorit energjetik dhe shfrytëzimi racional i burimeve energjetike duhet të jetë prioritet i politikave ekonomike, zhvillimore. Përmes këtyre politikave rregullohen dhe prezantohen politikat dhe strategjia e energjisë, të cilat propozohen nga qeveria dhe ministria përgjegjëse në konsultim me palët e interesuara. Në institucionet e sektorit përfshihen institucionet qeveritare, rregullatore dhe ndërmarrjet energjetike.³

Institucionet kryesore Energjetike janë:

MZHE (Ministria e Zhvillimit Ekonomik) - është përgjegjëse për krijimin e politikave energjetike dhe marrjen e vendimeve për këtë sektor, të cilat promovojnë reformat e tregut dhe qeverisjen e mirë.

ZRrE-ja⁴ (Zyra e Rregullatorit të Energjisë) - bën rregullimin ekonomik të sektorit dhe licencimin e operatorëve të tregut të energjisë.

² *Acquis Communautaire* të BE- përmbledhje e legjislacionit të BE-së për energjinë.

³ MEM (Ministria e Energjisë dhe Minierave), (2009), Strategjia e Energjisë 2009-2018 (MEM), paraqet rishikimin e Strategjisë së Energjisë së Kosovës për periudhën 2005-2015 (MEM).

⁴ Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRE) dhe Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Tregut (KOSTT) janë themeluar në vitin 2004 e përcjellë nga shthurja e KEK-ut.

ZRrE-ja po ashtu bën rishikim dhe miratimin e tarifave dhe monitorimin e tregut të energjisë.

KPMM (Komisioni I Pavarur për Miniera dhe Minerale) - luan një rol të rëndësishëm në dhënien e licencave për hulumtim dhe shfrytëzim të resurseve natyrore, si dhe në tërheqjen e Investimeve vendore dhe të huaja në sektorin e minierave.

Përveç këtyre institucioneve energjetike, ndikim të konsiderueshëm në zbatimin dhe menaxhimin e sektorit energjetik kanë edhe këto institucione dhe Komunitat: MMPH (Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor) - përgjegjëse për Ambientin - duke filluar nga caktimi i zonave që janë me interes të veçantë deri te dhënia e Pëlqimeve ambientale apo Vlerësimit në ndikimin në mjedis, MTI (Ministria e Tregtisë dhe e Industrisë; MPMS (Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale) dhe MF (Ministria e Financave),⁵ Komunitat - përgjegjëse për përgatitjen e planeve zhvillimore komunale.

Ndërmarrjet energjetike kryesore janë:

Republika e Kosovës qysh nën administrimin e UNMIK-ut ka filluar të harmonizojë sistemin elektroenergjetik me atë të BE-së. Shturja e aktiviteteve të transmisionit KOSTT-it në njërin anë dhe KEK-ut (gjenerimit, shpërndarjes dhe furnizimit) në anën tjetër, është një detyrim që vjen nga direktiva e parë dhe e dytë (96/92/EC dhe 2003/54/EC).

- KOSTT (Operatori i Sistemit, Transmetimit dhe i Tregut të Energjisë Elektrike),
- KEK-u (Korporata Energjetike e Kosovës), është i organizuar në dy Divizione qenësore, Divizionin e Mihjeve dhe në Divizionin e Gjenerimit. Korporata operon me mihjen sipërfaqësore të linjtit (gjegjësisht Mihjen e Sibovcit Jugperëndimor) dhe dy termocentralet (TC "Kosova A" dhe TC "Kosova B"),

⁵ Rregullorja me Nr.01/2012 për Themelimin dhe funksionimin e komisionit për certifikimin të auditorëve dhe Menaxherëve të Energjisë.

- KEDS dhe CESCO (Kompania për Distribuim dhe Furnizim me Energji elektrike),⁶ dhe
- Ngrohtorja e Qytetit

Në Kuvendin e Kosovës diskutohen dhe miratohen të gjitha dokumentet e rëndësishme për sektorin e energjisë, të cilat i sjell Ministria Përkatëse, përkatësisht MZHE.⁷ Dokumentet e rëndësishme për këtë sektor janë: Strategjia e energjisë, Programi për Zbatimin e strategjisë së energjisë dhe rishikimin e saj,⁸ Politikat energjetike, dhe Ligjet e energjisë.

Në këtë drejtim janë zhvilluar dhe miratuar politika⁹ dhe strategji¹⁰ energjetike, për sektorin e energjetikës, të cilat janë në përputhje me direktivat e BE-së. Qëllimi i strategjisë duhet të zërthehet ne Objektiva strategjike, si dhe në masa e aktivitete që duhen ndërmarrë. Dokumenti Strategjik¹¹ duhet të paraqet rrugën që do të ndiqet dhe masat që do të ndërmerren për sektorin energjetik: për të plotësuar kuadrin ligjor dhe rregullator, për të investuar, në mënyrë që të plotësohen kërkesat (të cilat janë në rritje) për shërbime energjetike më cilësore, për të identifikuar burimet e reja të energjisë, dhe të rritur eficiencën në përdorimin e energjisë në të gjithë sektorët e ekonomisë.

⁶ Procesi i shthurjes përfundoi me privatizimin e shpërndarjes dhe furnizimit në vitin 2013 dhe shthurjen e tyre në KEDS dhe CESCO në vitin 2015.

⁷ MZHE (Ministria e zhvillimit Ekonomik), e cila është ristrukturuar në vitin 2011, nga MEM (Ministria e Energjisë dhe e Minierave).

⁸ Ministria përkatëse po ashtu përgatiti programin 3 vjeçar të zbatimit të strategjisë së energjisë dhe rishikimin e saj.

⁹ MEM (Ministria e Energjisë dhe Minierave), *Politikat energjetike dhe rregullimi ekonomik*, Strategjia e Energjisë 2009-2018;

¹⁰ Kosova ka miratuar disa strategji të energjisë:

✓ MEM (Ministria e Energjisë dhe Minierave), (2006), *Strategjia e Energjisë 2005-2015*;

✓ MEM (Ministria e Energjisë dhe e Minierave), (2009), *Strategjia e Energjisë e Republikës së Kosovës 2009-2018*;

✓ MZHE (Ministria e Zhvillimit Ekonomik), (2016 Draft), *Strategjia e Energjisë 2017-2026*;

¹¹ Shiroka-Pula, J (2010),” *Zhvillimi i Energjetikes sipas qasjes Evropiane prioritet i Qeverisë*”, Magazina Evropiane–SOROS, Nr.1: Fondacioni Kosovar për shoqëri të hapur-SOROS, fq. 7-9

Këto sfida mund të tejkalohen nëse në periudhën afatmesme deri atë afatgjatë, zbatohet një politikë ekonomike dhe një strategji zhvillimore adekuate e cila do të synojë reformimin dhe ristrukturimin e sektorit energjetik.

Vizioni i strategjisë për sektorin energjetik duhet të përfshijë:¹²

- Reformat e orientuara drejt tregut, në mënyrë që të tërhiqen investime kapitale, përmes një procesi të hapur, transparent dhe konkurrues në kuadër të një partneriteti Publik–Privat
- Zhvillimin e tregut konkurrues dhe pa monopol të energjisë, në pajtim me *acquis* të BE-së dhe me Traktatin për Komunitetin e Energjisë për Europën Juglindore, përmes së cilit do të mund të ofronte shërbime energjetike të cilësisë së lartë, me teknologji që nuk dëmtojnë mjedisin.

Strategjia e energjisë i kushton vëmendje të veçantë përputhshmërisë me “*acquis communautaire*”¹³ të Bashkimit Evropian. *Acquis* të BE-së që për sektorin e energjisë, janë të obligueshme për Kosovën, si anëtare në *Traktatin e Komunitetit të Energjisë* (TKE). Përmes Strategjisë së Energjisë është përcaktuar korniza ligjore dhe rregullatore e energjisë që përbën bazën ligjore për organizimin dhe menaxhimin e sektorit të energjisë.

Korniza Ligjore

Përgjegjësit për qeverisjen dhe rregullimin e sektorit të energjisë i përcakton dhe i rregullon legjislacioni në fuqi. Në vitet e fundit është arritur progres i ndjeshëm në aspektin ligjor, rregullativ dhe institucional në fushën e energjetikës, por mbetet akoma shumë hapësirë për t’i implementuar dhe monitoruar.¹⁴

¹² Po aty, fq. 6.

¹³ EU *Acquis Communautaire*: <http://www.ero-ks.org>.

¹⁴ Shiroka Pula, J., Leno, V. dhe Surdulli, S. (2012), “Për një zhvillim të qëndrueshëm të bazuar në resurset minerare dhe njerëzore në Kosovë”, Konferencë- Resurset Minerare : Instituti për Hulumtime Ekonomike “Globus”, Prishtinë, fq. 43-44.

Baza ligjore

Korniza ligjore-përkatësisht ligjet e përbëjnë bazën Ligjore për organizimin dhe menaxhimin e sektorit energjetik. Ligjet e energjisë të cilat janë hartuar deri më tani janë:

1. Ligji Nr. 05/L-081¹⁵ për energjinë,¹⁶
2. Ligji Nr. 05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë,¹⁷
3. Ligji Nr. 05/L-085¹⁸ për energjinë elektrike,¹⁹
4. Ligji Nr. 04/L-016 për eficiencyn e energjisë,²⁰

¹⁵ Ligji për energjinë, përcakton parimet e përgjithshme të strategjisë energjetike dhe programit energjetik në Kosovë; rregullat për sigurimin e furnizimit të qëndrueshëm dhe efikas të energjisë, si dhe shfrytëzimin e burimeve të ripërtërishme të energjisë: vendosjen e rregullave tregut të energjisë: masat e tjera të domosdoshme për sigurimin e furnizimit të duhur të aktiviteteve në sektorin e energjisë.

¹⁶ Ligji Nr.05/L-081 për energjinë, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës /Nr.24/13 korrik 2016, Prishtinë. (Ligji paraprak 2010 / 03-L-184).

- Udhëzim Administrativ (QRK) Nr. 09/ 2017 Për Zyrat Komunale të Energjisë, është miratuar në mbledhjen e 154 të Qeverisë së Kosovës, me Vendimin Nr.03/154, i 30.08.2017.
- Udhëzim Administrativ (MZHE) Nr.06/2017 Për Promovimin e Shfrytëzimit të Energjisë nga Burimet e Ripërtërishme, i 07.08.2017.
- Udhëzim Administrativ (MZHE) Nr. 05/2017 Caqet e Energjisë nga Burimet e Ripërtërishme, i 23.06.2017.
- Udhëzim Administrativ (MZHE) Nr.01/2017 Për Promovimin e Investimeve të përbashkëta rajonale në sektorin e energjisë, i 20.02.2017.
- Udhëzim Administrativ (MZHE) Nr.04/2017 Mbi Rregullat për masat kufizuese të furnizimit me energji në situata emergjente, i 03.05.2017.

¹⁷ Ligji Nr.05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr.25 / 14 korrik 2016, Prishtinë. (Ligji paraprak 2010 / 03-L-185).

¹⁸ Ligji për energjinë elektrike, vendos kushtet për kryerjen e aktiviteteve të prodhimit, bartjes, të distribuimit, të furnizimit, të tregtimit, të eksportimit, të importimit dhe të transitit të energjisë elektrike; organizimin e sistemeve elektroenergjetike dhe organizimin e tregut të energjisë elektrike.

¹⁹ Ligji Nr.05/L-085 për energjinë elektrike, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 26 / 21 korrik 2016, Prishtinë. (Ligji paraprak 2010 / 03-L-201).

- Udhëzim Administrativ (MZHE) Nr.07/2017 lidhur me nivelin e rezervave të lëndëve djegëse për prodhuesit e energjisë elektrike, i 07.08.2017.

²⁰ Ligji Nr.04/L-016 për eficiencyn e energjisë, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr.6 / 22 korrik 2011, Prishtinë.

- Marrëveshja bilaterale ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Dukatit të Madh të Luksemburgut, nënshkruar më 24.10.2016.

5. Ligji Nr. 05/L-052 Për Energjinë Termike,²¹
6. Ligji Nr. 02/L-103 për pajisjet nën presion,²²
7. Ligji Nr. 05/L-082 për gazin natyror.²³
8. Ligji Nr. 03/L-116 për ngrohje qendrore.²⁴

Ligjet përcjellëse:

- Ligji Nr. 04/L-045 për partneritet publiko privat,²⁵
- Ligji Nr. 04/L-220 për investime të huaja,²⁶
- Ligji Nr. 05/L-079 për investime strategjike në Republikën e Kosovës.²⁷
- Ligji Nr. 02/L-123 për shoqëri tregtare.²⁸

Rëndësinë më të madhe për rregullimin e sektorit të energjisë e kanë katër ligjet e para të energjisë, nga të cilat dalin edhe aktet

-
- Udhëzim Administrativ (QRK) Nr.01/2012 për auditimin e energjisë, i 30.01.2013.
- ²¹ Ligji Nr.05/L-052 për energjinë termike, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr.40/31 Dhjetor 2015, Prishtinë, Ky ligj shfuqizon Ligjin Nr.03 / L-116 për ngrohje qendrore.
 - ²² Ligji Nr.02/L-103 për pajisjet nën presion, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës /Nr.24/01 maj 2008.
 - ²³ Ligji Nr.05/L-082 për gazin natyror, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës /Nr.24/13 korrik 2016, Prishtinë. (Ligji paraprak 2009 / 03-L-133).
 - Udhëzimi Administrativ (MZHE) Nr.08.2017 Për Sigurinë e Furnizimit me Gaz Natyror, nënshkruar date 23.10.2017.
 - ²⁴ Ligji është miratuar në Kuvend me 20.12.2008, Kurse është shpallur me Dekretin e Presidentit të Republikës së Kosovës nr. DL-066-2008, Data 13.12.2008, (Mirëpo Ligji për energjinë termike Nr.05/L-052, shfuqizon Ligjin Nr.03 / L-116 për ngrohje qendrore).
 - ²⁵ Ligji Nr.04/L-045 për partneritet publiko privat, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës /Nr.26/25 Nr.26/25 nëntor 2011, Prishtinë.
 - ²⁶ Ligji Nr.04/L-220 për investimet e huaja, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës /Nr.01/09 janar 2014, Prishtinë.
 - Udhëzim Administrativ (MTI) Nr.01/2015 për formën dhe përmbajtjen e regjistrimit të investimeve të huaja, i 04.03.2015.
 - ²⁷ Ligji Nr.05/L-079 për investimet strategjike në Republikën e Kosovës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr.06/08 shkurt 2017, Prishtinë.
 - ²⁸ Ligji Nr.02/L-123 për shoqëritë tregtare, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës /Nr.39/01 tetor 2008, Prishtinë.

nënligjore me karakter edhe teknik, të cilat do të paraqiten në punim si legjislacion sekondar energjetik.

*Aktet nën ligjore*²⁹ të miratuara nga Ministria përkatëse janë në funksion të punës, me qëllim të qasjes dhe të informimit të zyrtarëve të institucioneve dhe për persona të tjerë lidhur me të drejtat dhe përgjegjësit e tyre.

Legjislacioni sekondar

Sa i përket legjislacionit sekondar, Kosova ka hartuar disa rregullore dhe udhëzime administrative, që rregullojnë funksionimin e ligjshëm të energjisë dhe zbatimin e tij.

Rregulloret në fushën e energjisë dhe auditimit³⁰ **të energjisë:** bëjnë rregullimin, funksionimin, organizimin e brendshëm të AEE (Agjencisë së Eficiencës së Energjisë) në Kosovë, auditimin e energjisë në ndërtesa të shërbimeve publike, etj. Këto rregullore janë në përputhje me ligjet e energjisë dhe bëjnë pjesë si legjislacion sekondar në kuadër të akteve nënligjore.

Udhëzime administrative: rregullojnë zbatimin e energjisë dhe të energjisë alternative në fushën e projekteve energjetike, duke u zbatuar nga institucionet përgjegjëse dhe operatorët ekonomikë. Këto udhëzime kanë të bëjnë me caqet e BRE-ve (Burimet e ripërtërishme të energjisë), promovimin e EE (Eficiencës së Energjisë), rregullat për balancet e energjisë, kushtet për konsumatorët e privilegjuar, për hapjen e tregut të energjisë për të gjithë konsumatorët jo familjar etj.³¹

²⁹ MEM, (2011), “Aktet nënligjore” të miratuara për periudhën 2005-2010: Ministria e Energjisë dhe e Minierave Prishtinë.

³⁰ Rregullore Nr.01/2012 për themelimin dhe funksionimin e Komisionit për Certifikim të Auditorëve dhe Menaxherëve të Energjisë.

³¹ MEM, (2011), “Aktet nënligjore” të miratuara për periudhën 2005-2010: Ministria e Energjisë dhe e Minierave Prishtinë.

Legjislacioni i BE-së

Kosova ka harmonizuar një mori dokumentesh dhe legjislacionin me Legjislacionin (*acquis*) të BE-së, në fushën e energjisë.³² *EU Acquis Communautaire*, që nënkupton përmbledhjen e legjislacionit të BE-së për energji, gaz, energji të ripërtërishme, eficiencë të energjisë dhe statistika, direktiva këto që janë adaptuar si përmbledhje legjislative të Republikës të Kosovës me ato të BE-së.

Prioritet i Qeverisë në Republikën e Kosovës, sa i përket integritimeve evropiane për sektorin e energjisë janë:

- Procesi i mekanizmit përcjellës për Stabilizim-Asocim me BE-në,
- Pjesëmarrja në Traktatin e Komunitetit të Energjisë, dhe
- Zhvillimi i bashkëpunimit dy palësh.

Standardet (Rregullat Teknike dhe Kodet Teknike)

Standardet³³ energjetike i referohen çdo standardi të sistemit teknik që zbatohen brenda komunitetit evropian. Këto standarde janë të nevojshme për të shfrytëzuar në mënyrë të sigurt dhe efikase sistemet e rrjetit (që përfshin aspektet e transmetimit, konjeksionet ndërkuftare, rregullimet). Standardet e përgjithshme (të sigurisë) të sistemit teknik, mundën me u zbatuar përmes Komitetit Evropian për standardizim (CEN), Komitetit Evropian për Standardizim Elektroteknik (CENELEC), për Energjinë Elektrike (UCTE) dhe Shoqatës Evropiane për Efikasitetin e Shkëmbimeve Energjetike (Easeegas), dhe në këtë mënyrë – apo përmes kësaj qasje vendosen rregulla të përbashkëta dhe praktikata e punës.³⁴

³² ZRR (Zyra e Rregullatorit të Energjisë), Legjislacioni i BE-së: <https://www.ero-ks.org>.

³³ Ligji për standardizim, (2004/12), vendos rregullat për procedurat e hartimit, përshtatjes, përvetësimit, miratimit dhe aplikimit të standardeve në Kosovë; përcaktimit të statusit të tyre; të certifikimit të produkteve, të proceseve, të shërbimeve, të sistemeve të cilësisë dhe të personelit, me qëllim të mbrojtjes dhe të aplikimit të standardeve në Kosovë, në përputhje me standardet ndërkombëtare në mënyrë që të sigurohet një nivel i caktuar i cilësisë, me përjashtim të rasteve kur në ligj përcaktohet ndryshe.

³⁴ Traktati për komunitetin e energjisë, ” *Pajtueshmëria me standardet përgjithësisht të zbatueshme të komunitetit evropian*”; Standardet përgjithësisht të zbatueshme në fushën e energjisë, (Kapitulli VI- neni 23), fq.11.

Rregullat teknike - janë standardet³⁵ që burojnë nga specifikat teknike të produkteve të ndryshme që identifikohen me specifikime të veçanta. Rregullat teknike janë aktet nënligjore me karakter teknik të cilat i përcaktojnë karakteristikat e produkteve, të proceseve të produkteve të tyre, ku përfshihen edhe masat administrative që zbatohen në rast të shkeljes së tyre. Rregullat teknike kanë për qëllim: Mbrojtjen e jetës së njerëzve dhe të shëndetit të tyre, Mbrojtjen e ambientit dhe të vlerave të tjera të natyrës, Mbrojtjen e ambientit të punës të njeriut, Mbrojtjen e konsumatorit të produkteve dhe të shfrytëzuesit të shërbimeve, Mbrojtjen përkatësisht të interesit në një proces të caktuar, Sigurimin teknik të objekteve, të pajisjeve dhe të veglave, Sigurimin e procesit të punës, etj.

Kodet teknike - përshkruajnë objektivat, rolin dhe përmbajtjen, duke ofruar një informacion të përgjithshëm për industrinë elektroenergjetike dhe strukturën e tregut të energjisë elektrike në Kosovë; KOSTT (OSTT - Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe Tregut), miratojnë një numër të kodeve teknike (Kodi i rrjetit, Kodi i matjes, Kodi i pajisjeve elektrike, Kodi i standardeve efektive , Kodi i punës për qasje në tokë dhe në ndërtesa); ZRRE-ja (Zyra e Rregullatorit për Energji), ka miratuar një numër të kodeve teknike që janë në fuqi. Këto kode kanë të bëjnë me matjen, rrjetin, Kodin e kyçjes, Kodin për stacione gjeneruese të energjisë me erë, Kodin e matjes së OSSH-së etj.

Përfundim

Resurset minerale/energjetike janë esenciale për një zhvillim ekonomik dhe social të qëndrueshëm. Shfrytëzimi i këtyre resurseve është fundamental për çdo sektor të ekonomisë.

Infrastruktura ligjore, rregullatore dhe institucionale, si dhe masat e domosdoshme që duhen ndërmarrë në fushën e energjisë, janë sfida

³⁵ Ligji për standardizimin (**2009/03-L-144**), është miratuar në Kuvend më 30.09.2009, kurse është shpallur me Dekretin e Presidentit të Republikës së Kosovës nr. DL-028-2009, të 19.10.2009.

kryesore për arritjen e zhvillimit ekonomik dhe rruga e integritit ekonomik, rajonal dhe evropian.

Kosova ka harmonizuar një mori dokumentesh dhe legjislacionin me legjislacionin (*acquis*) e BE-së, në fushën e energjisë. Infrastruktura ligjore dhe rregullatore në fushën e energjisë rregullon legjislacionin dhe politikat energjetike në harmonizim me atë të BE-së. Në bazë të aspektit ligjor zhvillohen dhe implementohen politikat, strategjitë dhe korniza ligjore për reformimin dhe ristrukturimin e sektorit energjetik në pajtueshmëri me *acquis* të BE-së. *Hartimi dhe zbatimi i infrastrukturës ligjore në fushën e energjisë në Kosovë, është një ndër përparësitë me të mëdha në zhvillimin e politikave energjetike.*

Strategjia e energjisë duhet t'i kushton vëmendje të veçantë përputhshmërisë me '*acquis communautaire*' të Bashkimit Evropian. *Acquis* të BE-së që për sektorin e energjisë, janë të obligueshme për Kosovën, si anëtare në *Traktatin e Komunitetit të Energjisë* (TKE). Përmes Strategjisë së energjisë janë / duhet të përcaktohet korniza ligjore dhe rregullatore e energjisë që përbën bazën ligjore për organizimin dhe për menaxhimin e sektorit të energjisë. Rishikimi i strategjive të energjisë, duhet të bëhet të paktën një herë në tri vjet, pasi që me kalimin e kohës dhe gjendjes ekzistuese dhe pasuese, ato mund të ndryshojnë dhe të bëhen plotësime shtesë në to.

Me hartimin dhe zbatimin e legjislacionit primar dhe sekondar në Kosovë, janë implementuar disa projekte për energji, eficiencë të energjisë, për BRE, auditim energjetik, projekte këto të cilat janë vlerësuar shumë lart, dhe njëkohësisht kanë gjetur zbatim të madh në Kosovë.

Legjislacioni në Kosovë duhet të kontribuojë në zhvillimin e standardeve jetësore dhe një mirëqenie kombëtare duke promovuar zhvillim të qëndrueshëm të të gjitha resurseve energjetike që ka Kosova dhe duke siguruar eksploatim efikas dhe efektiv të këtyre resurseve.

Referencat

1. Shiroka-Pula, J (2010),”Zhvillimi i Energjetikes sipas qasjes Evropiane prioritet i Qeverisë”, Magazina Evropiane – SOROS, Nr.1: Fondacioni Kosovar për shoqëri të hapur - SOROS.
2. Shiroka Pula, J., Leno, V. dhe Surdulli, S. (2012), “Për një zhvillim të qëndrueshëm të bazuar në resurset minerare dhe njerëzore në Kosovë”, Konferencë - Resurset Minerare: Instituti për Hulumtime Ekonomike “Globus”, Prishtinë: Qeveria e Republikës së Kosovës.
3. MEM (Ministria e Energjisë dhe e Minierave), (2006), *Strategjia e Energjisë 2005-2015*, Prishtinë: Qeveria e Republikës së Kosovës.
4. MEM (Ministria e Energjisë dhe e Minierave), (2009), *Strategjia e Energjisë e Republikës së Kosovës 2009-2018*, Prishtinë: Qeveria e Republikës së Kosovës.
5. MZHE (Ministria e Zhvillimit Ekonomik), (2016 Draft), *Strategjia e Energjisë 2017-2026*, Prishtinë: Qeveria e Republikës së Kosovës.
6. MZHE (Ministria e Zhvillimit Ekonomik), (2012). *Strategjia Minerare e Republikës së Kosovës 2012-2025*. Prishtinë: Qeveria e Republikës së Kosovës.
7. ZRRE. (2015). *Raporti Vjetor 2015*. Prishtinë: ZRRE.
8. EC. (1997). Directive 96/92/EC of the European Parliament and of the Council of 19 December 1996 concerning common rules for the internal market in electricity. *Official Journal of the European Communities, L(027)*, fv. 20-29.
9. EC. (2003). Directive 2003/54/EC of the European Parliament and of the Council concerning common rules for the internal market in electricity and repealing Directive 96/92/EC. *Journal of the European Communities, L(176)*, fv. 37-55.
10. EC. (2009). Directive 2009/72/EC of the European Parliament and of the Council Concerning Common Rules for the Internal

- Market in Electricity and Repealing Directive 2003/54/EC. *Official Journal of the European Union, L211*, fv. 55-93.
11. TKE - Traktati për Komunitetin e Energjisë, ” *Pajtushmëria me Standardet Përgjithësisht të Zbatueshme të Komunitetit Evropian*”; Standardet Përgjithësisht të Zbatueshme në fushën e energjisë, (Kapitulli VI- neni 23).
 12. Ligji Nr.05/L-081 për energjinë, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës /Nr.24/13 korrik 2016, Prishtinë.
 13. Ligji Nr.05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr.25/ 14 korrik 2016, Prishtinë.
 14. Ligji Nr.05/L-085 për energjinë elektrike, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 26 / 21 korrik 2016, Prishtinë.
 15. Ligji Nr.04/L-016 për efikasitet të energjisë, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr.6 / 22 korrik 2011, Prishtinë.
 16. Ligji Nr.05/L-052 për energjinë termike, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr.40/31 dhjetor 2015, Prishtinë.
 17. Ligji Nr.02/L-103 për pajisjet nën presion, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës /Nr.24/01 maj 2008, Prishtinë.
 18. Ligji Nr.05/L-082 për gazin natyror, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës /Nr.24/13 korrik 2016, Prishtinë.
 19. Ligji Nr.04/L-045 për partneritet publiko privat, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/ Nr.26/25 Nr.26/25 nëntor 2011, Prishtinë.
 20. Ligji Nr.04/L-220 për investimet e huaja, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës /Nr.01/09 janar 2014, Prishtinë.
 21. Ligji Nr.05/L-079 për investimet strategjike në Republikën e Kosovës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr.06/08 Shkurt 2017, Prishtinë.
 22. Ligji Nr.02/L-123 për shoqëritë tregtare, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës /Nr.39/01 Tetor 2008, Prishtinë.
 23. MEM, (2011), “Aktet nënligjore” të miratuara për periudhën 2005-2010: Ministria e Energjisë dhe e Minierave Prishtinë.

24. Rregullore Nr.01/2012 për themelimin dhe funksionimin e Komisionit për Certifikim të Auditorëve dhe të Menaxherëve të Energjisë.
25. Udhëzim Administrativ (QRK) Nr. 09/ 2017 për Zyrat Komunale të Energjisë, është miratuar në mbledhjen e 154 të Qeverisë së Kosovës, me Vendimin Nr.03/154, të 30.08.2017.
26. Udhëzim Administrativ (MZHE) Nr.06/2017 për promovimin e shfrytëzimit të energjisë nga burimet e ripërtërishme, 07.08.2017.
27. Udhëzim Administrativ (MZHE) Nr. 05/2017 caqet e energjisë nga burimet e ripërtërishme, 23.06.2017.
28. Udhëzim Administrativ (MZHE) Nr.01/2017 Për Promovimin e Investimeve të përbashkëta rajonale në sektorin e energjisë, 20.02.2017.
29. Udhëzim Administrativ (MZHE) Nr.04/2017 Mbi Rregullat për masat kufizuese të furnizimit me energji në situata emergjente, 03.05.2017.
30. Udhëzim Administrativ (MZHE) Nr.07/2017 Lidhur me Nivelin e Rezervave të lëndëve djegëse për prodhuesit e energjisë elektrike, 07.08.2017.
31. Marrëveshja Bilaterale ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Dukatit të Madh të Luksemburgut, nën shkruar më 24.10.2016.
32. Udhëzim Administrativ (QRK) Nr.01/2012 Për Auditimin e Energjisë, 30.01.2013.
33. Udhëzimi Administrativ (MZHE) Nr.08.2017 Për Sigurinë e Furnizimit me Gaz Natyror, nënshkruar më 23.10.2017.
34. Udhëzim Administrativ (MTI) Nr.01/2015 Për Formën dhe Përbajtjen e Regjistrit të Investimeve të huaja, 04.03.2015.

EUROIZIMI NË KOSOVË: STABILITETI FINANCIAR DHE DISA ASPEKTE MAKROEKONOMIKE

Valentin Toçi¹ dhe Arben Mustafa²

Hyrje

Euroizimi në Kosovë ka rrjedhur në mënyrë të “natyrshme” për shkak të përdorimit të gjerë të valutave të huaja, sidomos Markës gjermane, në kohën e ish-Jugosllavisë ekonomia e së cilës ka shfaqur probleme të mëdha strukturore dhe makroekonomike, përfshirë stabilitetin monetar dhe fiskal. Pas përfundimit të luftës, Kosova adoptoi Euro-n si valutën e saj zyrtare përmes rregulloreve të UNMIK-ut. Sidoqoftë, kushtetuta e Kosovës nuk heqë mundësinë e futjes së valutës nacionale në përdorim. Ekzistojnë një varg përfitimesh të përdorimit të Euro-s, si sigurimi i stabilitetit makroekonomik dhe financiar, por edhe disa dobësi afatshkurtra. Ky artikull ofron një analizë të ndikimit të euroizimit në ekonominë e Kosovës, duke u fokusuar kryesisht në kufizimet që euroizimi i ka shkaktuar politikës monetare në aspektin e instrumenteve për sigurimin e stabilitetit financiar dhe, në anën tjetër, përfitimet i ka sjellë për të arritur këtë qëllim. Nëse prospektet e anëtarësimit në BE janë të qarta dhe me një afat të parashikueshëm kohor, atëherë një politikë alternative, ajo e futjes së valutës nacionale do të ishte jofizibile. Kjo, nën supozimin që Euro do të jetë zgjedhje e qëndrueshme e BE-së.

¹ Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Ekonomik, rr. Agim Ramadani p.n. Prishtinë 10000, Republika e Kosovës, valentin.toçi@uni-pr.edu

² Universiteti “Kadri Zeka”, Gjilan, Republika e Kosovës, arben.mustafa@uni-gjilan.net

Adoptimi i Euro-s në Kosovë

Termi ‘dollarizim’ është përdorur në literaturën ekonomike për t’iu referuar përdorimit të gjerë të valutës së huaj krahas një valute nacionale ose adaptimit të valutës së huaj si valutë zyrtare në një vend. Më vonë, me futjen e Euros në përdorim, edhe termi ‘euroizim’ ka filluar të përdoret gjerësisht për t’iu referuar vendeve që përdorin Euron gjerësisht ose si valutë zyrtare. Bazuar në Nenin 11, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës “Në Republikën e Kosovës si mjet i vlefshëm pagese përdoret një valutë e vetme.”

Humbja e besimit në Dinarin jugosllav në vitet e ’80-ta e posaçërisht vitet e ’90-ta si rezultat i hiperinflacionit dhe problemeve në strukturën e atëhershme financiare, ekonomike dhe politike, ka bërë që valutat konvertibile, posaçërisht Marka gjermane të jetë *de facto* valutë e përdorur gjerësisht. Në vazhden e kësaj, pas përfundimit të luftës Marka gjermane u shndërrua *de facto* në valutën zyrtare të Kosovës. Me fillimin e përdorimit të Euro-s si valutë zyrtare në Eurozonë, Kosova filloi procesin e konvertimit Markave gjermane në euro dhe me këtë rast adoptoi euro-n si valutën e saj zyrtare.

Përdorimi i Markës gjermane është i rregulluar me Rregulloren dhe Udhëzimin Administrativ të UNMIK-ut 1999/04 dhe 1999/02 respektivisht, që ka bërë Markën gjermane valutë të lejuar e më pas mjet pagese për llogaritë dhe pagesat zyrtare. Më pas, konvertimi në Euro është rregulluar përmes Direktivës së UNMIK-ut 2001/24 ku praktikisht Kosova hyn në regjimin e ashtuquajtur *euroizim i njëanshëm*. Konvertimi në Euro u bë nën udhëheqjen e Bankës Qendrore dhe me përkrahjen e institucioneve vendore e ndërkombëtare.

Një nga funksionet kryesore të Bankës Qendrore është furnizimi i ekonomisë me valutën Euro. Sidoqoftë, Kosova si vend i euroizuar njëanshëm nuk është pjesë e eurozonës dhe të ashtuquajturit ERM I dhe II (*angl.* Exchange Rate Mechanism) të cilat janë menduar të jenë kriter konvergjence për vendet anëtare në çështje monetare, fiskale, inflacion dhe politikë të kursit të këmbimit. ERM ishte pjesë e Sistemit Monetar Evropian që kishte për qëllim të stabilizojë valutat në BE-së duke i

paraprirë Unionit Ekonomik dhe Monetar dhe futjes së valutës së përbashkët Euro në vitin 1999. Konvertimi nga valutat nacionale në Euro në vendet e eurozonës u bë në vitin 2002. Për rastet si Kosova dhe Mali i Zi, që me anëtarësim në BE dhe eventualisht në eurozonë, aspekti legal është i paqartë. Sidoqoftë, Rostowski (2001) nënvizon se “euroizimi i njëanshëm nuk është ilegal”.

Përdorimi i Euro-s si valutë zyrtare ka disa përparësi. Së pari, ka siguruar stabilitet makroekonomik. Për shembull, stabiliteti fiskal është siguruar për arsye se është e pamundur të monetizohet borxhi. Rrjedhimisht, kjo zgjedhje ka imponuar një vetëdisciplinë fiskale. Së dyti, mbështet tregtinë duke eliminuar rrezikun e normës së këmbimit dhe duke zvogëluar kostot e transaksioneve. Kjo është posaçërisht e rëndësishme për Kosovën duke qenë se pjesa më e madhe e tregtisë së Kosovës realizohet me vendet e eurozonës dhe me vendet që kanë politikë të kursit fiks apo kuazi fiks të këmbimit me valutën euro. Zvogëlimi i rrezikut nga kursi i këmbimit paraqet një përfitim të rëndësishëm edhe për stabilitetin financiar. Përdorimi i valutës euro dhe besimi i lartë i publikut në këtë valutë ka bërë që bilanci i gjendjes i sektorit bankar në Kosovë pothuajse në tërësi të jetë i denominuar në valutën euro, gjë e cila minimizon rrezikun nga kursi i këmbimit. Së treti, frika nga fleksibiliteti karakterizon shumë vende në zhvillim. Risku i normës së këmbimit është ngushtë i lidhur me riskun sovran, rrjedhimisht, shumë vende që kanë valutat nacionale ndjekin politika të kursit fiks apo kuazi fiks të këmbimit. Përdorimi i një valute të qëndrueshme dhe me besueshmëri të lartë ka zvogëluar rreziqet nga zhvlerësimi i mundshëm i saj, duke kontribuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në stabilitetin e çmimeve në Kosovë.

Në anën tjetër, ekzistojnë edhe disa disavantazhe që rezultojnë nga euroizimi i njëanshëm. Së pari, mundësia për të absorbuar tronditjet në ekonomi duhen kërkuar përtej politikës monetare, përmes instrumenteve strukturore që mundësojnë mobilitetin e faktorëve të prodhimit, fleksibilitetin e pagave dhe çmimeve, diversifikimin e ekonomisë dhe reforma të tjera strukturore. Rrjedhimisht, bankat qendrore në ekonomitë me eurizim të njëanshëm kanë në dispozicion

një varg më të kufizuar të instrumenteve të politikës monetare të cilat do të mund të përdoren për të ndikuar në objektivat makroekonomike siç janë rritja ekonomike, stabiliteti i çmimeve, si dhe në objektivat e stabilitetit financiar, rëndësia e të cilat për të qenë një ndër objektivat primare të bankave qendrore po rritet çdo ditë e më tepër.

Euroizimi, politika monetare dhe stabiliteti financiar

Stabiliteti financiar është bërë një objektivi i rëndësishëm për çdo bankë qendrore. Bankat qendrore mund të ndjekin objektivat e stabilitetit financiar kryesisht nëpërmjet dy instrumenteve të politikave, duke përfshirë politikën monetare, e cila vepron kryesisht nëpërmjet normave afatshkurtra të interesit për huat për bankat dhe së fundi politikat makroprudenciale. Kohët e fundit, veçanërisht pas krizës, përdorimi i politikës monetare për qëllime të stabilitetit financiar është rritur në shumë vende dhe një numër i bankave qendrore tashmë kanë përfshirë stabilitetin financiar brenda objektivave të tyre kryesore. Por, si mundet një bankë qendrore të ndjekë objektivat e stabilitetit financiar nëpërmjet instrumenteve të politikës monetare dhe a janë instrumentet e politikës monetare gjithmonë efektive në ndjekjen e objektivave të stabilitetit financiar? Po në lidhje me bankat qendrore (p.sh. rastin e Kosovës) që nuk kanë politikë monetare? A mund të jenë ende efektive në ruajtjen e sektorëve të qëndrueshëm financiarë? Në vazhdim do të adresohen këto pyetje në kontekstin e Kosovës.

Mënyra më e zakonshme e politikës monetare për të ndjekur objektivat e stabilitetit financiar është të përfshihet në sjellje kundërciklike duke përcaktuar normat e interesit, të cilat janë më të larta se ajo që do të kërkohej për stabilizimin e inflacionit ose të prodhimit kombëtar. Në këtë drejtim, vendosja e normave të larta të interesit mund të dekurajojë familjet dhe firmat që të marrin hua dhe, nga ana tjetër, mund t'i inkurajojë bankat që të ulin shkallën e tyre të levës. Prandaj, pritet që normat e larta të interesit të ulin nivelin e rrezikut. Gjithashtu, bankat qendrore që kanë autonomi mbi politikën monetare mund të përdorin instrumente të politikës monetare për të rritur ofertën e parasë

dhe të ushtrjnë funksionin e huadhënësit të instancës së fundit (LOLR) duke injektuar likuiditet në bankat që gjenden në vështirësi.

Duke thënë këto, ne mund të shohim se instrumentet e politikës monetare mund të përdoren për të përmirësuar ose rivendosur stabilitetin financiar. Megjithatë, a janë gjithmonë të efektshëm për ta bërë këtë? Le të shqyrtojmë disa çështje që sugjerojnë se politika monetare mund të mos jetë domosdoshmërisht efektive si një mjet për të mbrojtur stabilitetin financiar. Duke vendosur norma më të larta interesi, banka qendrore mund të dekurajojë huamarrjen dhe mund të zvogëlojë shkallën e levës te bankat, por në të njëjtën kohë mund të zvogëlojë kërkesën agregate dhe të dobësojë aktivitetin e përgjithshëm ekonomik, duke zvogëluar kështu kapacitetin e huamarrësve për të shlyer kreditë e tyre. Gjithashtu, kur detyrimet kanë norma të ndryshueshme dhe afate të shkurtra të maturimit, atëherë rritja e normave të interesit mund të rrisë barrën e borxhit. Në këtë mënyrë, politikat që rrisin normën e interesit mund të dobësojnë më tej kapacitetin e huamarrësve për të shlyer kreditë e tyre. Kjo tregon se politika monetare, ndonëse një mjet i rëndësishëm, ka kufizimet e veta dhe nuk mund të shërbejë si një mjet i gatshëm për të ndjekur objektivat e stabilitetit financiar.

Përveç kësaj, pavarësisht nga rritja e rëndësisë së stabilitetit financiar, shumica e bankave qendrore janë kryesisht të zëna me stabilitetin e çmimeve dhe me objektivat e stabilitetit të prodhimit kombëtar. Në këtë drejtim, bankat qendrore mund të ballafaqohen me pengesa mes objektivave të stabilitetit financiar dhe të objektivave të tyre tradicionale, të cilat janë stabiliteti i çmimeve dhe stabiliteti i prodhimit ose punësimit. Prandaj, angazhimi në sjelljen kundërciklike, d.m.th. duke rritur normën e interesit, përfshin pagesën e një kosto afatshkurtër duke ndikuar negativisht në prodhimin ose punësimin në këmbim të përfitimit afatmesëm në formën e kostove më të ulëta të pritshme nga kriza financiare (IMF, 2015). Kjo ndërhyrje në mes të objektivave mund të dëmtojë besueshmërinë e bankës qendrore në publik, sepse kostot afatshkurtra në terma të prodhimit më të ulët ose të punësimit janë shumë lehtë të vëzhgueshme nga publiku, ndërsa

përfitimet afatmesme në terma të uljes së kostove të pritshme nga kriza financiare mund të mos ndodhin kurrë dhe nuk janë lehtësisht të vëzhgueshme nga publiku. Me fjalë të tjera, sjellja kundërciklike kërkon një kosto të caktuar, e cila ndihet gjerësisht në publik, në këmbim të një përfitimi të mundshëm që nuk është i sigurt që do të shfaqet dhe, edhe në rast se shfaqet, nuk është e lehtë që të vihet re nga publiku i gjerë. Kështu, sjellja kundërciklike e politikës monetare mund të dëmtojë kredibilitetin e bankës qendrore dhe kjo humbje e kredibilitetit mund të dëmtojë efektivitetin e saj dhe madje mund të shtrembërojë edhe pritjet për inflacionin.

Një tjetër çështje e lidhur me efektivitetin e politikës monetare në ndjekjen e objektivave të stabilitetit financiar ka të bëjë me efektivitetin e mekanizmit të transmetimit të politikës monetare, veçanërisht në vendet që kanë një shkallë të lartë të euroizimit. Në rrethana të tilla, edhe nëse banka qendrore ka diskrecion mbi politikën monetare, ajo nuk do të jetë domosdoshmërisht në gjendje të ndikojë në çështjet e stabilitetit financiar. Gjithashtu, edhe pse norma e interesit e bankës qendrore është e rëndësishme në përcaktimin e normave të interesit të ngarkuara nga bankat, dihet se ka edhe norma të tjera interesi të cilat mund të jenë të rëndësishme dhe relevante në treg, që do të thotë se transmetimi i normës së interesit të bankës qendrore në normat e interesit të bankave komerciale nuk mund të jetë shumë i fortë (Billi dhe Vredin, 2014).

Një kanal tjetër nëpërmjet të cilit bankat qendrore mund të ndikojnë në stabilitetin financiar është funksioni i huadhënësit të instancës së fundit (LOLR) dhe vendet që kanë monedhën e tyre mund të jenë më efektive në ushtrimin e funksionit të LOLR, sepse ato kanë sasi më të mëdha rezervash. Megjithatë, në vendet që kanë një pjesë të madhe të depozitave të huaja, banka qendrore mund të mos jetë shumë e efektshme në përdorimin e funksionit të LOLR, sepse aftësia e saj për të përdorur këtë funksion varet nga shuma e rezervave ndërkombëtare në dispozicion ose aftësia për të rritur ato përmes huamarrjes. Edhe nëse banka qendrore ka mundësi të përdorë funksion LOLR, përdorimi aktiv

i tij mund të nxisë rrezikun moral duke i zvogëluar stimujt e bankave për t'u rikapitalizuar dhe ristrukturuar.

Stabiliteti Financiar në Kosovë

Duke parë mënyrat në të cilat politika monetare mund të përdoret për të ndjekur objektivat e stabilitetit financiar dhe kufizimet e tij për ta bërë këtë, le t'i kthehemi rastit të Kosovës dhe të shohim se si sigurohet stabiliteti financiar nën kushtet e euronizimit të njëanshëm, që nënkupton një disponueshmëri mjaft të kufizuar të instrumenteve të politikës monetare. Përdorimi i euros në Kosovë ka forcuar stabilitetin makroekonomik, duke siguruar një inflacion të ulët dhe të qëndrueshëm, i cili ka qenë mjaft shumë në përputhje me normat e inflacionit në eurozonë - rajonin me të cilin Kosova tregton shumicën e produkteve. Rreziku i kursit të këmbimit është minimizuar pas euroizimit. Mbi 95% e bilancit të gjendjes të sektorit bankar është në euro. Kjo ka çuar në një besim më të fortë të bankave në ekonomi dhe gjithashtu në besimin e fortë të depozituesve në banka, duke kontribuar kështu që depozitat në sektorin bankar të Kosovës të jenë të qëndrueshme madje edhe gjatë periudhës së krizës.

Duke pasur stabilitetin financiar si objektiv kryesor dhe duke mos pasur ndonjë "dhimbje koke" me kursin e këmbimit dhe çështjet e stabilitetit të çmimeve, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) ka qenë në gjendje të fokusohet në zhvillimin e funksioneve që janë të lidhura në mënyrë më të drejtpërdrejtë me stabilitetin financiar. Megjithëse BQK-ja është një bankë qendrore relativisht e re, ajo ka qenë mjaft e suksesshme në zhvillimin e këtyre funksioneve, duke përfshirë mbikëqyrjen e bankave, rregullimin, licencimin dhe njësinë e stabilitetit financiar.

Siç është përmendur edhe më lart, euroizimi i njëanshëm kufizon aftësinë e bankës qendrore për të ushtruar funksionin e huadhënësit të instancës së fundit dhe ky është rasti edhe me BQK-në. Sidoqoftë, BQK-ja ka arritur që deri në një masë të mënjanojë këtë kufizim duke prezantuar një skemë të mbështetjes emergjente me likuiditet, e cila

financohet bashkërisht nga kapitali i Bankës Qendrore dhe nga Qeveria e Kosovës. Kjo skemë bazohet në një fond që synon të përdoret për të injektuar likuiditet në bankat solvente, por që hasin në probleme afatshkurtra të likuiditetit. Përveç kësaj, 90% e sektorit bankar të Kosovës është në pronësi të huaj. Nga 10 banka, 8 janë banka në pronësi të huaj, të cilat përbëjnë 90% të aktiveve, gjë që nënkupton që, në rast se ka nevojë shtesë për likuiditet, mund të pritët një fluks nga bankat amë. Një argument tjetër për këtë është se bankat e huaja që veprojnë në Kosovë janë shumë të rëndësishme në aspektin e madhësisë për Kosovën, por janë shumë të vogla në krahasim me grupet e tyre. Pra, mund të pritët që çdo nevojë për likuiditet të bankave të huaja në Kosovë do të plotësohet lehtë nga bankat e tyre amë, sepse do të ishte një shumë shumë e vogël në krahasim me madhësinë e bankës amë.

Hapësira e kufizuar e BQK-së për të vepruar përmes funksionit të huadhënësit të instancës së fundit ka çuar në një sjellje më konservatore nga ana e bankës qendrore në drejtim të mbikëqyrjes së bankave dhe gjithashtu në një sjellje më të disiplinuar nga vetë bankat. Bankat në Kosovë janë shumë të vetëdijshme se nuk mund të trokasin lehtësisht në derën e Bankës Qendrore për të marrë ndihmë dhe kjo ka çuar në një sjellje shumë të disiplinuar, e cila përkthehet në një sistem bankar të shëndoshë.

Në rastet kur mund të paraqiten nevojat për rikapitalizim të bankave, atëherë kjo do të ishte më tepër një çështje për qeverinë sesa për Bankën Qendrore dhe mungesa e instrumenteve të politikës monetare mund të mos jetë shumë relevante në këtë kontekst. Kjo çështje lidhet kryesisht me aftësinë paguese të Qeverisë dhe jo me kapacitetin e Bankës Qendrore për të mbështetur bankat komerciale.

BQK-ja ka zhvilluar kohët e fundit një Kornizë Makroprudenciale, e cila në një masë pritët të përmbushë disa mangësi të mundshme të krijuara për shkak të mungesës së politikës monetare. Kjo kornizë është zhvilluar duke u bazuar në udhëzimet e Bordit Evropian të Riskut Sistemik (ESRB) dhe gjithashtu është themeluar një Komision Këshillimor Makroprudencial brenda bankës qendrore, i

përbërë nga drejtuesit e departamenteve përkatëse brenda Bankës Qendrore. Politika makroprudenciale ka përparësinë e aftësisë për të identifikuar dhe adresuar rreziqet më afër burimit të tyre, për dallim nga politika monetare që mund të jetë më pak e aftë të merret me rreziqet specifike që paraqiten në sektorin bankar.

Duke pasur parasysh të gjitha këto, tani le të shohim shkurtimisht se si po performon Kosova në aspektin e stabilitetit financiar. Sektori bankar ka pasur një rritje të fuqishme të kredisë për sektorin privat, i cili kryesisht është financuar nga depozitat e mbledhura në vend. Me gjithë rritjen mjaft të qëndrueshme të huadhënies, raporti i kredisë ndaj PBB-së mbetet nën mesataren e rajonit. Kjo do të thotë se ende ka hapësirë për të thelluar ndërmjetësimin financiar, por këtu duhet të pranojmë faktin se sektori bankar i Kosovës filloi të veprojë më vonë sesa pjesa tjetër e rajonit. Rritja e aktivitetit të qëndrueshëm të kreditimit ka mundësuar një konvergjencë graduale drejt mesatares së ndërmjetësimit financiar të pjesës tjetër të rajonit.

Cilësia tashmë e mirë e portofolit është përmirësuar edhe më shumë gjatë viteve të fundit. Në fund të vitit 2016, raporti i kredive joperformuese (NPL) ishte 4.9% dhe ka rënë më tej në 4.5% në mars 2017 (BQK, 2017). Rënia e fundit e NPL-ve kryesisht i atribuohet reformave ligjore që janë ndërmarrë në Kosovë. Një nga problemet më të rëndësishme në Kosovë lidhej me efikasitetin e gjykatave në zbatimin e kontratave, por ndryshimi i ligjit të procedurës së përmbarrimit e ka bërë shumë më të lehtë për bankat të zbatojnë kontratat e tyre. Tani autoritetet përmbarruese mund të ngrijnë shumë lehtë llogaritë bankare të debitorëve të keq dhe t'i transferojnë shumat tek palët përkatëse dhe gjithashtu është ulur numri i ankandëve që kërkohen për ekzekutimin e kolateralit. Një tjetër zhvillim i rëndësishëm është funksionalizimi i përmbarruesve privat, të cilët ndihmojnë shumë gjykatat në zbatimin e kontratave. Këto zhvillime u mundësojnë bankave të çlirojnë disa borxhe të këqija që ata kanë pasur për një kohë dhe gjithashtu ndikojnë në qëndrimin e ardhshëm të huamarrësve në drejtim të respektimit të kontratave të tyre të kredisë. Këto zhvillime kanë zvogëluar rreziqet ndaj bankave, gjë që është

reflektuar në një rënie të ndjeshme të normave të interesit në kredi të cilat janë konsideruar si tepër të larta deri vonë.

Raporti i kapitalizimit të sistemit bankar mbetet i kënaqshëm, shumë më lart se kërkesa rregullatore prej 12%. Raporti kredi/depozita mbetet nën 80%, duke sugjeruar që akoma ka hapësirë për zgjerimin e kreditimit pa shkaktuar shqetësime të likuiditetit. Gjithashtu, pozicioni i likuiditetit mbetet i fortë me aktivet likuide ndaj pasivit afatshkurtër në një nivel prej mbi 40%. Shkalla e profitabilitetit mbetet e kënaqshme, me normat e profitabilitetit në nivele më të larta krahasuar me sektorët bankarë të vendeve të rajonit. Kjo ishte për shkak të normave të larta të interesit për kreditë, por edhe për shkak të cilësisë së mirë të portofolit të kredisë.

Bankat kanë ruajtur normat e interesit të depozitave në një nivel të ulët gjatë viteve të fundit, por kanë reduktuar vazhdimisht normat e interesit për kreditë. Përveç reformës gjyqësore, faktorë të tjerë të rëndësishëm që kanë ndikuar në rënie të normave të interesit të kredisë përfshijnë uljen e normave të interesit të depozitave dhe rritjen e konkurrencës së sektorit bankar. Aktualisht, përhapja e normës së interesit në sektorin bankar të Kosovës qëndron në nivelin mesatar të rajonit.

Përfundim

Që nga paslufta, ekonomia e Kosovës ka shfrytëzuar valutat e huaja si valutë të saj zyrtare, duke filluar me markën gjermane dhe të kaluar pastaj në adoptimin e njëanshëm të valutës euro. Shfrytëzimi i një valute të qëndrueshme dhe të besueshme si valutë zyrtare i ka sjellë Kosovës shumë përfitime, kryesisht të lidhura me stabilitetin makroekonomik dhe lehtësimin e tregtisë. Sidoqoftë, mungesa e një valute kombëtare i ka shfaqur edhe kufizimet e veta dhe atë kryesisht për sa i përket instrumenteve të politikës monetare në dispozicion të Bankës Qendrore. Ky artikull u fokusua kryesisht në ndikimet e mundshme që ka pasur euroizimi, përmes kufizimit të politikës monetare, në kapacitetet e Bankës Qendrore për të siguruar stabilitetin financiar në Kosovë.

Bazuar në shqyrtimin e literaturës ekzistuese, politika monetare duket të jetë një mjet i rëndësishëm për të ndjekur e objektivin e stabilitetit financiar, por nuk paraqitet të jetë domosdoshmërisht efektive për të arritur këtë objektiv. Prandaj, mungesa e diskrecionit mbi politikën monetare në ekonomitë me euroizim të njëanshëm jo domosdoshmërisht paraqet një mundësi të humbur në lidhje me stabilitetin financiar, që do të thotë se stabiliteti financiar mund të mbahet edhe pa një autonomi të plotë mbi politikën monetare. Euroizimi i njëanshëm në Kosovë ka ulur rreziqet financiare dhe ka mundësuar një përqendrim më të madh në çështjet e stabilitetit financiar, duke bërë që Kosova të mund të shërbejë si një shembull i mirë i sigurimit të stabilitetit financiar edhe në kushtet e disponueshmërisë së kufizuar me instrumentet e politikës monetare. Përveç kësaj, siç mund të shohim nga rënia e fundit e normave të interesit në Kosovë dhe rënia e kredive joperformuese, rritja e efikasitetit të ndërmjetësimit financiar dhe zvogëlimi i rreziqeve të sektorit bankar në ekonomitë me euroizim të njëanshëm më tepër duhet ndjekur nëpërmjet reformave strukturore të cilat janë të prira të garantojnë stabilitet më afatgjatë dhe më të shëndetshëm për sistemin financiar dhe ekonominë në përgjithësi.

Referencat

1. Billi, R. and Vredin, A. (2014), Monetary Policy and Financial Stability – A Simple Story, *Sveriges Riksbank Economic Review*, 2014:2.
2. BQK (2017), Vleresimi Tremujor i Ekonomisë Nr. 18, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës: BQK, Prishtinë.
https://www.bankofalbania.org/web/pub/rostowski_ang_226_1.pdf
3. International Monetary Fund (2015), Monetary Policy and Financial Stability, IMF Staff report, Washington, D.C.
4. Rostowski, J. (2001), Why unilateral euroization makes sense for (some) applicant countries, [Në dispozicion:

RRUGA E KOSOVËS DREJT
INTEGRIMIT EKONOMIK EVROPIAN

Tryezë shkencore
(29 nëntor 2017)

2018

Botues:

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS

Lektor:

Shfqet Riza

Redaktor teknik:

ASHAK

Realizimi kompjuterik:

ASHAK

Madhësia: 8.50 tabakë shtypi

Tirazhi: 200 copë

Formati: 16x24 cm

Shtypi:

Focus Print

Shkup

Katalogimi në botim – (CIP)

Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

339.92(4/9:496.51)”2017”(063)

Rruga e Kosovës drejt integrimit ekonomik evropian : tryezë shkencore (29 nëntor 2017) / redaktore Justina Pula. – Prishtinë : Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës : Seksioni i Shkencave Shoqërore, 2018. – 131 f. : ilustr. ; 24 cm.

Titulli paralel në gjuhën shqipe dhe angleze

1.Pula, Justina

ISBN 978-9951-615-87-7